

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Çështje të sigurisë - 25

ÇËSHTJE EUROPIANE
DHE TË SIGURISË

European and
security affairs

Revistë e përtrenuajshme mbi sigurinë

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Bordi Shkencor:

Prof. Dr. Rexhep Meidani (kryetar)

Dr. Pëllunb Qazimi (anëtar)

Arjan Dymishi (anëtar)

Dr. Elona Dhërbo (anëtar)

Dr. Foto Duro (anëtar)

Redaktor përgjegjës :

Elira Hroni MA

Ndihmuan në përgatitje:

Egest Gjokutaj



Ky numër reviste botohet me mbështetjen financiare të Divizionit të Diplomacisë Publike të NATO-s dhe Fondacioni Shoqëria e Hapur OSI Think tank Fund, Tiranë

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	7
FROSINA DONINOVSKA	
VËSHTRIM NË TË ARDHMEN SFIDAT E BASHKËPUNIMIT RAJONAL PËR SIGURINË NË BALLKANIN PERËNDIMOR	9
N/KOL. (R) KANAN HIMAJ	
STUDIUES NË QENDRËN KOMBËTARE TË SIGURISË DHE MBROJTJES PERSPEKTIVAT E SIGURISË DHE ROLI INSTRUMENTIT USHTARAK NË RAJONIN TONË	30
KOL (R) FOTO DURO	
SISTEMI I PROMOVIMIT TË PERSONELIT NË FORCAT E ARMATOSURA SHQIPTARE	47
JULIAN DORACI	
KOMPANITË PRIVATE TË SIGURISË, IMPAKTI I TYRE NË SHOQËRITË E SOTME DHE NË REALITETIN SHQIPTAR	70
DOKTORANT KOL (R) THIMI HUDHRA - ZV/DREJTOR I QENDRËS KOMBËTARE TË SIGURISË DHE MBROJTJES	
KONCEPTI STRATEGJIK I SIGURISË DHE I MBROJTJES SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË SI VEND ALEAT ...	97
JËDRZEJ PASZKIEWICZ	
BASHKËPUNIMI RAJONAL NË BALLKANIN PERËNDIMOR NJË KËNDVËSHTRIM NGA BRENDA BASHKIMIT EVROPIAN, PREMISAT DHE PENGESAT	107
ABSTRACT	127

PARATHËNIE

Në përpjekje për të kontribuar në informimin e publikut mbi çështjet kryesore të politikave mbi reformat dhe performacën e sektorit të sigurisë në përgjithësi, trendet evropiane dhe globale të sigurisë, debatin aktual dhe të ardhshëm mbi fushat prioritare të NATO-s, sfidat e Shqipërisë për reformimin e institucioneve dhe qeverisjes në sektorin e sigurisë, çështjet debatuese dhe partneritetet e NATO-s me BE-në dhe organizatat e tjera botërore, ky numër i Revistës për Çështjet Evropiane dhe të Sigurisë vjen më një tematikë të veçantë, “Sfidat lokale e rajonale dhe bashkëpunimi në sektorin e sigurisë midis vendeve të Ballkanit Perëndimor.”

Ky volum përqendrohet mbi sfidat e bashkëpunimit rajonal të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Një rëndësi e veçantë i kushtohet edhe aspektit të sigurisë me një këndvështrim nga institucionet e sigurisë në vendin tonë.

Frosina DONINOVSKA

VËSHTRIM NË TË ARDHMEN SFIDAT E BASHKËPUNIMIT RAJONAL PËR SIGURINË NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Hyrje

Ruajtja e bashkëpunimit rajonal të sigurisë përbën një nga interesat më të rëndësishëm të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ky bashkëpunim përbën një faktor thelbësor për krijimin e stabilitetit politik, sigurisë dhe prosperitetit ekonomik. Bashkëpunimi rajonal është një instrument efikas për adresimin e sfidave të sigurisë me të cilat përballet rajoni, për shkak se adreson në mënyrë efektive një sërë çështjesh emergjente sikurse janë krimi i organizuar dhe korrupsioni apo menaxhimi i integruar i kufijve dhe emigracioni i paligjshëm.

Duke filluar që pas konfliktit të armatosur në territorin e ish Jugosllavisë, iniciativat e Bashkimit Evropian për vendosjen e bashkëpunimit rajonal ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor nuk kanë arritur efektin e dëshiruar. Strategjia e parë e qenësishme e komunitetit ndërkombëtar për parandalimin e konfliktit, e cila mundësoi kuadrin për bashkëpunimin rajonal dhe për marrëdhënie më të afërta me strukturat Euro-Atlantike, ka qenë Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore, i cili u themelua pak pas bombardimeve në Kosovë të vitit 1999 në Këln, me iniciativën e ministrit të punëve të jashtme të asaj kohe të Republikës Federale Gjermane, Joschka Fischer¹.

Në fillimet e tij, Pakti i Stabilitetit përfaqësoi një balancë ndërmjet komunitetit ndërkombëtar dhe rajonit. Me

¹ Bonne, A. "On the Need for Regional Cooperation". *Political Thought*, Vol. 31, Sep. 2010 p. 7.

krijimin e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal, dimensionin rajonal fitoi prioritet. Kësaj rradhe ky fakt përbënte një ndryshim revolucionar pasi deri atëherë, aktivitetet rajonale, kryesisht hartoheshin, propozoheshin dhe zbatoheshin nga Pakti i Stabilitetit dhe udhëhiqeshin nga komuniteti ndërkombëtar². Organizimi i ri nënkuptonte ndryshimin e tipareve të bashkëpunimit rajonal si edhe ndryshimin e mënyrës së ndërveprimit ndërmjet tyre për vendet e Evropës

Sekretari i parë i përgjithshëm i kësaj iniciative të re ishte diplomati kroat Hido Bisevic, i cili u zgjodh gjatë konferencës së mbajtur në maj në Zagreb nga Ministri i Jashtëm të rajonit. Transferimi zyrtar i kompetencave konsistonte në dy pjesë: vendosjen e zyrave qendrore rajonale dhe infrastrukturës përkatëse si edhe përshtatja e të gjithë grupeve dhe iniciativave ekzistuese në kuadrin e Paktit të Stabilitetit, nën kuadrin e ri rajonal³.

Bashkëpunimi rajonal ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor mund të konsiderohet si indikator i domethënës i stabilitetit në rajon. Ky konstatim është i vërtetë, pasi iniciativa presupozon pikërisht bashkëpunimin ndërmjet atyre grupeve shoqërore të Ballkanit Perëndimor që kishin qenë më aktive gjatë luftërave të fundit.

Situata aktuale në arenën ndërkombëtare nxjerr nevojën për një bashkëpunim më të madh rajonal ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor. Kjo ndodh për shkak se bashkëpunimi në vetvete është një faktor kryesor për stabilitetin dhe rritjen ekonomike të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Bashkëpunimi rajonal për sigurinë nuk është diçka e re për vendet e Ballkanit Perëndimor. Këto vende janë tashmë anëtarë të një sërë grupimeve rajonale evropiane si për shembull Bashkëpunimi Ekonomik i Detit të Zi (BEDZ), Iniciativa e Evropës Qendrore (IQL) dhe Zona e Tregëtisë së Lirë e Evropës Qendrore

²Radic, N. Paktot sto go Izmeni Liceto na Jugoistocna Evropa. Setimes. June, 2007.

³"The News and Views of South East Europe" The Pact That Changed the Face of Southeast Europe. Parë në 25 shtator 2013.

Shih: <http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/mk/features/setimes/articles/2007/06/11/reportage-01>

(CEFTA). Për më tepër, vullneti i përbashkët për të qenë anëtarë të organizatave me ndikim si BE dhe NATO apo edhe Këshilli i Evropës tregon interesa të përbashkët politike dhe reagime të ngjashëm ndaj mjedisit ndërkombëtar⁴.

Presioni i jashtëm për bashkëpunim rajonal është gjithashtu një sfidë tjetër për forcimin e bashkëpunimit të sigurisë ndërmjet shteteve. Kështu ka qenë sidomos në vijim të konfliktit në Kosovë. Përgjigjia për këtë konflikt nga komuniteti ndërkombëtar ishte krijimi i Paktit të Stabilitetit, i cili më vonë u shndërrua në Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal.

Përse nevojitet bashkëpunimi rajonal?

Së pari bashkëpunimi rajonal nevojitet për vetë Ballkanin Perëndimor dhe për një sërë çështjesh të tij sikurse janë lufta ndaj krimit të organizuar, rritja e tregëtisë dhe thithjes së investimeve, forcimi i parandalimit dhe parapërgatitjes në rastet e fatkeqësive natyrore e të tjerë. Të gjitha këto çështje mund të adresohen më së miri vetëm përmes një kuadri rajonal. Konkretisht, ky është një nga kriteret për anëtarësimin në NATO dhe BE, duke qenë se këto dy organizata duan të anëtarësojnë vendet të cilat tregojnë maturi në marrëdhëniet me fqinjët e tyre, pavarësisht se sa të dhimbshme mund të jenë kujtimet e ngjarjeve të fundit.

Megjithatë, bashkëpunimi rajonal nuk duhet perceptuar gabimisht si një zëvendësues për integrimin evropian dhe atë Euro-Atlantik. Duke qenë se bashkëpunimi rajonal përbën themelet e vetë BE-së, ky është gjithashtu edhe një kusht për integrimin e mëtejshëm të vendeve të Evropës Juglindore në BE. Bashkëpunimi rajonal duhet parë pra si një përgatitje e rëndësishme për anëtarësimin në NATO dhe BE⁵.

⁴ Ibid.

⁵ "Stability Pact for Southeastern Europe". From a Conflict Prevention and Confidence Building Initiative in Southeastern Europe to a Regionally-owned Regional Co-operation Council. Parë në: 30.09.2013 Shih: <http://www.stabilitypact.org/about/SPOënershipprocessPortal.asp>

Faktorët më të rëndësishëm që kontribuojnë për bashkëpunimin në rajon janë renditur si më poshtë. Së pari, ekziston një marrëdhënie më e ngushtë mes shteteve duke menduar se ata i përkasin të njëjtit rajon. Faktori i dytë i rëndësishëm është historia dhe kultura e përbashkët, zakonet kulturore dhe shoqërore të njëjtë dhe lidhjet ekonomike si partnerë tregtarë. Pavarësisht një sërë faktorëve që ndihmojnë bashkëpunimin rajonal për sigurinë, pa dyshim që ekziston nevoja për të krijuar një kuadër të përgjithshëm lidhur me rreziqet politike ose konfliktet e jashtëm. Ekzistenca e çështjeve rajonale dhe e problemeve të përbashkëta që burojnë nga tranzicioni, nënzhvillimi dhe mungesa e sigurisë në rajon njihen si faktorë thelbësorë që stimulojnë bashkëpunimin⁶.

Nga Pakti i Stabilitetit të Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal

Pakti i Stabilitetit

Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore u krijua në vitin 1999 me iniciativën e Bashkimit Evropian dhe dymbëdhjetë firmëtarët e tij përfshinin vende dhe organizata ndërkombëtare, të cilat merren me mbështetjen e vendeve të Evropës Juglindore për përpjekjet dhe reformat që synojnë paqe të qëndrueshme, zhvillim demokratik dhe mirëqenie ekonomike e që do të siguronin stabilitetin afatgjatë të rajonit⁷.

Pakti funksionon bazuar në marrëveshjet e fqinjësisë së mirë, nënshkruar ndërmjet shteteve të Evropës Juglindore. Puna e tij u nda së pari në grupe rajonale (të drejtuar nga një koordinator special) të cilat përbëheshin nga një sërë nëngrupesh (i pari prej këtyre grupeve ishte për demokratizimin dhe të drejtat e njeriut, i dyti për rindërtimin, bashkëpunimin

⁶ Anastasakis, O. and Bojicic – Dzelovic, V. *Balkan Regional Cooperation and European Integration*. (London: School of Economic and Political Science, 2002) p. 25

⁷ Ibid p. 27.

dhe zhvillimin ekonomik dhe i treti për çështjet e sigurisë). Kësisoj u krijuan mekanizma për koordinimin e politikave të aktorëve të shumtë të përfshirë në zonën e Ballkanit dhe për aprovimin e politikave që u miratuan nga ata të cilët kishin firmosur Paktin⁸. Mandati i gjerë dhe mbështetja e fortë ndërkombëtare për Paktin e Stabilitetit mundësoi bindjen e vendeve të Evropës Juglindore për t'u përfshirë në një projekt për bashkëpunimin rajonal, të gjerë dhe të artikuluar, i cili do të sillte përfitime praktike dhe një të kuptuar politik më të thelluar.

Me arritjen e progresit domethënës në terren dhe me përmirësimin e kushteve ekonomike, politike dhe shoqërore në rajon, qasja e orientuar prej ndërkombëtarëve, që përbënte thelbin e Paktit të Stabilitetit, u bë e vjetër. Si rrjedhojë, u ndie nevoja për një kuadër me pronësi më të theksuar rajonale, që do të reflektonte edhe maturinë në rritje të rajonit. Ky ishte motivi kryesor për ridimensionimin e transformimit të Paktit të Stabilitetit në organizatën pasardhëse të tij, Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal.

Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal

Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (KBR) u lançua zyrtarisht në takimin e Ministrave të Punëve të Jashtme të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (PBEJL) në Sofje, në vitin 2008. Nëpërmjet një kuadri me pronësi rajonale, KBR u përqendrua te promovimi dhe shtimi i bashkëpunimit rajonal në Evropën Juglindore (EJL) dhe mbështeti integrimin evropian dhe atë Euro-Atlantik të vendeve aspirante. KBR mundësoi kapacitete operationale nën udhëheqjen politike të PBEJL. Puna e KBR u përqendrua në fushat prioritare të bashkëpunimit ekonomik dhe shoqëror, energjisë dhe infrastrukturës, drejtësisë dhe çështjeve të brendshme, bashkëpunimit në fushën e sigurisë, ndërtimit të kapitalit human dhe bashkëpunimi parlamentar.

⁸ "Regional Academy for Democracy." Regional Cooperation. Parë në: 30.09.2013. Shih: <http://www.radwb.eu/2013/about-rad/regional-cooperation>

Organizata zhvillon dhe mban marrëdhënie të ngushta pune me të gjithë aktorët përkatës dhe palët pjesëmarrëse në këto fusha duke përfshirë qeveritë, organizatat ndërkombëtare, institucionet financiare ndërkombëtare, organizatat rajonale, shoqërinë civile dhe sektorin privat.

KBR synon të sigurojë stabilitetin ekonomik, politik dhe ligjor të rajonit, sikundër edhe Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore, përpara tij. Për arritjen e këtij qëllimi, puna e Këshillit përqendrohet në fushat prioritare të zhvillimit ekonomik dhe social, infrastrukturës dhe energjisë, drejtësisë dhe punëve të jashtme, bashkëpunimit në sektorin e sigurisë, arsimit dhe kërkimit si dhe bashkëpunimit parlamentar (çështja e fundit u pa si një çështje ndërsektoriale)⁹.

Nuk ka dyshim se rajoni është afruar edhe një hap drejt integritimit Euro-Atlantik sot dhe për këtë sukses duhet vlerësuar edhe Pakti i Stabilitetit. Në fazën e ardhshme rajoni duhet të largohet prej atij që ka qenë fillimisht një proces i udhëhequr nga ndërkombëtarët drejt një pronësie më të madhe vendore për punët e tyre. Duke pasur parasysh këtë, një proces transformimi dhe ri-dimensionimi u lançua në vitin 2005 me synimin final për të pasur një kuadër të ri të bashkëpunimit rajonal në Evropën Juglindore brenda vitit 2008.

Në vijim të një procesi të gjerë konsultimesh me vendet e EJT, struktura më e lartë vendimmarrëse e Paktit të Stabilitetit, tryeza rajonale e Beogradit, e majit të vitit 2006, vendosi për transformimin e Paktit të Stabilitetit në Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal. Detyra kryesore e kësaj organizate ishte të luante rolin e një lehtësuesi të bashkëpunimit rajonal dhe të siguronte mbështetjen për integrimin evropian dhe Euro-Atlantik të vendeve të Ballkanit.

⁹ "Federal Ministry for Economic Cooperation and Development". From Stability Pact to Regional Cooperation Council – Greater Ownership for Southeastern Europe. Parë në: 02.10.2013. Shih: http://www.bmz.de/en/what_We_do/countries_regions/Central-Eastern-and-South-Eastern-Europe/rat_regionale_kooperation/index.html

Pronësia rajonale e strukturës së re do të ishte jo vetëm politike, por edhe financiare. Për këtë, vullneti financiar i vendeve të rajonit është një shenjë e rëndësishme e vullnetit politik të vendeve të EJL për t'u përfshirë edhe më tej në procesin e bashkëpunimit rajonal. Njëkohësisht, Pakti i Stabilitetit dhe partnerët e tij ndërkombëtarë sigurojnë përfshirjen e vazhdueshme të komunitetit të donatorëve duke ruajtur kështu ligjshmërinë e paktit¹⁰.

Roli i KBR

KBR përfshihet në adresimin e sfidave të mbetura dhe atyre të reja në nivel kombëtar dhe rajonal në fushën e sigurisë dhe kështu përipiqet të vendosë një mjedis sigurie stabil në të gjithë Evropën Juglindore. Bashkëpunimi rajonal, i cili sipas KBR duhet të përfundojë në një pronësi tërësisht rajonale, do të ndihmonte për bërjen më efikasë të reagimeve për sigurinë. KBR vendos theksin mbi të ashtuquajturën Reformë të Sektorit të Sigurisë (RSS) duke përfshirë forcimin e funksionit mbikëqyrës të strukturave legjislative për forcat e armatosura dhe për shërbimet e sigurisë.

Përsa i përket RSS-së, Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal synon bërjen transparente të ndarjeve funksionale për komunitetin e donatorëve e promovimin e pronësisë vendore si edhe ndërtimin e kapaciteteve koordinuese. Duke pasur parasysh faktin se koordinimi ndërmjet aktorëve qeverisës ndërkombëtarë dhe kombëtarë në fushën e sigurisë ka mjaft rëndësi dhe se ky koordinim është ende i pamjaftueshëm, ambiciet e KBR synojnë marrjen e rolit udhëheqës në zhvillimin e RSS-së¹¹.

¹⁰ "Coordination of Research Policies with the Western Balkan Countries". From Stability Pact to Regional Co-operation Council. Parë në: 02.10.2013. Shih: <http://wbc-inco.net/object/news/3656>

¹¹ Regional Cooperation in South Eastern Europe: The Post- stability Pact Period. Report No. 31. Analytica. October, 2009. p. 8. Parë në: 05.10.2013. Shih: <http://analyticamk.org/files/ReportNo31.pdf>

Përfitimet nga anëtarësimi në iniciativat e bashkëpunimit rajonal

Përmes iniciativave të sigurisë ose segmenteve dhe iniciativave që përfshijnë edhe objektivat e sigurisë, vendet e Ballkanit Perëndimor u fokusuan tek anëtarësimi dhe bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare të sigurisë për të vendosur paqen, stabilitetin dhe për t'u marrë në mënyrë efikase me krimin e organizuar.

Vendet e Ballkanit Perëndimor panë tek anëtarësimi në këtë strukturë një mundësi për t'u përgatitur për hyrjen në organizatat ndërkombëtare përmes arritjes së përshtatshmërisë dhe standardeve të tjerë të nevojshëm. Pra sekuenca e përgjegjësive të brendshme në fushën e sigurisë e kombinuar me aktivete mundësoi bashkëpunimin rajonal për sigurinë. Përmes bashkëpunimit rajonal për sigurinë, vendet morën disa garanci dhe ndihmë në luftën kundër krimit të organizuar dhe kërcënimeve ndaj sigurisë prej partnerëve të tyre (BE dhe NATO).

Një tjetër përfitim që buronte nga anëtarësimi ishte aftësia për të mbajtur një komunikim më pak formal, por më shumë efikas me strukturat e BE-së dhe NATO-s¹². Kjo krijon hapësirën e nevojshme për promovimin e lehtësive të sigurisë kombëtare dhe të mundësive për t'u takuar jo vetëm për interesat e sigurisë shtetërore, por edhe për interesa të tjerë brenda strukturave ndërkombëtare.

Përshtatja ishte një pjesë integrale e procesit të krijimit të politikave kombëtare të sigurisë së Ballkanit Perëndimor në kuadër të integritimit evropian dhe Euro-Atlantik. Harmonizimi i strategjive të brendshme të sigurisë me ato të BE-së dhe NATO-s u bë për të tejkaluar konceptin e një politike sigurie kombëtare të pavarur, e cila bazohet vetëm tek burimet e saj

¹²*Regional Cooperation in the Western Balkans: A Policy Priority for the European Union.* (Luxembourg: European Commission Report, 2006).

për t'u përballur me rreziqet e sigurisë. Gjithashtu, fillimi i iniciativave të sigurisë rajonale koïncidoi me kohën e zbatimit të reformës në sektorin e sigurisë¹³.

Roli i BE-së dhe NATO-s në procesin e bashkëpunimit rajonal për sigurinë në Ballkanin Perëndimor

Strategjia e komunitetit ndërkombëtar ishte që NATO të kontribuonte për sigurinë dhe Evropa për vendimet kushtetuese dhe për zhvillimin ekonomik të Ballkanit Perëndimor. Kjo nënkuptonte: së pari prezencën e vazhdueshme të NATO-s në rajon dhe së dyti strategjia synonte të nxiste fuqinë transformuese të BE-së në rajon nëpërmjet premtimit se shtetet do të bëheshin anëtarë të saj. Kështu, integrimi Euro-Atlantik do të kontribuonte për stabilitetin dhe zhvillimin e rajonit.

NATO dhe BE janë të përfshirë në Ballkanin Perëndimor për shkak të veprimeve të tyre për zgjerimin, i cili zhvillohet në rastin e NATO-s përmes procesit të Planit të Veprimit për Anëtarësim (PVA) dhe në rastin e BE-së përmes Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit me këtë të fundit. Gjithashtu, përfshirja e tyre u manifestua edhe nëpërmjet menaxhimit të krizave në Bosnjë-Hercegovinë dhe Kosovë¹⁴. Fuqia ekonomike, politike dhe ushtarake e NATO-s dhe BE-së u jep këtyre organizatave një ndikim domethënës, si rezultat i dëshirës që kanë shumë vende të rajonit për t'u anëtarësuar në këto organizata.

Pavarësisht prezencës së theksuar të organizatave kryesore evropiane dhe ndërkombëtare në këtë zonë, ende nuk mund

¹³ Rajkoceviski, R. "The Contemporary Identity of the Western Balkans Transformed into Active Regional Security Cooperation". *Political Thought*, Vol. 31. September 2010.

¹⁴ *Implementing the Renewed Enlargement Consensus*. (Brussels: Commission of the European Communities, 2008).

të flitet për rezultate të kënaqshme thelbësore. Politikat e zgjerimit bazohen mbi premisën së shtetet mund të pranohen në grup por vendimet për anëtarësim do të bazohen tek vullneti i secilit prej vendeve. Kjo qasje inkurajon bashkëpunimin rajonal ndërmjet vendeve partnerë si dhe ndonjëhere rrit konkurrueshmërinë ndërmjet tyre për zhvillimin e marrëdhënieve më të ngushta me perëndimin¹⁵.

Ndërsa NATO dhe BE-ja mund dhe duhet të bëjnë më shumë për nxitjen e bashkëpunimit rajonal në Ballkanin Perëndimor, progresi i bashkëpunimit rajonal nuk mund të ndahet nga zhvillimet e gjera politike dhe të sigurisë. Bashkëpunimi rajonal nuk mund të zhvillohet ose të luajë rol domethënës, nëse Ballkani Perëndimor karakterizohet nga shpërthimet e vazhdueshme të dhunës dhe nga përkeqësimi i marrëdhënieve ndëretnike dhe ndërshtetërore¹⁶. Në këtë kontekst, perëndimi ka dështuar për zhvillimin e një strategjie efikase për të adresuar shkaqet e problemeve rajonale, që shkaktohen nga dështimet në procesin e demokracisë dhe nga nacionalizmi i dhunshëm.

Zgjidhja afatgjatë e problemeve të Ballkanit Perëndimor dhe shtrirja e mëtejshme e stabilitetit në rajonin e Evropës Juglindore varet nga zhvillimi i demokracive, nga fakti se duhet të ekzistojnë të njejtat standarde për respektimin e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të minoriteteve në të gjithë shtetet si edhe prej zbatimit të principit të ndryshimit të kufijve ndërkombëtarë¹⁷. Për arritjen e këtij objektivi, anëtarët kryesorë të NATO-s dhe BE-së duhet të mbeten të angazhuar seriozisht në Ballkanin Perëndimor edhe gjatë viteve në vazhdim. Një

¹⁵ Ibid.

¹⁶ Grillot, S. Cruise, R. and D' Erman, V. *Developing Security Community in the Western Balkans: The role of the EU and NATO*. (Oklahoma: School of International and Area Studies, University of Oklahoma,).

¹⁷ Marizza, G. "Italian Atlantic Committee". NATO and the Western Balkans. Parë në: 06.10.2013. Shih: <http://www.comitatoatlantico.it/en/studi/nato-and-the-western-balkans/>

nga elementët e këtij angazhimi duhet të jetë shtimi i mbështetjes për bashkëpunimin rajonal. Sfida për organizatat kryesore evropiane dhe ndërkombëtare do të jetë gjetja e hapësirës politike në të cilën organizatat rajonale mund të zhvillojnë dhe mundësojnë mbështetje politike dhe materiale për forcimin e këtij bashkëpunimi¹⁸.

A funksionon realisht ideja e bashkëpunimit rajonal për sigurinë?

Në të kaluarën kemi qenë dëshmitarë të një zhvillimi dinamik në fushën e bashkëpunimit rajonal për sigurinë, i cili është përqendruar tek krijimi i strukturave për shtimin e këtij bashkëpunimi. Megjithatë, pyetja që shtrohet është: a janë të arritshme idetë për iniciativa rajonale në Ballkan? Sipas zyrtarëve evropianë theksimi, njëkohësisht i bashkëpunimit rajonal dhe komunikimit, nuk do të thotë se mbështetja e BE-së për rajonin do të dobësohet¹⁹. Në të kundërt, sipas tyre, procesi i integritimit duhet të shoqërohet nga një rritje e fortë ekonomike rajonale dhe nga zhvillimi i bashkëpunimit reciprok ndërmjet vendeve të Evropës Juglindore.

Megjithatë, ekspertët theksojnë se derisa të gjitha çështjet e mbetura pezull në Ballkan të zgjidhen, do të jetë e vështirë për të bërë funksionale në nivelin e dëshiruar këto iniciativa rajonale. Sipas tyre, një çështje thelbësore në këtë kontekst është ajo e Kosovës. Sipas ish Ministrit të Punëve të Jashtme të Republikës së Maqedonisë, Antonio Milososki, ndërmjet vendeve të rajonit ka bashkëpunimin, por ato gjithnjë përballen me probleme, kur vjen fjala te vendi, pjesëmarrja e të cilit do

¹⁸"Marshal Center Macedonia". Regional Aspects of the Defense and Security of the Republic of Macedonia. Parë në: 06.10.2013. Shih: http://www.ecbs.org.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=17:2010-05-06-01-14-26&catid=6:forums&Itemid=21&lang=mk

¹⁹ Bozinovska, Z. The Balkan Countries Associate Only Formal. *Nova Makedonija*, 2013.

të thotë mungesë pjesëmarrjeje për një vend tjetër. E tillë është situata me Kosovën dhe Serbinë dhe në disa raste edhe me Maqedoninë dhe Greqinë.

Disa prej iniciativave, megjithatë janë të qëndrueshme, deri kur ka interes të përbashkët. E tillë është për shembull Karta e Adriatikut, e cila filloi me Maqedoninë, Kroacinë dhe Shqipërinë dhe që funksionon ende, ndonëse motivimi është më i ulët pas hyrjes së Kroacisë dhe Shqipërisë në NATO dhe si rrjedhojë nuk ka vrullin e mëparshëm. Sipas Milososkit, aktualisht forumi më serioz dhe më i gjerë në rajon është procesi i bashkëpunimit në Evropën Juglindore, i cili nuk ka sjellë mrekulli ekonomike dhe tregtare, por ka si të vetmin rrezultat takimin ndërmjet përfaqësuesve të të gjitha vendeve.

Koncepti i “kompleksit të sigurisë” në kontekstin e vendeve të Ballkanit Perëndimor

Për të kuptuar rëndësinë e Ballkanit Perëndimor për sigurinë Euro-Atlantike, vëmendje e veçantë i është kushtuar konceptit të “kompleksit të sigurisë”. Koncepti i komplekseve rajonale të sigurisë lidhet me mënyrën se si siguria grupohet në rajone të ndarë gjeografikisht. Shqetësimet për sigurinë nuk përçohen mirë në distancë dhe si pasojë ka më tepër mundësi që rreziqet të ndodhin në rajon. Siguria e secilit aktor në rajon ndërvepron me sigurinë e aktorëve të tjerë. Shpesh ka ndërvarësi të theksuar të sigurisë brenda një rajoni, por jo ndërmjet rajoneve, gjë që përcakton një rajon dhe bën që siguria rajonale të jetë një fushë interesante²⁰. Rajonet duhen parë si mini sisteme ku të gjitha teoritë e MN mund të aplikohen duke përfshirë Balancën e Fuqive, polaritetin, ndërvarësinë, sistemin e aleancave, e të tjerë.

²⁰ Buzan, B. & Waeaver, O. *Regions and Powers. The Structure of International Security*. (Cambridge: Cambridge University Press, 2003) p 125.

Ka pasur hapësirë për debat mbi faktin nëse rajoni i Ballkanit Perëndimor përfaqëson një kompleks të sigurisë *per se*, apo nëse ai është një subkompleks i kompleksit të sigurisë evropiane²¹. Buzan dhe Waever theksojnë karakteristikat që kthejnë një grup shtetesh në një rajon, duke theksuar se “një grup specifik etnitetesh duhet të zotërojë një nivel ndërvarësie të sigurisë, të mjaftueshëm si për t’i pozicionuar ata si një kuadër të ndërlidhur, ashtu edhe për t’i veçuar ata nga rajonet e sigurisë që i rrethojnë.”

Buzan identifikon dy periudha kohore kryesore që përcaktojnë zhvillimet e Ballkanit Perëndimor: periudha nga viti 1990 deri në vitin 1999 dhe lufta në Kosovë e zhvillimi i Ballkanit Perëndimor nga viti 1999 e deri më sot. Ai thekson se gjatë periudhës së parë Rajoni i Ballkanit Perëndimor (RBP) mund të përkufizohet si një kompleks sigurie, ndërsa gjatë periudhës së dytë RBP është më së shumti një subkompleks sigurie, për shkak se zhvillimi i ngjarjeve në zonë është formësuar kryesisht në nivel evropian, më shumë se brenda rajonit²². Komplekset e sigurisë kanë tendencë të jenë afatgjata, por ato nuk janë as të përhershme dhe as ndërkombëtarisht të ngurta, duke qenë se disa faktorë të jashtëm mund t’i ndikojnë ato në një mënyrë apo në një tjetër. Në rastin tonë, ndërhyrjet e NATO-s dhe BE-së kanë qenë vendimtare për formësimin e tipareve të këtij kompleksi të sigurisë.

Praktikat më të mira

Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë bërë progres të dukshëm në proceset e përmirësimit të sigurisë rajonale dhe integritit në BE. Gjithashtu, kanë rënë dakord për të

²¹ NATO as a Regional Actor: *Shaping the Western Balkan’s Security Complex*. Center for European Policy Evaluation. July, 2012.

²² Ciuta, F. *Reviewed work(s): Regions and Powers: The Structure of International Security by Barry Buzan; Ole Wæver*. The Slavonic and East European Review, Vol. 83, No. 1 January, 2005 p. 166-167.

promovuar iniciativat e bashkëpunimit rajonal dhe marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe për mbrojtjen dhe sigurinë. Në këtë kuadër është bërë progres, sidomos përsa i përket marrëdhënieve dypalëshe ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, së brendshmi në Bosnjë Hercegovinë dhe për integrimin evropian të Maqedonisë²³.

Sipas profesorit të universitetit në European Center for Peace Studies, Mathew Rhodes, kontributi më i madh në fushën e bashkëpunimit rajonal për sigurinë ka qenë firmosja e marrëveshjes kuadër ndërmjet Kosovës dhe Serbisë e cila vendosi bazat për komunikim paqësor dhe të vazhdueshëm ndërmjet këtyre shteteve.

Sipas Stojan Slaveski, profesor në Fakultetin për Sigurinë në Shkup fakti se rajoni ngadalë por bindshëm po bëhet më stabil dhe më i sigurt dhe po përfshihet në proceset e integritit Euro-Atlantik përbën progres të madh me të cilin ne duhet të jemi të lumtur, megjithëse ka ende çështje të hapura ku NATO dhe BE duhet të përqendrohen. Vendet në rajon janë tashmë më të përgatitura për bashkëpunim dhe janë bërë iniciatorë të këtij bashkëpunimi. Një sërë iniciativash rajonale për mbrojtjen dhe sigurinë po japin tashmë rezultate pozitive.

Kreu i marrëdhënieve publike të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Malit të Zi thekson se të gjithë vendet në rajon duan të kontribuojnë për përmirësimin e bashkëpunimit rajonal. Kjo është e ardhmja e Ballkanit dhe NATO e BE duhet të udhëheqin bashkëpunimin rajonal për njëfarë kohe. Zgjidhja e krizave përmes projekteve dhe aktiviteteve të përbashkët është një çështje që u ngrit si një iniciativë e NATO-s.

Pavarësisht zhvillimeve pozitive në bashkëpunimin rajonal për sigurinë, ende ka disa sfida të sigurisë që kërkojnë vëmendjen e të gjithëve. Lufta kundër krimit të organizuar,

²³ Intervistë me Mathew Rhodes, Profesor në European Center for Peace Studies. Set Times, shtator, 2013.

ekstremizmit politik dhe strukturave radikale përbëjnë faktorët bazë që Ballkani të arrijë siguri dhe stabilitet afatgjatë. BE dhe NATO janë zgjidhjet më të mira për të gjithë problemet dhe rreziqet e sigurisë.

Sfidat përpara

Aktualisht mjedisi global vazhdon të përparojë drejt marrëdhënieve më komplekse. Paradigma e rreziqeve të reja trajton një armik të panjohur, i cili është zakonisht një strukturë jo-qeveritare, një aktor jo shtetëror dhe jo konvencional dhe nuk i përmbahet asnjë prej rregullave të angazhimit, që janë përcaktuar aktualisht. Rreziku i ri për sigurinë është asimetrik nga natyra dhe shpesh është e pamundur të prioritetizohet mbledhja e informacionit dhe parandalimi i tij. Mjedisi i sigurisë globale pritet të bëhet më kompleks dhe më i paparashikueshëm në të ardhmen. Këndet e izoluar të destabilitetit po zgjerohen dhe po bëhen edhe më të paqartë. Duke pasur parasysh këtë mjedis të ri, do të ketë një kërkesë më të madhe për shërbime informative në të ardhmen. *Bota ku jetojmë sot përballet me realitetet e ndryshimit gjeostrategjik dhe gjeopolitik. Gjithashtu, kjo vlen edhe për Ballkanin*²⁴.

Pavarësisht zhvillimeve dhe trendeve pozitive në rajonin e Ballkanit, Ballkani Perëndimor përballet me sfida domethënëse, të cilat përkeqësojnë arritjet e aspiratave për integrim Euro-Atlantik dhe përbëjnë rrezik për situatën e sigurisë.

Ka pasur një rënie domethënëse të krimit ordiner në Ballkanin Perëndimor, por megjithatë krimi i organizuar dhe korrupsioni janë ende prezent. Krimi i organizuar në përgjithësi shfaqet në formën e trafikut të drogës dhe të qenieve njerëzore si edhe përmes pastrimit të parave. Këto aktivitete lehtësohen

²⁴ Arben Imami, Ministër i Mbrojtjes i Shqipërisë, në takim in Karta e Adriatikut 5 mbajtur në Durrës në 10 dhjetor 2011)

nga nivelet e dobëta të zbatimit të ligjit. Kuadri ligjor për këto probleme është i zhvilluar mirë, megjithatë përballet me probleme gjatë procesit të implementimit.

Evidenca për një vazhdimësi specifike “terror-krim” është e pa plotë. Kjo vjen pjesërisht për shkak të vështirësive në përcaktimin e koncepteve. Gjithashtu, kjo vjen edhe për shkak të vështirësive për identifikimin e motiveve të grupeve që veprojnë brenda një rrjeti të caktuar²⁵. Për shembull, në fund të luftës disa lidhje u vendosën ndërmjet disa sektorëve të shtetit në lindje e sipër të Bosnje-Hercegovinës dhe grupimeve islamike, disa prej të cilëve kishin lidhje me grupime terroriste. Prandaj Bosnja është përdorur, edhe pse në mënyrë të kufizuar, si një “portë” për militantët që lëvizin ndërmjet Evropës dhe Lindjes së Mesme. Megjithatë, motivimet pas këtyre lidhjeve shpesh janë bazuar tek dëshira për të promovuar (ose prishur) një proces paqeje lokal dhe jo tek eksportimi i terrorizmit në vendet e treta²⁶.

Ekzistojnë një sërë sfidash tek të cilat vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të përqendrohen në të ardhmen. Rrjeti i krimit të organizuar ushqen nacionalizmin dhe ekstremizmin në vendet e rajonit dhe eksporton produktet e tij të paligjshme në BE. Një nga problemet e identifikuar është fakti se thuajse dy të tretat e heroinës së konfiskuar në BE vjen nëpërmjet Ballkanit, ndërkohë që e ashtuquajtura “rruga e Ballkanit” është një korridor kryesor për trafikimin e qenieve njerëzore, drogës dhe mallrave të tjera të paligjshëm drejt BE-së²⁷. Përveç këtyre dy sfidave kryesore, vendet e Ballkanit Perëndimor

²⁵ *The European Future of the Western Balkans*. (Paris: European Institute for Security Studies, 2013) p. 119.

²⁶ “Socio – economic and Humanities Research for Policy”. Organized Crime and Corruption Threaten Human Security in the Western Balkans. Parë në: 10.10.2013. Shih: <http://www.scoopproject.org.uk/1organised-crime-and-corruption-threaten-human-security-in-the-western-balkans.aspx>

²⁷ Delevic, M. *Regional Cooperation in the Western Balkans*. (Beograd: Institute for Security Studies. No.104, 2007) p 82.

duhet të luftojnë trafikun e armëve dhe forma të tjera të krimit të organizuar.

Në përgjithësi, rreziqet e sigurisë për Ballkanin Perëndimor janë të ngjashme për të gjithë vendet e rajonit. Këto lloj rreziqesh lidhen me zhvillimet e brishta politike, shqetësimet sociale dhe ekonomike, ndarjen dhe mungesën e besimit ndërmjet grupeve etnike, tendencat për ekstremizëm islamik dhe për vendosjen e lidhjeve rajonale, ekzistencën e krimit të organizuar dhe zgjerimin e tij brenda rajonit dhe përtej, prezencën e një stoku të madh armësh dhe municionesh, të cilat mund të jenë tërehqëse për grupimet ekstremiste dhe ndikimin nga kriza financiare²⁸.

Masat e nevojshme për t'u përballur me krimin e organizuar janë tashmë të vendosura, por ato zakonisht nuk implementohen²⁹. Kjo, kryesisht ndodh për shkak të institucioneve të dobëta shtetërore, interesave të ndërthurura politike dhe kriminale dhe për mungesë të burimeve humane dhe financiare. Roli i shoqërisë në Ballkanin Perëndimor gjithashtu nevojitet të forcohet duke institucionalizuar pjesëmarrjen e saj në punët publike.

Çështja e statusit të Kosovës është një prishës potencial i procesit të stabilizimit në rajon. Për të reduktuar rezikun e përshkallëzimit të shpërthimeve të dhunës, komuniteti ndërkombëtar dhe kryesisht përfshirja e organizatave Euro-Atlantike dhe prezenca e tyre në rajon, vazhdon të jetë e domosdoshme³⁰. Anëtarësimi në NATO i Shqipërisë dhe i Republikës së Maqedonisë është i dëshirueshëm për të siguruar

²⁸ "Albanian Institute of Intelligence and Security Studies." *New Security Threats Impose western Balkan Countries a New Way of Doing Intelligence*. Parë në: 10.10.2013. Shih: <http://www.aliiss.org/?p=362>

²⁹ Marenin, O. *Security Sector Reform in the Western Balkans: Assessing Progress*. (Vienna: National Defense Academy, Bureau for Security Policy at the Austrian Ministry of Defense. 2007) p. 274.

³⁰ Grim, K. *Integrating the Western Balkans into NATO and EU: Challenges, Expectations and Needs*. (Montenegro: Consortium of Defense Academies and Security Studies Institutes, 2007).

kufijtë dhe për stabilitet të vazhdueshëm. Institucionet demokratike dhe RSS nevojiten urgjentisht në Kosovë. Përgjithësisht i duhet kushtuar më shumë vëmendje arsimit dhe trajnimit. Nëpërmjet mekanizmave aktualë të kontrollit dhe mbikëqyrjes, të cilët funksionojnë relativisht mirë, duhet forcuar kontrolli dhe vendimmarrja. Llogaridhënia e cila është aktualisht elementi më i dobët i qeverisjes së sektorit të sigurisë në vendet e Ballkanit Perëndimor, duhet forcuar më tej.

Adresimi i niveleve të pamjaftueshme të qeverisjes demokratike nevojitet veçanërisht në rastet e sektorit privat të sigurisë, i cili duhet rregulluar sipas ligjeve përkatëse dhe duhet mbikëqyrtur siç duhet nga mekanizmat e kontrollit demokratik. Policia dhe shërbimet e inteligjencës janë sektorë të tjerë të sigurisë, ku nevojitet një reformë e mëtejshme.

Konkluzione

Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor vuajnë nga mungesa e kapaciteteve zbatuese. Kjo ndodh ose sepse ekzistojnë pak kapacitete dhe se këto të fundit duhen plotësuar përmes këshillimit dhe asistencës ndërkombëtare, ose sepse arsyet që vështirësojnë zbatimin, janë politikat e këtyre vendeve. Vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të fokusohen në disa sfida për të përmirësuar situatën e bashkëpunimit për çështjet e sigurisë. Për më tepër, nevojitet që këto të fundit të forcojnë bashkëpunimin për zbatimin e reformave në sektorin e sigurisë. Kjo do të thotë se këtyre vendeve do t'ju nevojitet që të përqendrohen tek përpjekjet e përbashkëta për krijimin e qendrave kërkimore të cilat do të vlerësojnë dhe do të kenë akses tek progresi dhe pengesat për zbatimin.

Në këtë kuptim roli i shoqërisë civile është mjaft i rëndësishëm. Kjo përbën thelbin e përpjekjeve të shoqërisë civile për të balancuar pretendimet e shtetit, rreth nevojave për sigurinë dhe politikave si edhe ndihmon për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies. Atyre do t'ju duhet të

përdorin praktikat më të mira të mësuar, jo vetëm prej eksperiencës me BE-në, por edhe prej përpjekjeve për të reformuar sektorin e sigurisë në vendet e Ballkanit Perëndimor. Mësimet e mësuar janë më të aplikueshme, nëse ato nxirren nga kontekste të ngjashme. Mbështetja për trajnimin dhe arsimin, sidomos të menaxherëve të niveleve të mesme në agjencitë e reja për kontrollin e kufijve dhe në sistemet e rinj për këtë, është thelbësore për përmirësime të bashkëpunimit rajonal për sigurinë.

Rajoni ka nevojë për lindjen e një gjenerate të re politike, e cila të mund të largohet prej trashëgimisë konfliktuale. Shoqëria civile në rajon është një kundërpeshë thelbësore kundrejt fuqisë së elitave politike në rajon dhe luan një rol thelbësor për ndërgjegjësimin e publikut mbi problemet e qeverisë. Mbështetja nga BE-ja është efikase për të mbajtur një shoqëri civile të shëndetshme, e cila mbështet transformimin demokratik dhe pajtimin rajonal.

Bibliografi

Libra dhe artikuj:

1. Anastasakis, O. Bojicic – Dzelovic, V. *Balkan Regional Cooperation and European Integration*. (London: School of Economic and Political Science, 2002).
2. Bozinovska, Z. *The Balkan Countries Associate Only Formal*. (Skopje: Nova Makedonija, 2013).
3. Bonne, Anri. *On the Need for Regional Cooperation*. Political Thought Vol. 31 (Skopje: Konrad Adenauer Foundation, Institute for Democracy, 2010).
4. Buzan, B. Wæver, O. *Regions and Powers. The Structure of International Security*. (Cambridge: Cambridge University Press, 2003).
5. Ciuta, F. *Reviewed work(s): Regions and Powers: The Structure of International Security by Barry Buzan; Ole Wæver*. (London: The Slavonic and East European Review, Vol. 83, No. 1. 2005).
6. Delevic, M. *Regional Cooperation in the Western Balkans*. (Belgrade: Institute for Security Studies, 2007).

7. Grim, K. *Integrating the Western Balkans into NATO and EU: Challenges, Expectations and Needs*. Montenegro: Consortium of Defense Academies and Security Studies Institutes, 2007)
8. Grillot, S. Cruise, R. and D' Erman, V. *Developing Security Community in the Western Balkans: The role of the EU and NATO*. (Oklahoma: School of International and Area Studies, University of Oklahoma, 2007).
9. Marenin, O. *Security Sector Reform in the Western Balkans: Assessing Progress*. (Vienna: National Defense Academy, Bureau for Security Policy at the Austrian Ministry of Defense, 2007).
10. Rajkocovski, R. *The Contemporary Identity of the Western Balkans Transformed into Active Regional Security Cooperation*. Political Thought, Vol. 31. (Skopje: Konrad Adenauer Foundation, Institute for Democracy, 2010).

Burime nga Interneti:

1. Albanian Institute of Intelligence and Security Studies. *New Security Threats Impose Western Balkan Countries a New Way of Doing Intelligence*. See: <http://www.aliiss.org/?p=362>
2. Coordination of Research Policies with the Western Balkan Countries. *From Stability Pact to Regional Cooperation Council*. See: <http://wbc-inco.net/object/news/3656>
3. *European Future of the Western Balkans*. (Paris: European Institute for Security Studies, 2013).
4. Federal Ministry for Economic Cooperation and Development. *From Stability Pact to Regional Cooperation Council – Greater Ownership for South Eastern Europe*. See: http://www.bmz.de/en/what_we_do/countries_regions/Central-Eastern-and-South-Eastern-Europe/rat_regionale_kooperation/index.html
5. *Implementing the Renewed Enlargement Consensus*. (Brussels: Commission of the European Communities, 2008).
6. Italian Atlantic Committee. *NATO and the Western Balkans*. See: <http://www.comitatoatlantico.it/en/studi/nato-and-the-western-balkans/>
7. Marshal Center Macedonia. *Regional Aspects of the Security and Defense of the Republic Macedonia*. See: http://www.ecbs.org.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=17:2010-05-06-01-14-26&catid=6:forums&Itemid=21&lang=mk
8. *NATO as a Regional Actor: Shaping the Western Balkan's Security Complex*. (Center for European Policy Evaluation, 2012)
9. *Paktot sto go Izmeni Liceto na Jugoistocna Evropa*. (Setimes, 2007).

10. Regional Academy for Democracy. *Regional Cooperation*. See: <http://www.radwb.eu/2013/about-rad/regional-cooperation>
11. *Regional Cooperation in South Eastern Europe: The Post- stability Pact Period*. Report No. 31. (Skopje: Analytica, 2009).
12. *Regional Cooperation in the Western Balkans: A Policy Priority for the European Union*. Report of the European Commission 2006.
13. Socio – economic and Humanities Research for Policy. *Organized Crime and Corruption Threaten Human Security in the Western Balkans*. See: <http://www.scoopproject.org.uk/1organised-crime-and-corruption-threaten-human-security-in-the-western-balkans.aspx>
14. Stability Pact. *From a Conflict Prevention and Confidence Building Initiative in South Eastern Europe to a regionally – owned Regional Co-operation Council*. See: <http://www.stabilitypact.org/about/SPownershipprocessPortal.asp>
15. The News and Views of South – Eastern Europe. *Western Balkans Intensify Security Co-operation*. http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/features/2013/09/10/feature-01

N/Kol. (R) Kanan Himaj,
Studiues në Qendrën Kombëtare të Sigurisë dhe Mbrojtjes

PERSPEKTIVAT E SIGURISË
DHE ROLI INSTRUMENTIT
USHTARAK NË RAJONIN TONË

Abstrakt

Ballkani po ndryshon me shpejtësi drejt krijimit të një ambienti miqësor. E interesuar dhe e ndikuar nga proceset integruese Euro-Atlantike, si një objektiv madhor, arritja do të mundësojë forcimin e demokracisë në këtë rajon.

Në qendër të shkrimit është vendosur konteksti i ri i sigurisë, ku kërkesat e rajonit ndaj sigurisë do të gjejnë zgjidhje në proceset e bashkëpunimit ndërballkanik e të qasjes integruese në Bashkimin Evropian, i cili me forcën e tij kulturore, ekonomiko-financiare e ushtarake, do të bëjë të rritet e të garantohet siguria e të gjitha vendeve në rajonin tonë. Në këtë kontekst, nuk ka rëndësi sasia numerike e forcës, por efektiviteti i saj në përmbushjen e misionit në shërbim të interesave kombëtare.

Roli i instrumentit ushtarak në formësimin e mjedisit të sigurisë në ditët e sotme është polivalent. Sot ai po merr një karakter më ndërdisiplinor dhe më pak agresiv. Termi “forcë” nuk ka më vetëm kuptimin e një mjete dhune, por shkon shumë më tej, në kuptimin e kapaciteteve të përshtatshme për të kryer një diapazon misionesh në rritje, por edhe të rolit të tyre në shoqëri (brenda shoqërisë, por edhe në marrëdhënie me vende të tjera). Ushtarakët shpesh funksionojnë si shoqëri brenda shoqërive, duke pasur komunitetet e veta ushtarake.

Vetëm zgjidhjet politike të mbështetura nga masat parandaluese me mjete ushtarake apo përdorimin efektiv të një mjete të tillë të fuqishëm mund të çojnë në rezultate që zgjasin sigurimin e rendit, stabilitetit dhe sigurisë në një botë më të sigurt dhe demokratike.

Hyrje

Ngjarjet në fillim të këtij shekulli kanë shkaktuar një proces transformimi të thellë në mjedisin e sigurisë në rajonin tonë. Ato kanë gjeneruar pasoja të cilat kanë ndikuar fuqishëm në komunitetin kombëtar, atë Ballkanit¹ dhe më gjerë. Njohja, kuptimi dhe vlerësimi i saktë i proceseve të përshkuara nga vendet e rajonit kërkojnë më shumë energji të përbashkëta për modernizimin e jetës së tyre në modelin evropian duke lënë mbrapa çështje të historisë së vjetër.

Në ditët e sotme, rajoni ynë po përjeton ndryshime të dukshme në aspektin politik, ekonomik, ushtarak e të tjerë, përfshi aderimin në NATO dhe organizmat e tjera të sigurisë në Evropë. Si rrjedhojë e tyre, rezultatet për modernizimin e vendit, rritja e sigurisë dhe nivelit të jetës së komunitetit janë të dukshme. Pjesë e rëndësishme e këtij transformimi kanë qenë edhe sektori ushtarak në të gjitha dimensionet konceptuale, strukturore, teknologjike, kodit të sjelljes, e të tjerë. Arritja e objektivave politike e strategjike nga vendet e rajonit për integrim të plotë në BE dhe NATO, për ruajtjen e paqes e sigurisë, është një angazhim sa individual, aq dhe kolektiv.

Ballkani tanimë ka hyrë në një rrugë të re, e cila ka një bazë të gjerë ku mbështetet. Pas disa vitesh luftëra dhe probleme madhore, po gjenden pikëpamje progresive të përbashkëta. Është e rëndësishme që vendet e rajonit kanë një sistem politik demokratik dhe kanë në themel ekonominë e tregut të lirë, aspirojnë anëtarësimin në Bashkimin Evropian, disa prej tyre janë anëtarë ose aspirojnë aktivisht për anëtarësimin në NATO.

¹**Ismail Kadare:** “Në këtë botë mund të ndodhin gjithfarë gjëmash, por është e vështirë që një popull ballkanas të mund të thyhet nga një tjetër popull ballkanas. Kur popujt e gadishullit të ndërgjegjësohen për këtë të vërtetë, kur ata të kuptojnë se i vetmi shans për ta është e kundërta e konfliktit, ata do të vihen vërtet në rrugën e shpresës”

1. Sfidat e sigurisë, problematika në rajonin tonë

Sfidat ndaj sigurisë në rajon janë të natyrave të ndryshme dhe jo vetëm ushtarake, prandaj përballimi i tyre kërkon kontribute kolektive si të shteteve të rajonit, ashtu dhe të komunitetit ndërkombëtar, në bashkëpunim me aktorë ushtarakë dhe civilë, në mënyrë të veçantë për t'u larguar nga konfliktet e vjetra ballkanike².

Rajoni ynë ka hyrë në një rrugë të re, në atë të evropianizimit dhe bashkëpunimit me tërë aktorët ndërkombëtarë të sigurisë. Analizat gjeopolitike për rajonin kanë nxjerrë në pah se ende ekzistojnë rreziqe të ndryshme që janë kërcënim jo vetëm për Ballkanin, por edhe për sigurinë evropiane. Rajoni, përfshi edhe vendin tonë, është i ekspozuar ndaj sfidave dhe rreziqeve të reja si terrorizmi, përhapja e armëve të shkatërrimit në masë, migrimi ilegal, krimi i organizuar, droga dhe trafikimi i qenieve njerëzore si dhe ekzistenca ende e disa “konflikteve të ngrira” të cilat mund të bëhen aktive midis kombësive apo vetë shteteve ballkanike. Në vijim të kësaj logjike, rajonit tonë i imponohet nevoja e përpjekjeve të përbashkëta për projektin e sigurisë dhe stabilitetit.

Të gjitha politikat dhe strategjitë e vendeve të rajonit në themelin e tyre kanë vendosur ruajtjen e vlerave të tilla si liria, sovraniteti, integriteti territorial, rendi demokratik, mbrojtja e shëndetit, jetës, të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Të gjitha këto janë të lidhura me kredibilitetin e shtetit, të bazuar në aftësinë për të përmbushur detyrimet e vendit që rrjedhin nga traktatet dhe marrëveshjet ndërkombëtare, si dhe aftësinë për zgjidhjen e situatave kritike për të përballuar

² **Konflikti i armatosur që ndodhi në territorin e ish-Jugosllavisë** në periudhën 1991-2001 mori jetën e mbi 200.000 njerëzve. Konflikti Ballkanik ishte një pjesë e fenomenit të përgjithshëm të tranzicionit të periudhës pas-komuniste të Evropës. Për më gjerë shih: Vepra interesante e Marina Glamoëak, *La transition guerrière yougoslave*, Paris: L'Harmattan, 2002. Kjo është një nga studimet e pakta që shikojnë këtë aspekt të problemit Jugosllav, i cili ndodh sistematikisht. “The Balkans”. <http://en.wikipedia.org/wiki/Balkans>.

kërcënimet e dhunës dhe agresionit. Prandaj, siguria dhe mbrojtja janë në fokusin e vëmendjes së shtetit e qytetarëve të të rajonit.

Koncepti i sigurisë kolektive mund të jetë i ndërlikuar. Në një nga përcaktimet ai përkufizohet si “një sistem i rregullt botëror, në të cilin pësha e komunitetit të tërë ndërkombëtar do të hidhet kundër çdo agresioni të ndërmarrë nga ndonjë shtet, siç parashikohet në deklaratën e Kombeve të Bashkuara”³. Analiza strategjike e mjedisit të sigurisë rajonale kryhet në disa dimensione themelore të cilat lidhen me vlerësimin e situatës nga pikëpamja politike dhe strategjike e çdo vendi. Secili shtet në rajonin tonë, duke e parë në këtë këndvështrim, ka qëllimin të identifikojë sfidat më të mundshme në një mjedis dinamik ndryshimi gjeopolitik. Dimensionet strategjike të mjedisit të sigurisë janë të një rëndësie të veçantë dhe veçori për secilin shtet në rajonin tonë, në varësi të rrethanave.

Në Ballkan mbeten ende vatra të nxehta, ku mund të përmenden Bosnje-Hercegovina, Mitrovica (Veriu i Kosovës), si dhe vazhdimi i problematikës së shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, por edhe problemet etnike në Maqedoni.

Tashmë në vlerësimin e përgjithshëm, vendet e rajonit në strategjinë e secilit vlerësohen nga dimensionin politik dhe ligjor, i cili përfshin identifikimin e aleatëve. Rajoni ynë i ka kapërcyer në tërësi pengesat, duke përfshirë vlerësimin në rritjen e sigurisë nga vetë pozicionimi i NATO-s, BE-së, OSBE-së dhe OKB-së. Secili vend ka edhe specifikat e veta në traditë, kulturën kombëtare, por marrëdhëniet ndërmjet vendeve aleatë janë ndërtuar mbi kontributet dhe interesat e përbashkëta. Organizmat ndërkombëtare të sigurisë dhe ato të sistemit të së drejtës ndërkombëtare kanë rol dhe status të veçantë. Menaxhimi krizave dhe zgjidhja paqësore e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare dhe rajonale janë të një rëndësie në rritje. Ato

³ Koncepti Strategjik për Mbrojtjen dhe Sigurinë e anëtarëve të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut Miratuar nga Krerët e Shteteve dhe Qeverive në Lisbonë, Nëntor, 2010

kanë ndikim në vendimet politike mbi përdorimin e forcave të armatosura dhe në kufizimin e kushteve për vendosjen e tyre.

Po kështu, në kushtet e vendeve të rajonit, dimensionin ekonomik dhe social merr rëndësi të veçantë në përcaktimin e burimeve për të zgjidhur një situatë të caktuar dhe paraqet komponentin më të rëndësishëm të të gjitha proceseve të zhvillimit në mjedisin strategjik. Në këto kushte, fuqia e ekonomisë së një vendi përcakton nivelin e zhvillimit në fushat e tjera (shkencore dhe teknologjike, nivelin e shoqërisë), përfshi rolin dhe nivelin e zhvillimit të forcave të armatosura të tij. Ato kanë ndikim të drejtpërdrejtë në trazira apo aktivitete të tjera kërcënuese të brendshme, stabilitetit të shoqërisë dhe të rendit publik.

Dimensioni ushtarak në rajon është fokusuar në potencialin luftarak me ndikim në zhvillimin e mjedisit strategjik dhe në realizimin e objektivave strategjike nga aleatët ndërkombëtarë apo vendet rajonale. Përveç kësaj, ky dimension merr parasysh veprimtarinë brenda kornizave të rendit demokratik dhe kushtetues, veprimtarisë së gjerë me natyrë paqebërësi dhe mbrojtjen e saj; mundësitë dhe llojet e dislokimit të forcave të armatosura, qasjet e mundshme për zhvillimin e operacioneve të luftës dhe ndikimin e tyre në aftësinë e forcave të armatosura jo vetëm brenda vendit, por edhe jashtë tij.

Dimensioni fizik lidhet me dimensionin ushtarak, pasi ai paraqet elementet e mjedisit fizik që ndikojnë në kushtet për zgjidhjen e konfliktit dhe të krizës duke përfshirë kushtet gjeografike, elementët e terrenit, motin, burimet natyrore dhe produktet strategjike në rajonin e Ballkanit dhe më gjerë. Këta faktorë të cilët, nga pikëpamja e operacioneve ushtarake kanë ndikim, mund të jenë nxitës ose frenues në zhvillimin e proceseve në të gjitha dimensionet e tyre.

Ndër rreziqet dhe kërcënimet ndaj sigurisë dhe stabilitetit rajonal, janë: ekzistenca ende (ndonëse me një intensitet të ulët) e konflikteve etnike, fetare dhe ideologjike të pa zgjidhura; terrorizmi ndërkombëtar; intensifikimi i trafiqeve ilegale të armëve të vogla, materialeve strategjike, trafikimit të narkotikëve, përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe

mjetet jo konvencionale vdekjeprurëse; mundësia e aktiviteteve të paligjshme, ilegale, terroriste në Detin Adriatik e Jon, në Mesdhe, Egje e deri në Detin e Zi; vështirësitë ekonomike, financiare dhe problemet sociale; zgjerimi i krimit të organizuar, krimit ekonomik dhe financiar, trafikimit të mallrave dhe kontrabandës njerëzore; rritja e aksidenteve automobilistike, teknologjike apo fatkeqësitë natyrore në afërsi të kufirit dhe në rajon; ngjarjet e paparashikuara të tilla si përmytjet, tërmetet, aksidentet ekologjike, kriza sociale që mund të ndikojë te publiku, ekonomia dhe stabiliteti politik.

Mekanizmat dhe aleancat mund të provojnë efikasitetin e tyre në zgjerimin e demokracisë nëpërmjet iniciativave të bashkëpunimit ekonomik, partneritetet dhe marrëdhëniet dypalëshe e shumëpalëshe, rezultati i të cilave mund të gjenerojë ndërtimin e nevojshëm të sigurisë dhe stabilitetit. Kjo është arsyeja pse ne kemi nevojë të ndërtojmë në këtë hapësirë, shtyllat e sigurisë ekonomike, politike dhe ushtarake të cilat, në të ardhmen, duhet të zgjerohen në hapësirë duke kontribuar në menaxhimin apo zbutjen e tensioneve dhe krizave.

Pavarësisht disa dallimeve, perceptimet e sigurisë janë të ngjashme në të gjitha vendet e rajonit. Për shembull, koncepti i mbrojtjes dhe sigurisë në Maqedoni përcakton terrorizmin, krimin e organizuar, migracionin e paligjshëm, trafikimin e paligjshëm të drogave, armëve, njerëzve dhe korrupsionin. Mali i Zi liston kërcënimet si kontrabandë të drogës dhe armëve, emigracionit të paligjshëm, trafikimin njerëzor dhe përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë. Po kështu, në shtete të tjera të rajonit shfaqen fenomene të tilla si përhapja dhe rritja e forcave të krimit të organizuar, një nga rreziqet më të mëdha të sigurisë në Ballkan.

Tranzicioni nga sundimi komunist në demokraci, luftërat në rajonin e Ballkanit në vitet 1990, si dhe prania e shteteve të dobëta në kontekstin e pasluftës krijuan kushte të favorshme për rrjetet e krimit të organizuar. Ato gjejnë shprehjen e tyre në trafikimin e paligjshëm të mallrave (të tilla si armëve dhe drogës), krimin ekonomik, pastrimin e parave, organizimin e emigracionit të paligjshëm dhe trafikimit të qenieve njerëzore.

Terrorizmi ka gjetur ambient të përshtatshëm në konflikte nacionale dhe etnike. Grupet minoritare, qoftë të pakënaqurit me statusin e tyre ose lëvizjet e forcuara nacionaliste, munden lehtësisht të bëhen organizatorët e terrorizmit.

Ekzistenca e armëve të vogla dhe të lehta (AVL) jashtë kontrollit të shteteve ndikon për nxitje të konflikteve dhe lidhet ngushtë me shqetësimet aktuale në rajon për sasinë masive të armëve dhe pajisjeve të tjera ushtarake, sidomos për numrin e madh të armëve të zjarrit, të importuara gjatë konfliktit në ish Jugosllavinë, rënia e pjesshme e shtetit Shqiptar në vitin 1997, të cilat kanë ushqyer kontrabandën e armëve. Në mjedisin e papunësisë së lartë, qeverisja e dobët, korrupsioni e të tjerë, krijojnë disa alternativa për zgjidhjen e problemeve me dhunë.

2. Vizioni për të promovuar stabilitet, paqe dhe siguri

Si një vend anëtar i NATO-s në rajon, interesi i vendit tonë është që vendet fqinje të jenë me stabilitet, të aftë për të ruajtur paqen dhe mirëkuptimin mes tyre, krijimin e komuniteteve pluraliste rajonale dhe të ketë një sjellje të parashikueshme në lidhje me sigurinë. Ndërtimi i klimës së sigurisë, stabilitetit dhe prosperitetit në rajon kërkon një orientim të veçantë të kësaj strategjie. Shqipëria, e cili dëshiron të jetë një element dinamik i prosperitetit demokratik, sigurisë dhe stabilitetit, ka interes strategjik që ky rajon të jetë stabël, demokratik, i lidhur ngushtë me strukturat evropiane dhe euro-atlantike. Objektivi strategjik përcaktohet nga rëndësia gjeopolitike e rajonit si një zonë e rëndësishme e burimeve të energjisë dhe në të njëjtën kohë, një hapësirë e rëndësishme me një ndikim të konsiderueshëm mbi sigurinë Euro-Atlantike.

Nga pikëpamja energjetike dhe sfidave të sigurisë, rajoni paraqet interes për shkak të pozicionit strategjik dhe transit (Gazsjellësi TAP) në lidhjen e Evropës me burimet e energjisë. Gjithashtu, mund të dilet në një përfundim, se koha sjell probleme të ndjeshme dhe pamundësi për të ushtruar atributet

e shteteve dhe konflikte deri në tensione midis vendeve të rajonit. Në vijim, kriminaliteti ndërkuftar gjen mbështetjen për anarki, shfrytëzim të veprimeve të kontrabandës dhe kriminalitetit e të tjerë dhe krijojnë vështirësi në funksionimin e drejtë të marrëdhënieve rajonale dhe më gjerë.

Kundërveprimi ndaj këtyre kërcënimeve është një përgjegjësi e madhe e shteteve në rajon. Ata duhet të jetë të vetëdijshëm për ekzistencën e këtyre fenomeneve, të zhvillojnë politika të brendshme e të jashtme për t'i neutralizuar ato dhe të për afrojnë bashkëpunimin dhe mirëkuptimin.

Vendet në rajonin tonë, më shumë se kurrë, sot duhet të bashkëpunojnë në mënyrë aktive dhe efektive, të promovojnë masa të destinuara për të rritur besimin në rajon dhe për të përmbushur detyrimet lidhur me reduktimin e rreziqeve të tilla. Në të njëjtën kohë, duke filluar nga koncepti i sigurisë në hapësirën Euro-Atlantike, në përputhje me kërkesat e globalizimit, nga nevoja për një trajtim të barabartë për të gjitha shtetet e rajonit me interesa legjitime në zonë, duke përfshirë NATO-n dhe Bashkimin Evropian, ne konsiderojmë se është një hapësirë gjeopolitike e hapur për komunitetin demokratik ndërkombëtar.

Për sa më lart, ato duhet të promovojnë një strategji euro-atlantike dhe evropiane, duke marrë parasysh përvojën e NATO-BE, qasje në procesin e stabilizimit në Evropën Jug-Lindore dhe nevojën e një balance të aftë për të favorizuar shtetet të parandalojnë rritjen e rreziqeve dhe kërcënimeve, në mënyrë efektive të kontribuojnë në zgjidhjen e konflikteve dhe tensioneve. Zgjerimi i përgjegjësive në stabilizimin dhe rindërtimin e rajonit, konsolidimin e pranisë së organizmave të sigurisë ndërkombëtare dhe kontributin në procesin e promovimit të demokracisë, paqes dhe sigurisë, janë faktorë për të kontribuar në zbatimin e një strategjie të tillë.

Në këtë kontekst, prioritetet e Shqipërisë janë: harmonizimi dhe përmirësimi i proceseve të vazhdueshme të bashkëpunimit institucional; krijimi i një dialogu të ri dhe të kuadrit të bashkëpunimit me pjesëmarrjen e të gjitha shteteve rajon. Për këtë, do të duhet të veprojnë në mënyrë të vendosur për të promovuar demokracinë dhe zhvillimin ekonomik, sigurinë e

energjisë, duke rritur stabilitetin, paqen dhe sigurinë. Vendi ynë duhet të bashkëpunojnë ngushtë me shtetet në rajon Kosovën, Maqedoninë, Serbinë, Malin e Zi, me shtetet e tjera fqinje dhe gjithashtu me të tjera shtete anëtare të bashkësisë Euro-Atlantike.

Njëkohësisht, Shqipëria duhet të mbështesë aktivisht zhvillimet e reja në rajon, për të lehtësuar bashkëpunimin me të gjitha shtetet anëtare të BE-së, të cilat do të stimulojnë zhvillimin e infrastrukturës së energjisë dhe të transportit, të nxitjes së tregtisë, investimeve dhe mekanizmave të ekonomisë së tregut të lirë. Për zgjidhjen e konflikteve rajonale, vendi ynë të përdorë të gjitha mundësitë për të ruajtur axhendën e aktorëve kryesorë të sigurisë, për të promovuar një veprimtari konkrete dhe aktive duke përfshirë mekanizmat që synojnë zgjidhjen e konflikteve në mënyrë paqësore.

Mosefikasiteti i disa prej mekanizmave të përdorura deri tani për të zgjidhur konfliktet dikton nevojën për të riparë përfshirjen e vendeve dhe organizatave me kontribut pozitiv. Brenda një strategjie të tillë, është e nevojshme të krijohet një grup parimesh, normash dhe rregullash të sjelljes, në përputhje me interesat e komuniteteve brenda rajonit, me interesat e komuniteti Euro-Atlantik dhe dispozitat e ligjit ndërkombëtar, të aftë për t'iu përgjigjur në mënyrë adekuate për dallimet specifike për secilin konflikt.

Për të promovuar këto parime, Shqipëria kërkon të jetë e përfshirë drejtpërdrejt në procesin e zgjidhjes paqësore të konflikteve dhe mosmarrëveshjeve në rajon, me veprime shumëpalëshe, duke synuar të nxisë dhe mbështesë përpjekjet për t'iu afruar Evropës dhe strukturat euro-atlantike për përmirësimin në vijimësi të sigurisë.

Dimensioni ekonomik ka një rol të rëndësishëm në ndërtimin e sigurisë brenda rajonit. Kështu, politika e jashtme ekonomike e Shqipërisë, bashkëpunimi i saj duhet të jenë pragmatike dhe vendi ynë duhet të përdorë në mënyrë efektive mjetet e siguruara nga formatet bilaterale dhe multilaterale, në mënyrë që të marrë pjesë në projekte të mëdha që synojnë konsolidimin e demokracisë. Ato të synojnë zhvillimin e energjisë dhe transportit, korridore të afta për të lidhur rajonin dhe të lejojnë kapitalizmin e potencialit të ofruar nga portet detare në detin Adriatik dhe Jon.

Në të njëjtën kohë, është e nevojshme një vëmendje e veçantë për mbrojtjen e mjedisit, duke ruajtur potencialin dhe rithemeluar funksionet e shumta të ekosistemit në rajonin e Ballkanit. Kështu mund të mbështesin zhvillimin e nismave rajonale në lidhje me aftësitë për t'iu përgjigjur krizës dhe kërcënimeve asimetrike si edhe mund të përmirësohet kuadri ligjor i favorshëm për rritjen e besimit midis shteteve të tjera të interesuara në sigurinë rajonale.

3. Nevoja për një dinamikë të re për çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes

Mjedisi aktual i sigurisë në rajonin tonë është i ndikuar nga ndryshimet e vazhdueshme dhe transformimet që mund të gjenerojnë rreziqe dhe kërcënime të reja. Në këtë kontekst, po bëhet gjithnjë e më e qartë se interesi i rajonit dhe objektivat e sigurisë mund të realizohen me bashkëpunim rajonal dhe më gjerë. Kjo kërkon veprim të përbashkët të shteteve që ndajnë interesa dhe vlera të përbashkëta⁴.

Rreziqet e një konfrontimi të madh ushtarak në kontinent kanë rënë dukshëm. Megjithatë, ka ende premisa të destabilitetit dhe krizës në nivel nënrajonal, si dhe tendenca të marginalizimit ndaj fragmentarizmit ose izolimit në mesin e shteteve të caktuara.

Kërcënimi ndaj sigurisë në rajonin tonë mund të shfaqet nga paqëndrueshmëria politike, frenimi i zhvillimeve demokratike, si dhe nga krijimi i situatave jo të favorshme ekonomike, të cilat bëjnë të ngrenë kokë qëndrime e veprime ekstremiste.

Shtetet në rajon ndajnë vlerat dhe parimet demokratike dhe kanë një histori të përbashkët rajonale. Ato duan të

⁴**Siguria Shtetërore** lidhet më shumë me masat për sigurinë dhe mbrojtjen tradicionale të vendit dhe ka të bëjë kryesisht me ruajtjen e sovranitetit, mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe të pavarësisë. Shqipëria, në përputhje me Nenin 5 të Traktatit të Uashingtonit, respekton parimin themelor të sigurisë dhe mbrojtjes kolektive.

bashkëpunojnë, por ende nuk kanë harmonizim të plotë të axhendës politike dhe ushtarake. Kjo është arsyeja pse ajo është e domosdoshme për të krijuar institucione të reja dhe për të zhvilluar projekte të reja e të përbashkëta të cilat duhet të jenë konkrete dhe specifike. Ato mund të jenë në forcimin e bashkëpunimit të ngushtë dhe pjesëmarrjes në strukturat shumëkombëshe ushtarake; sigurimin e komplementaritetit me iniciativat e sigurisë së Bashkimit Evropian, veçanërisht në drejtim të kërcënimeve të lidhura me krimin e organizuar, emigracionin ilegal, trafikimin e qenieve njerëzore. Po kështu, mund të jenë në drejtim të konsolidimit dhe kompletimit të masave të lidhura me rritjen e besimit, specifike për këto fusha, duke përfshirë formulat e bashkëpunimit rajonal ushtarak; parandalimin e kërcënimeve asimetrike duke rritur kapacitetet e reagimit dhe duke iu përshtatur mekanizmave për zgjidhjen e objektivave të përbashkëta të sigurisë në zonën Euro-Atlantike; riorganizimin e forcave të armatosura, përmirësimin i kontrollit civil mbi forcat e armatosura dhe bashkëpunimin midis fushën e sigurisë.

Në nivel rajonal, Shqipëria promovon stabilitetin nga zhvillimi i nismave brenda rajonit si pjesëmarrja në operacionet shumëkombëshe në mbështetje të paqes; bashkëpunimi bilateral dhe multilateral ushtarak; përmbushjen e angazhimeve ndërkombëtare dhe detyrimeve në lidhje me kontrollin e armatimit, çarmatimin dhe parandalimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë.

Si një vend anëtar i NATO-s, ajo konsiderohet sot një vend me siguri të mirë, por nga ana tjetër ajo ka për të përmbushur standardet ekonomike dhe institucionale, si një vend pretendent për t'u anëtarësuar në BE. Për shkak të pozicionit të saj gjeostrategjik, hapave dhe përvojës në proceset demokratike, së bashku me vendet e tjera në Ballkan⁵, Shqipëria përfaqëson një

⁵ **Gadishulli i Ballkanit**, gjerësisht referuar si Ballkani, është një rajon gjeografik dhe kulturor i Evropës Juglindore. Rajoni ka emrin e vet nga malet e Ballkanit që shtrihen nga lindja e Bullgarisë për shumë lindje të Serbisë. Rajoni është i banuar kryesisht nga grupet etnike sllave (bullgarët, maqedonasit, serbët, kroatët, goranët, malazezët, boshnjakët), edhe nga rumunët, grekët, turqit, shqiptarët, si dhe grupet e tjera etnike të cilat paraqesin pakicat në vende të caktuara si populli romë, arumunët, ashkali etj.

vend me një rol të rëndësishëm. Bashkëpunimi i këtyre vendeve, në të gjitha nivelet, përfshi atë ushtarak, është i nevojshëm dhe i dobishëm për të ruajtur sigurinë si dhe për të ndikuar edhe në zgjidhjen e disa “konflikteve të ngrira”.

Përfundimi i procesit të stabilizimit, sidomos në Ballkan është një çështje e rëndësishme në axhendën e BE-së. Shqipëria, si një vend anëtar në NATO, OKB, OSBE, KiE dhe kandidat për anëtar në BE, është një aktore e rëndësishme në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe po kontribuon në menaxhimin e përbashkët të rreziqeve dhe kërcënimeve. Dinamikat e ndryshme në rajon dhe hapësirat rreth tij, të cilat nuk mund të parashikohen gjithmonë, nënkuptojnë zgjidhje dhe veprime të afta për të dhënë zgjidhjen përmes bashkëpunimit të përhershëm në Ballkan.

Në rajonin tonë kahu i tendencave është pozitiv për njohjen, kuptimin dhe vlerësimin e proceseve të brendshme për nga shkalla kohezionit, duke rritur aftësinë e mobilizimit publik për projektet kombëtare dhe ato rajonale. Përpjekjet e përbashkëta synojnë: përcaktimin objektiv të kërcënimeve dhe rreziqeve të përbashkëta dhe monitorimin e tyre; krijimin e mënyrave efikase për të kundërvepruar në kohën e duhur dhe me kontributet reale të vendeve pjesëmarrëse, pavarësisht nga distanca dhe kufijtë; organizimin dhe mbrojtjen e territorit, sigurisë së qytetarëve dhe mallrave, ruajtjen e institucioneve dhe infrastrukturës kritike ndaj rreziqeve dhe kërcënimeve të reja.

4. Roli i Forcave të Armatosura, element i rëndësishëm për mbrojtjen dhe sigurinë

Aktualisht, në zhvillimin e Forcave të Armatosura në rajon e më gjerë po shihet tendenca e reduktimit të numrit, por kjo

Feja më e madhe në Ballkan është Krishtërimi Orthodhoks, e ndjekur nga katolike krishterimit dhe islamizmit sunit. Sipërfaqja e përgjithshme e Ballkanit është 257.400 kilometra katrorë dhe popullsia totale është 59.297.000 (2002). Ballkani takohet me Detin Adriatik në veriperëndim, Detit Jon në jugperëndim, Mesdhe dhe Deti Egje në jug dhe juglindje, Detit të Zi në lindje dhe verilindje. Pika më e lartë e Ballkanit është mali Musala 2.925 metra (9596 ft) mbi malet Rila në Bullgari.

po kompensohet me cilësinë, nëpërmjet modernizimit të tyre, në aspektin konceptual dhe të pajisjeve e armatimeve. Elitat politike po përpiqen për të përmirësuar nivelin e tyre, paralelisht me përpjekjet për rritjen ekonomike, pasi një ekonomi e fortë gjeneron energji pozitive për të gjithë sektorët e sigurisë, stabilitetit dhe mbrojtjes.

Tashmë, elementët e sigurisë janë bërë më pak të dukshme, duke qenë më pak intensivë se më parë. Karakteristika kryesore e kësaj dekade është mungesa e rrezikut në kuptimin klasik të një konflikti të madh me intensitet të lartë. Megjithatë, sot kërcënimet paraqesin një rrezik real ndaj sigurisë rajonale dhe globale. Nga ana tjetër, për shkak të globalizimit, dimensionet e sigurisë gjysmë-ushtarake dhe joushtarake janë gjithnjë e më të rëndësishme për të gjithë komunitetin ndërkombëtar, pavarësisht nga distanca me rajonin ku ato kanë gjeneruar. Për këto arsye, roli i instrumentit ushtarak në formësimin e mjedisit aktual të sigurisë ka marrë tipare polivalente, një karakter ndërdisiplinor dhe më pak agresiv.

Komplementariteti mes instrumenteve të fuqisë ushtarake dhe atyre joushtarake për të zgjidhur krizën dhe konfliktin, është çështje e rëndësishme edhe për rajonin tonë. Vetëm zgjidhjet politike të mbështetura nga masat e parandalimit përmes mjeteve ushtarake apo përdorimin e efektiv të këtij instrumenti të pushtetit mund të çojnë në rezultate të qëndrueshme sigurimin e stabilitetit, rendit dhe sigurisë në rajonin e Ballkanit. Në këtë kontekst, ndërkombëtarizimi i procesit të sigurimit të rajonit paraqet një mekanizëm me efekt të madh për të siguruar stabilitetin dhe paqen në rajon. Kjo është favorizuar edhe nga prania politike, ekonomike dhe ushtarake e NATO-s dhe BE-së.

Në procesin e stabilitetit dhe paqes në rajon, vendi ynë dhe ushtria e tij e shohin partneritetin si një angazhim për të përmirësuar marrëdhëniet dypalëshe dhe shumëpalëshe, me qëllim parandalimin e përplasjeve, duke promovuar vlerat trans-atlantike të sigurisë si vend anëtar i NATO-s, për ndërveprimin në menaxhimin e krizave, bashkëpunimin në sigurimin e kufijve, menaxhimin e emergjencave civile, e të tjerë. Gjithashtu, mund të shtojmë pjesëmarrjen në ndihmën

e dhënë ndaj vendeve fqinje në çështjet e reformës së mbrojtjes dhe zhvillimit të programeve të modernizimit, konceptit të përgatitjes së dokumenteve kryesore të planifikimit; shkëmbimit të përvojës, kryesisht për platformën në hartimin e dokumentit të planit kombëtar vjetor për çështjet e mbrojtjes. E tillë ka qenë konferenca shkencore mbi “Smart Defence”, zhvilluar në Prishtinë, për prezantimin e disa dokumenteve të reja për metodologjinë e hartimit të Dokumentit të Rishikimit të Mbrojtjes; shkëmbimi i eksperiencës në fushën e integritit në NATO dhe BE⁶, ku janë prezantuar hartimi i dokumentit të Planit Kombëtar Vjetor për çështjet e mbrojtjes (për ciklin e MAP dhe PARP).

Me shumë vëmendje dhe interes kanë qenë edhe zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta në fushën e mbrojtjes për kontrollin e armëve, zbatimi i marrëveshjeve reciproke, të cilat kanë rritur besimin e ndërsjellë në rajon. Model i qëndrueshëm bashkëpunimi ka qenë pjesëmarrja aktive në marrëveshje të ndryshme si SEEBRIG, e cila ka përfaqësuar një instrument luftarak ndaj rreziqeve dhe kërcënimeve asimetrike, ka intensifikuar dialogun shumëpalësh për zgjidhjen e krizave, si dhe ka marrë pjesë në mjaft aktivitete në kuadër të OKB-së, NATO-s, BE-së, OSBE-së dhe në mbështetjen e operacioneve.

Forcat tona të Armatosura kanë plane bilaterale bashkëpunuese me ushtritë e vendeve fqinje për shumë fusha si stërvitjet e përbashkëta, trajnimet, për arsimin, llojet e forcave e të tjerë. Të veçanta janë aktivitetet sipas forcave (tokësore, ajrore dhe detare) me objektiv ndërveprimin rajonal ndërmjet forcave ushtarake. Aktivitete të tilla kanë ndikuar në rritjet e rolit të bashkëpunimit rajonal, të cilat në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare BE, OSBE,

⁶ **The European Union Institute for Security Studies (EUISS):** Bashkimi Evropian ka konfirmuar përkrahjen e saj pa ekuivok se e ardhmja e Ballkanit Perëndimor është brenda Bashkimit Evropian. Ndërsa Shqipëria, Bosnja - Hercegovina dhe Kosova ende konsiderohen si kandidatë potenciale “për anëtarësim në BE, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia e kanë bërë një hap përpara në procesin e zgjerimit dhe zyrtarisht kanë statusin e kandidatit nga Këshilli i Bashkimit Evropian.

NATO, OKB, kanë kontribuar pozitivisht në rritjen e nivelit të sigurisë dhe besimit rajonal, pjesë e arkitekturës evropiane të sigurisë. Krijimi i koalicioneve, zhvillimi i solidaritetit funksional, rigjallërimi dhe konsolidimi i iniciativave të integruara dhe masat konkrete për të siguruar kapacitete efektive operacionale në luftën kundër terrorizmit dhe të tjera kërcënime e rreziqe ndërkufitare, përfaqësojnë disa prej çështjeve të bashkëpunimit.

Në këtë kontekst është i domosdoshëm zhvillimi i dialogut për çështjet ushtarake brenda zonës dhe me partnerët strategjikë. Gjithashtu, ato të ruajnë dhe zhvillojnë aftësitë ushtarake, autonominë për t'u përgjigjur për krizat dhe sfidat e ardhshme dhe të përcaktojnë më qartë se si e mendojnë përdorimin e përbashkët të burimeve të mbrojtjes. Dallimet midis aktorëve në rajon nuk përbëjnë pengesë në përpjekjet stabilizuese, për aq kohë sa asnjëri prej tyre, shteti ose aktorë joshitetërorë, mund të kontrollojë proceset komplekse në rajon.

Vendi ynë kontribuon në sigurinë dhe stabilitetin përmes përpjekjeve të përbashkëta duke përshtatur veprimtarinë dhe standardet me dispozitat e programeve kombëtare me strategjinë e vendeve moderne dhe në veçanti atë të Aleancës Euro-Atlantike. Këto përpjekje synojnë promovimin e demokracisë, paqes dhe stabilitetit me vendet fqinje duke reduktuar dobësitë, zhvillimin e aftësive kombëtare dhe transformimin e thellë të institucioneve të sigurisë dhe mbrojtjes.

5. Konkluzione/rekomandime

Procesi i integritimit në strukturat Euro-Atlantike është një proces gjithëpërfshirës për vendet e rajonit. Vetë ky integrim kërkon më shumë punë për forcimin e konsolidimit dhe demokracisë, të ekonomisë, me qëllim krijimin e një ambienti të përshtatshëm të sigurisë dhe mirëqenies.

Në këto momente është e pritshme që pjesë e rëndësishme e politikës së vendeve të rajonit, do të jenë marrëveshjet

bilaterale dhe multilaterale të monitoruara nga institucionet prestigjioze ndërkombëtare për ruajtjen e paqes e të sigurisë, jo vetëm për zhvillimin e tyre, por për një bashkëpunim konkret në të gjitha fushat, si mënyra më e mirë për anëtarësimin e tyre në institucionet e sigurisë.

Rikonceptimi i rolit të forcave të sigurisë dhe mbrojtjes, si dhe rolit të tyre në mjedisin e ri të sigurisë, mund të progresojë më shpejt nëpërmjet bashkëpunimit me aktorë të tjerë brenda dhe jashtë vendit. Aktualisht në rajon janë identifikuar dhjetra ide dhe aktivitete të nivelit rajonal për fushën e mbrojtjes. Përtej kësaj, ato duhet të zhvillohen dhe diskutohen në tryeza të rrumbullakëta, të bazuara në një qasje të qartë, pasi rruga është e hapur për debate dhe diskutime për të mirën e vendeve tona. Aftësitë e mbrojtjes duhet të zhvillohen duke qëmtuar atë çka është pozitive te secili vend i rajonit dhe brenda standardeve të vendeve anëtare të NATO-s.

Një fushë e gjerë për reformim e bashkëpunim mbetet sistemi i planifikimit të mbrojtjes. Edhe këtu, reformat kërkojnë një vullnet të fortë politik në nivel kombëtar dhe rajonal. Kjo do të kërkojë rregullime të reja të standardeve dhe bazës ligjore nga vendet e rajonit, të cilat janë anëtarë të NATO-s apo aspirantë, anëtarë apo aspirantë për në BE. Ndryshimet e reja duhet të pasqyrohen në dokumentet e strategjive të sigurisë kombëtare dhe strategjitë ushtarake të vendeve tona në rajon. Ato duhet të udhëhiqen nga prania e sfidave të përbashkëta, të cilat menaxhohen më mirë nëpërmjet qasjeve rajonale, gjetjes së zgjidhjeve më të mira në interes të përbashkët rajonal.

Ulja e shpenzimeve ushtarake po çon në një humbje neto të aftësive kolektive. Siç ka pak shpresë për ndonjë rritje të shpenzimeve për të ardhmen, zgjidhja e vetme është bashkimi i përpjekjeve dhe kontributeve për interesa të nevojshme dhe të përbashkëta. Kjo mund të jetë e vetmja mënyrë jo vetëm për të ruajtur aftësitë bazë, por edhe për të zhvilluar aftësi të reja; zbatimi dhe gjenerimi i efikasitetit ushtarak si një mjet i nevojshëm dhe çlirimi nga pajisje të vjetra, promovimi i teknologjisë së re ushtarake për zgjerimin e aftësive të kombinuara ushtarake në rajon.

REFRENCAT:

- “*Strategjia e Sigurisë Kombëtare*”, pjesa e politikës së mbrojtjes, 2004
- “*Koncepti Strategjik i NATO-s*”, Samitin i NATO-s, Lisbonë, 2010
- “*CIA/ analysis on terrorism*”, 2010/opensource-gov
- “*International Relations Theory*”, fq.1-16; 532-40 (normative theory), Viotti and Kauppi,
- “*North Atlantic Treaty Organisation*”, ribotim 2009
- “*Bashkëpunimi ndërkombëtar për paqe, siguri dhe përparim në Europën Juglindore*”, (2004), Shoqata Shqiptare e Atlantikut
- “*The Balkans*”, <http://en.wikipedia.org/wiki/Balkans>
- “*Strategjia Ushtarake*”, botimi i 2007
- “*Ballkani i Jugut*”, Kadare, I., Tiranë 2005, f. 15
- “*Koncepti i Operacioneve të Përbashkëta*”, Konferenca e dymbëdhjetë vjetore ndërkombëtare për Zhvillimin e Konceptit dhe Eksperimentimin (CD & E), në Vilnius, Lituani, 6-8 nëntor 2012
- “*Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes të RSH*”, 2013
- *Neni 5 i Traktatit të Uashingtonit*, D.C., 4 prill 1949.
- European Union Institute for Security Studies: *The European future of the Western Balkans: Thessaloniki@10 (2003-2013)*, Edited by Eviola Prifti

KOL (R) Foto Duro

SISTEMI I PROMOVIMIT TË PERSONELIT NË FORCAT E ARMATOSURA SHQIPTARE

Abstrakt

Forcat e Armatosura Shqiptare (FASH) kanë ndryshuar tri herë strukturën e vet, brenda pesë viteve të fundit (dy herë që nga anëtarësimi në NATO). Kjo është justifikuar me nevojën për t'iu përshtatur kërkesave të NATO-s, por në fakt ndryshime kaq të shpeshta, të cilat nuk ndihmojnë në konsolidimin e FASH, dëshmojnë për probleme të brendshme “sistemike”, të cilat nuk mund të zgjidhen thjesht dhe vetëm me ndryshimin e strukturës së FASH.

Është elementi njerëzor, menaxhimi e promovimi i tij që, si rregull, përcakton suksesin e një organizate. Në material sillen fakte të cilat provojnë se me gjithë progresin në reformën e mbrojtjes në përgjithësi, ende ka probleme të efektivitetit të FASH, të cilat në një masë të madhe shkaktohen nga mangësitë në përzgjedhjen e personelit më të aftë, gjë që nga ana e vet, është rrjedhojë e mangësive në sistemin e vlerësimit dhe evidentimit të vlerave, e ndryshimit të vijueshëm të “rregullave të lojës”, deri ndërhyrjeve e shformimeve të shkaktuara nga nivelet më të larta të lidershit të FA ndaj këtij komponenti delikat të menaxhimit të burimeve njerëzore.

Sistemi aktual i promovimit në FASH, i cili pretendohet të jetë marrë nga përvojat më të mira të vendeve të tjera, duket se është zbatuar mekanikisht në realitetin shqiptar, duke mos dhënë rezultatet e pritshme në evidentimin e individëve më të mirë. Në jo pak raste, titullarët e Ministrisë së Mbrojtjes kanë anashkaluar e deri injoruar atë, duke bërë që te masa e ushtarakëve të bjerë besimi për një sistem të drejtë promovimi, duke nxitur tek ata ndjekjen e rrugëve të tërthorta për progres në karrierë. Për fat të keq, këto shformime marrin përmasa

më të dukshme në krye të piramidës ushtarake, deri në trajtimin e vetë gjeneralëve shqiptarë. Disa nga treguesit më kuptimplotë të këtyre problemeve janë numri relativisht i madh i ankimimeve (rreth 35% e kandidatëve për promovim), numri i madh i proceseve gjyqësore, si dhe numri i lartë i kërkesave për largim nga ushtria, sidomos në moshat e reja, të ushtarakëve duke bërë që në disa prej gradave (kapiten, major) të kthehet në shqetësim plotësimi i nevojave të FASH.

Në material është gjykuar që fokusi të vihet tek kategoria e oficerëve, për shkak të seriozitetit të problemeve që ajo mbart, por edhe të efektit që jep në gjithë efektivin e FASH. Është e kuptueshme që probleme të ngjashme ekzistojnë edhe në kategorinë e nënoficerëve. Një risi në këtë material përbën trajtimi i kategorisë së punonjësve civilë në FASH, i raporteve të tyre ndaj ushtarakëve dhe sidomos ndaj një sistemi gradash civile, që aktualisht nuk ekziston, megjithëse stadi aktual i reformave të mbrojtjes e ka kthyer në një imperativ që nuk mund të injorohet më.

Sfidat në motivimin dhe përzgjedhjen e ushtarakëve

Forca e armatosur konsiderohet nga organizimet më tipike, në të cilën është e domosdoshme një hierarki e spikatur piramidale, ku brenda zinxhirit të komandimit, nivelet më të larta kanë autoritet të konsiderueshëm mbi ato më të ulëta. Është vetë karakteri i detyrave (në luftë e në paqe) që e kushtëzon këtë hierarki. Për këtë arsye, brenda forcës së armatosur vendoset e respektohet (ndonjëherë deri në fetish) sistemi i gradave, bashkë me ndjenjën e ambicien (ndonjëherë të tepruar) për karrierë. Nga ana tjetër, bindja e vartësve ndaj eprorit, përtej imponimit që realizon sistemi hierarkik, duhet të vijë edhe “së brendëshmi”, si pranim i vlerave, i personalitetit dhe profesionalizmit të këtij të fundit. Në të kundërtën, motivimi i tyre për të kryer detyrën do të jetë minimal apo do të mungojë, me gjithë pasojat që kjo mbart me vete. Është harmonia midis pozicionit në hierarkinë

ushtarake dhe vlerave të vërteta të individit në atë pozicion, është “meritokracia”, që përcakton në një masë të madhe, nëse një forcë të armatosur është në gjendje të kryejë ose jo misionin e vet.

Në Forcat e Armatosura Shqiptare (FASH) janë bërë përpjekje të mëdha, sidomos në dy dekadat e fundit, për të instaluar e promovuar një sistem të qenësishëm vlerash, gjë që ka dhënë rezultate, megjithëse jo pa kundërshti, shpesh edhe me ndonjë hap prapa. Për çdo sistem promovimi pranohet vështirësia e të gjykuarit për vlerat e vërteta, pasi ato kërkojnë kohë për t’u verifikuar. Pavarësisht nga kjo, ka disa tregues që i bëjnë të dukshme këto probleme, sidomos në kreun e piramidës. Si rregull, sa më pranë kreut, aq më shumë menaxhimi i personelit tërheq vëmendjen dhe influencon masën e ushtarakëve, por edhe opinionin publik. Në mënyrë të posaçme këtu ndihet influenca e politikanëve, të cilët tradicionalisht kanë shfaqur interesin e kanë ushtruar fuqinë për të ndërhyrë e ndikuar në nivelet e larta të lidërshiptit ushtarak. Shkalla e këtyre ndërhyrjeve, si dhe efektet që ato prodhojnë tek një forcë e armatosur, janë treguesi më i mirë i pjekurisë së sistemit të promovimit, për rrjedhojë i të gjithë sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore. Në FASH, sikurse do të argumentohet më poshtë, shkalla e ndërhyrjeve dhe e shformimeve që rrjedhin prej tyre ka qenë relativisht e lartë. Disa prej këtyre shformimeve janë aq flagrante sa mund të quhen një fenomen unik shqiptar.

Kështu, megjithëse në legjisllacionin shqiptar përcaktohet se “*Shefi i Shtabit të Përgjithshëm është ushtaraku më i lartë, në gradë e detyrë, në Republikën e Shqipërisë dhe eprori më i lartë ushtarak i të gjithë personelit të Forcave të Armatosura*”¹, në fakt, në FASH, deri dy vite më parë, për periudha jo të shkurtra kohe, ka qenë vartësi i tij që ka pasur gradë më të lartë. Kjo dukuri ka qenë prezente edhe në pozicione më të ulëta të hierarkisë ushtarake,

¹ - Ligji Nr.8671, datë 26.10.2000, ndryshuar me Ligjin Nr.9194, datë 19.02.2004, “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e drejtimit strategjik të FARSH”, Neni 29.

deri aty sa gjenerali është vënë në varësinë e kolonelit². Raste të tilla, krahas “ngërçit” dhe problemeve në punën e përditshme, vënë në dyshim gjithë sistemin e përzgjedhjes, gradimit e emërimit në FASH, pa bërë fjalë për vështirësitë në raportet me të huajt.

Tashmë po bëhen shumë, rastet kur ushtarakë shqiptarë me grada madhore (gjeneral) janë liruar nxitimthi, pa motivacion, ndërsa janë vënë në dijeni të faktit vetëm nga mediat³. Duke filluar nga viti 1992, në FASH janë graduar 53 gjeneralë, prej të cilëve vetëm 5 janë liruar me procedura normale, duke organizuar edhe ceremoni ushtarake, në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Sërish sistemi vihet në dyshim: pse kaq shumë shkarkime gjeneralësh? Përse shumica e tyre kanë ngritur padi në gjykatë për shkarkim të paligjshëm dhe bile i kanë fituar gjyqet? Si është e mundur që edhe me vendime gjyqësore në favor të tyre, këta gjeneralë injorohen duke i lënë jashtë radhëve të FASH? A mundet që ushtarakët e gradave më të ulëta të kenë besim për një sistem të drejtë vlerësimi e promovimi, kur eprorët më të lartë të tyre trajtohen në këtë mënyrë? A mund të pritet prej tyre që t’ia besojnë promovimin e vet, sistemit aktual dhe “rregullave të shkruara të lojës”, pa bërë përpjekje për rrugë të “tërthorta” në këtë garë, kaq jetike për ta? A mund të pritet pas kësaj, ai kohezion ushtarakësh i domosdoshëm për realizimin e misionit?

Krahas gradimit, edhe pozicioni i punës, për individin, mbart në vetvete mesazhe vlerësimi, njohje të kapaciteteve të tij, dhënie kënaqësie për të punuar atje ku ai ndihet më i kompetent, por emërimet e nxituara mund të japin edhe efektin e kundërt. Për forcën e armatosur emërimet mbi bazë të vlerave e aftësive, janë garanci për plotësimin e misionit. Aktualisht janë jo të pakta rastet kur në FASH, ushtaraku është trajnuar në një fushë të caktuar (shpesh herë jashtë shtetit) dhe është emëruar në detyra

² Kjo situatë, p.sh, ka qenë prezente për një kohë relativisht të gjatë (2006-2009) në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes.

³ Dy prej tyre kanë pasur deri detyrën e lartë të Zëvendëshefit të Shtabit të Përgjithshëm dhe për kohëzgjatje, të dy kanë qenë propozuar nga një pjesë e rëndësishme e spektrit politik, për detyrën e lartë të Presidentit të RSH.

krejt të tjera. Gjithashtu, nuk kanë munguar edhe rastet kur pas trajnimit, ushtaraku është emëruar në detyra që janë më të ulëta se ajo që ka pasur para trajnimit. Në lidhje me këtë dukuri, materiali vlerësues i Komandës së NATO-s për Transformim (ACT) i Qershorit 2011, shprehet se “*FASH kanë dështuar në vënien e njeriut të duhur në vendin e duhur*”⁴.

Së fundi, bëhet me dije se këto shqetësime janë ngritur nga ndonjë kuadër i lartë ushtarak edhe tek autoritet më të larta politike të vendit, por reagimi ka qenë negativ, deri në shkarkimin e ankuesit⁵. Nga ana tjetër, sipas një studimi të Shtabit të Përgjithshëm për vitin 2009, kompletimi i FASH në gradat kapiten e major (të cilat përbëjnë masën kryesore të oficerëve) ka qenë përkatësisht 38% e 84%, ndërsa konstatohet tendenca e largimit të oficerëve të rinj dhe specialistëve, “*për arsye ekonomike*”. Një situatë e tillë ka nevojë për studime më të thella, ku me siguri do të konstatohet se “*arsyet ekonomike*” duke qenë qendrore, nuk mund të jenë të vetmet, por atyre u shtohen edhe faktorë të tjerë të cilat së bashku e rritin nivelin e demotivimit të ushtarakëve, sidomos të atyre në moshë të re, së bashku me dëshirën për t’u larguar nga FASH. Reagimi i lidërsipit të lartë politik e ushtarak ka qenë ndryshimi i strukturës (në pesë vitet e fundit janë tre të ashtuquajtura reforma në FASH, të cilat në fakt kanë konsistuar në zëvendësimin e njëres strukturë me një tjetër, së bashku me reduktimin sasior të FASH) pa analizuar shkaqet e vërteta të problemeve të efektivitetit, të cilat mund të përmbledheshin në konkluzionin e NATO-s: “*njeriu i duhur në vendin e duhur*”.

Procesi i vlerësimit të ushtarakut

Struktura piramidale e forcave të armatosura, me autoritete vertikale komandimi, e ka të domosdoshëm sistemin e gradave. Lidhja e ngushtë e gradës me autoritetin e komandimit dhe një

⁴ Ky fakt u konstatua nga Konferenca e 4^{të} e zhvilluar në Tiranë, me ekspertë të NATO-s, më datë 8-9 Qershor 2011.

⁵ Shih intervista e ish-ZV Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, Gjeneralbrigade Sandër Lleshi, Gazeta Shekulli, 16.06.2013.

sërë privilegjesh të tjera, u jep këtyre simboleve një fuqi tërheqëse të veçantë për ushtarakët, por indiferent ndaj tyre nuk mbetet as shoqëria. Sigurisht, roli i gradave ushtarake është i ndryshëm në vende të ndryshme, e lidhur kjo, veç një numri faktorësh, edhe me vendin që u jepet atyre në raport me pozicionin e punës⁶. Rivendosja, në vitin 1992, e sistemit të gradave në FASH, pati një rëndësi të veçantë në konsolidimin e zinxhirit të komandimit, por vetëm duke filluar nga viti 2004, me vendosjen e sistemit të pagave të ushtarakëve kryesisht mbi bazën e gradës, kjo e fundit mori një rëndësi të veçantë për ushtarakun shqiptar. Krahas anëve pozitive⁷ ky sistem, sollti nga njëra anë, një “ashpërsim” të konkurrencës për gradë, në jo pak raste edhe jashtë “rregullave të lojës”, nga ana tjetër një rënie të interesit për të punuar në detyra të vështira (përderisa shpërblimi ishte i njëjtë, i bazuar kryesisht tek grada).

Kriteret për përparimin në gradë të ushtarakëve të FASH rregullohen me ligjin nr.9171, datë 22.01.2004 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në FARSH”. Sipas këtij ligji, ushtaraku merret në shqyrtim për gradim në bazë të plotësimit të njëkohshëm të tre kriterëve⁸: afati kohor i qëndrimit në një gradë, arsimimi e trajnimi përkatës për gradën pasardhëse dhe performanca në punë, e njohur dhe dokumentuar nga eprori. Për më tepër, për secilin prej këtyre kriterëve, ky ligj jep përcaktime të detajuara, me qëllim shmangien në maksimum të subjektivizmit dhe interpretimeve të ndryshme⁹.

Performanca dhe rezultatet në punë përbëjnë komponentin

⁶ Në një numër vendesh (p.sh. Rumania) ende pozicioni i punës është më i rëndësishëm se grada në aspektin e shpërblimit, pra edhe të një numri kompetencash komandimi, privilegjesh, etj. Kjo bën që edhe konkurrenca për përparim në gradë të jetë më e moderuar.

⁷ Si faktorë pozitivë mund të renditen interesi dhe ambicia pozitive për promovim, thjeshtimi i sistemit të pagesave, etj.

⁸ Ligji Nr.9171, datë 22.01.2004 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në FARSH”, Neni 15/1.

⁹ Në Ligjin Nr.9171, Neni 10, përcaktohet koha minimale e detyrueshme për qëndrimin në një gradë për të lindur e drejta për gradën pasardhëse. Në Nenet 16 – 19 përcaktohet lloji dhe niveli i arsimimeve e trajnimeve për t’u kualifikuar në secilën gradë ushtarake.

më të rëndësishëm në kualitetet e një kandidati për të përparuar në gradë. Në të gjitha rregulloret për gradim të aplikuara deri tani në FASH, koeficientët e “performancës” në raport me ato të “arsimimit”, në vlerësimin e përgjithshëm të individit, kanë qenë në raporte të arsyeshme, afërsisht 6:4. Pavarësisht nga kjo, praktika e vlerësimit të kësaj performance ka qenë dhe vijon të mbetet problematike. Aktualisht në sistemin e vlerësimit të ushtarakut të FASH, janë adoptuar forma e metoda të cilat pretendohet të jenë marrë nga ushtri të përparuara perëndimore. Problemet e ndeshura tregojnë se gjatë marrjes së këtyre metodave e sidomos gjatë zbatimit të tyre, nuk është mbajtur sa duhet parasysh realiteti shqiptar.

Aktualisht performanca në punë e çdo ushtaraku të FASH evidentohet në formularë të caktuar, të përvitshëm, me një mori fushash, treguesish sasiorë e cilësorë të cilat në kushte ideale do të përfaqësonin një pamje të qartë të punës e përpjekjeve të individit për realizimin e detyrave. Në fakt, informacioni që këta formularë përmbajnë, në shumicën e rasteve, është shabllon, me fraza të përgjithshme, shpesh të pasakta, ndërsa në rastet kur kërkohet vlerësim me pikë, në përgjithësi ky vlerësim është maksimal. Këtu kanë ndikimin e vet një numër faktorësh objektivë e subjektivë. Së pari, në shumë raste, puna e individit (qoftë ky oficer apo nënoficer) përmban pak objektiva të matshëm, si pjesë e “përshkrimit të detyrës” apo të vendosura nga eprori. Këtij fakti i shtohet edhe mungesa e punës sistematike, gjithëvjetore, të eprorëve dhe sektorëve të personelit për matjen, vlerësimin dhe evidentimin e rezultateve në punë të ushtarakëve, pa përjashtuar rastet e përpjekjeve të individit për të influencuar titullarin e vet për këtë vlerësim.

a) Vlerësimi i performancës në punë			
Vlerësimi nga eprori	Kandidatë për gradën:		
	Kol	N/Kol	Major
nga 130 - 140 pikë (93%-100%)	77%	84 %	28 %
nga 120 - 130 pikë (86%-93%)	16 %	16 %	50 %
nga 110 - 120 pikë (79% - 86%)	7 %	-	17 %
nga 100 - 110 pikë (71% - 79%)	-	-	5 %

Duke qenë se njëra nga fushat e formularit të vlerësimit vjetor të ushtarakut (*fusha IV, vlerësimi profesional*) përmban tregues numerikë, te tabela “a” është paraqitur një përmbledhje e vlerësimeve të bëra nga eprorët për ushtarakët kandidatë për gradim, për vitin 2008, në gradat major, nënkolonel dhe kolonel. Vlerësimi maksimal në këtë fushë është 140 pikë dhe konstatohet se ndërsa për kandidatët për gradën “Major” ka një shpërndarje më të natyrshme të pikëve, ku 50% e tyre janë në nivelin 86-93% të vlerësimit, për gradat e tjera, më të larta, gati 80% e kandidatëve kanë vlerësimin maksimal (93-100%). Në këto kushte, për kuotat në dispozicion, krijohet artificialisht një masë relativisht e madhe konkurrentësh, të cilët në vlerësimin e performancës kanë maksimumin e pikëve¹⁰. Kjo nga njëra anë e bën gati të pamundur punën e Komisionit të Lartë të Karrierës, për të përzgjedhur individët më të mirë, nga ana tjetër i hap rrugën subjektivizmit e vlerësimit mbi kritere të tjera jo profesionale.

Niveli arsimor është pa dyshim një komponent i rëndësishëm i cilësive të kandidatit për gradim, që ka të bëjë me formimin e tij kulturor, doktrinor e profesional. Në këtë aspekt, një nga sfidat e sistemit të arsimim-stërvitjes në FASH ka qenë dhe mbetet objektiviteti, vendosmëria për të ndëshkuar me notë paraqitjen e dobët të studentëve të kurseve të ndryshme. Tashmë është një fakt i njohur “barazitizmi” në treguesit e performancës së studentit, duke vlerësuar maksimalisht, jo rrallë pa meritë (me notë 9 ose 10), pothuajse të gjithë pjesëmarrësit. Është e kuptueshme që, krahas kultivimit të dembelizmit, një situatë e tillë rrafshon vlerat, me gjithë efektet negative që e shoqërojnë. Nga aspekti i evidentimit dhe promovimit të individëve më të spikatur, një situatë e tillë nga njëra anë e “sfumon” këtë dallim, duke ia vështirësuar së tepërmi punën Komisioneve të Karrierës, nga ana tjetër krijon premisat për subjektivizëm e padrejtësi në dëm të individit të aftë. Natyrisht, fshirja e dallimeve ndodh vetëm në anën dokumentare, në dosjen personale, në punën e komisionit, pasi opinioni i ushtarakëve është gjithnjë i qartë

¹⁰ Për gradën “Kolonel” kuotat në dispozicion ishin rreth 18%

në lidhje me vlerat e gjithsecilit. Çdo padrejtësi në këtë aspekt, ka efektet e veta negative tek bindjet e gjithsecilit për objektivitetin e sistemit, duke nxitur edhe tek të tjerët gjetjen e rrugëve të tërthorta, së bashku me kurajën për të pretenduar më shumë se meritat.

b) Vlerësimi akademik			
Nota mesatare	Kandidatë për gradën:		
	Kol	N/Kol	Major
nga 9-10	82 %	51%	18%
nga 8-9	18 %	33%	53%
nga 7-8	-	-	29 %
pa notë	-	16 %	-

Në mbështetje të këtij argumenti, në tabelën “b” është dhënë një përmbledhje e vlerësimeve me nota, të kandidatëve për gradat “major”, “nënkolonel” e “kolonel”, të cilat i pati në dispozicion Komisioni i Lartë i Karrierës, për gradimet e vitit 2008. Sikurse shihet nga tabela, këto vlerësime (kryesisht të dhëna nga Akademia e Mbrojtjes e FASH) në shumicën e tyre janë maksimale, bile kjo tendencë drejt notave “9” e “10” vjen e rritet për grada më të larta (82% e kandidatëve për gradën e kolonelit¹¹ janë vlerësuar maksimalisht, ndërsa kuotat në dispozicion ishin për 18% të konkurrentëve). Vështirë ndonjë komision karriere, do të mundej në këto kushte të garantonte për individët një vlerësim objektiv, nga aspekti i arsimimit. Nga ana tjetër, megjithëse ligji për gradat përcakton në mënyrë taksative llojin e kursit që duhet të ketë përfunduar çdo kandidat (oficer ose nënoficer) për të marrë një gradë të caktuar. Nga sondazhet e kryera u konstatua të paktën rasti i një majori, i cili, megjithëse kishte braktisur në mënyrë flagrante kursin e Shtabit të Përgjithshëm në vitin akademik 2008-2009 dhe sigurisht nuk u mor në shqyrtim

¹¹ Të mbahet parasysh se bëhet fjalë për Nënkolonelë që konkurrojnë për gradën e “Kolonelit”. Në rast se do të kishte kurse trajnimi të kolonelleve, të dedikuara për të marrë gradën “Gjeneral” (kualifikimi për këtë gradë ka tjetër natyrë) mund të hamendësohet që vlerësimet do të ishin vetëm me notën maksimale “10”.

për gradë nga Komisioni përkatës, e përfitoi gradën Nënkolonel “me urdhër Ministri”.

Kohëqëndrimi në një gradë është kriteri i tretë i përcaktuar me ligj në sistemin e gradimeve dhe karrierës në FASH. Ligji për gradat përcakton një minimum të detyrueshëm vitesh qëndrimi në një gradë përpara se ushtarakut t’i lindë e drejta për të marrë gradën pasardhëse¹². Gjithashtu, ky ligj i njeh ushtarakut të drejtën për t’u graduar para kohe, në raste tepër të veçanta dhe për rezultate të spikatura në punë, por “vetëm një herë, gjatë gjithë karrierës ushtarake dhe jo më parë se një vit nga plotësimi i afatit kohor të qëndrimit në një gradë”¹³. Në raport me dy të tjerët, ky kriter duket më i thjeshtë për t’u zbatuar (përcaktimet për të në ligj, nuk lënë hapësira për keqinterpretim). Megjithatë, në praktikë janë konstatuar shkelje edhe të këtij kriteri, në jo pak raste. Ato konsistojnë në gradime në grada të larta shumë më herët se afatet ligjore dhe më shumë se një herë për të njëjtin person¹⁴. Në vërtetim të këtij pohimi mund të shërbejë një llogaritje e thjeshtë. Në bazë të nenit 10 të ligjit për gradat, në rastin më optimal, një ushtarak mund të marrë gradën “Nënkolonel” pas jo më pak se 15 vjetësh shërbim në FASH, ndërsa gradën “Kolonel”, pas jo më pak se 20 vjetësh. Nga të dhënat që ekzistojnë në “database” të FASH, konstatohen jo pak raste kur grada “Nënkolonel” është marrë pas 12-13 vitesh pune, ndërsa grada “Kolonel”, pas 17-18 vitesh pune, gjë që përbën shkelje të ligjit (neni 20) pasi vërteton gradim para kohë më se një herë, ose më herët se “një vit nga afati kohor i qëndrimit në gradë”¹⁵.

¹² Ligji Nr.9171, datë 22.01.2004 “Për gradat ...”, Neni 10 (neni përfshin të gjitha kategoritë e ushtarakëve, oficerë, nënoficerë, ushtarë)

¹³ Ligji Nr.9171, “Për gradat ...”, Neni 20.

¹⁴ Janë disa raste kur ushtaraku me gradën “Major”, është graduar “Nënkolonel” më herët se “një vit nga plotësimi i afatit kohor”, ndërsa një vit më pas ai ka marrë edhe gradën “Kolokol”, duke shkelur edhe një herë ligjin për të.

¹⁵ Një dukuri e tillë është konstatuar edhe për gradën “Gjeneralbrigade”, e cila për disa individë është dhënë pas një kohe relativisht të shkurtër shërbimi në uniformë, duke sjellë si alternative ose dhunimin e ligjit aktual, duke i nxjerrë në lirim para kohe, ose bllokimin e shanseve për promovim për ushtarakët e tjerë.

Procesi i përzgjedhjes dhe gradimit

Gjithë sa u trajtua më lart, ka të bëjë me vlerësimin e punës të ushtarakut, atë proces që, pavarësisht nga mungesat, në mënyrë të vijueshme, çdo vit, vlerëson dhe evidenton performancën e ushtarakut në punë apo në proces arsimimi. Ky proces i shërben gjithashtu një tjetër etape që është e lidhur me përzgjedhjen dhe promovimin në gradë të ushtarakut, duke finalizuar mundin dhe përpjekjet e tij për një periudhë 4-5 vjeçare. Pra, ndërsa etapa e parë është e vijueshme dhe e ballafaqon ushtarakun me standardet, etapa e dytë, për individin, zhvillohet një herë në 4-5 vjet. Për rreth një muaj, ajo e ballafaqon atë me kandidatët e tjerë, duke bërë edhe përzgjedhjen për gradën vijuese. Etapa e dytë, duke qenë se finalizon (ose jo) pritshmërinë e individit, konsiderohet me të drejtë më e rëndësishme, ndërsa pritshmëritë dhe një farë pasigurie tek çdo kandidat i japin kësaj faze një nivel tensioni më të lartë nga ç'do të duhej të kishte, rrjedhojë kjo edhe e dobësive në etapën e parë, atë të vlerësimit, të përmendura më lart. Një peshë e tillë e shtuar, ka bërë që edhe kjo etapë të pësojë shformimet e veta me rrjedhoja për individin, por edhe për vetë FASH, në përpjekjen për të përzgjedhur e promovuar elementin më pozitiv e më premtues për të ardhmen.

Ligji 9171, për gradat, duke synuar një proces sa më objektiv, ka bërë një numër përcaktimesh të rëndësishme në lidhje me procesin e gradimit, përbërjen e komisioneve të karrierës, personelin që duhet të marrë pjesë në këto komisione, si dhe personelin të cilit i ndalohet pjesëmarrja në to¹⁶ e të tjerë. Megjithatë, praktika ka treguar se një apo disa akte ligjore janë të pamjaftueshme, pa një traditë e kulturë të rrënjosur për një kohë të gjatë në fushën e menaxhimit të personelit. Një nga problemet në këtë aspekt ka qenë ndryshimi i vijueshëm i “rregullave të lojës”. Në kontrast me shumë vende të tjera ku

¹⁶ Sipas Ligjit 9171, “Për gradat...”, Neni 21/5, ndalohen të marrin pjesë në komisionet e karrierës të ushtarakëve: Ministri, Zëvendësministri, Sekretari i Përgjithshëm, Shefi i Kabinetit të Ministrit, këshilltarët ushtarakë të Ministrit, Kryeministri, Presidentit, oficerët e shërbimeve informative.

rregullat e vlerësimit për gradim, për ushtarakët qëndrojnë të pandryshuara për vite me radhë¹⁷, në Shqipëri është bërë praktikë e njohur tashmë miratimi çdo vit, me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, i një rregulloreje të re për punën e komisioneve të karrierës¹⁸. Në ndonjë rast (për shembull viti 2009) rregullorja është ndryshuar dy herë brenda 6 ditëve¹⁹.

Përgjithësisht ndryshimet në rregullore kanë qenë të mëdha. Hyrja në fuqi e saj zakonisht ka ndodhur jo më herët se dy javë para fillimit të punës së komisioneve të karrierës, ndërsa në vitin 2012 ajo hyri në fuqi, pas fillimit të punës së komisioneve²⁰. Kjo ka rritur pasigurinë tek kandidatët, por edhe tek vetë komisionet, përbërja e të cilave gjithashtu ka ndryshuar çdo vit, në ndonjë rast edhe disa herë brenda vitit, deri në ditën e fillimit të punës së komisionit²¹. Në “shtojcën 2” jepet një tabelë e ndryshimeve “të rregullave të lojës” në vitet 2012 e 2013.

¹⁷ Në Forcat Tokësore Amerikane, pas një periudhe prej 14 vjetësh në fuqi, disa nga praktikat e vlerësimit të ushtarakëve po gjykohej që të ndryshohen pjesërisht për të zbatuar në praktikë “mësimet e nxjerra” gjatë kësaj periudhe të aplikimit të tyre. Shih në: <http://www.military.com/daily-news/2013/07/10/army-to-overhaul-officer-evaluations.html?ESRC=army.nl>

¹⁸ Këtu nuk është fjala për urdhrin e përvitshëm të Ministrit të Mbrojtjes për formimin e komisioneve të karrierës, por për një rregullore voluminoze, me mënyrën e procedimit të komisioneve, deri të mënyrës së llogaritjes dhe koeficienteve që do të kenë në vlerësimin e përgjithshëm treguesit e ndryshëm të performancës e të kualifikimeve të individit. Edhe viti 2013 nuk i shpëtoi këtij “rregulli”. Në pesë vite, nga viti 2008 (viti i ftesës për anëtarësim në NATO) janë pesë urdhra të Ministrit të Mbrojtjes për miratim të rregulloreve të njëpasnjëshme të karrierës dhe konkretisht: Nr.983, datë 03.07.2008, Nr.983/1, datë 09.07.2008, Nr.819, datë 10.06.2009, Nr.1296, datë 08.08.2012 dhe së fundi, Nr. 220, date 04.02.2013

¹⁹ Këto dy rregullore u miratuan me urdhrat përkatës të Ministrit të Mbrojtjes, Nr.983, datë 03.07.2008 dhe Nr.983/1, datë 09.07.2008

²⁰ Urdhri për miratimin e kësaj rregulloreje mban datën 8 Gusht 2012, ndërsa ky urdhër përcaktonte si date të fillimit të punës së komisioneve të karrierës 1 Qershorin 2012.

²¹ Vetëm në vitin 2012, për përbërjen e Komisionit të Veçantë të Karrierës ka tre urdhra Ministri. Dy janë nxjerrë në të njëjtën datë 07.06.2012 dhe kanë përkatësisht numrat 933 e 936. I treti ka Nr. 933/1, datë 19.07.2012.

Është i kuptueshëm interesi i gjithë masës së ushtarakëve në përgjithësi dhe kandidatëve për gradim në veçanti, ndaj punës së komisioneve të karrierës, por bashkë me këtë interes nuk kanë munguar edhe përpjekjet për të ndikuar në punën e tyre. Këtyre ndikimeve nuk kanë mundur t’u rezistojnë as titullarët më të lartë. Kështu në vitin 2008, në kundërshtim me ligjin²², Presidenti dekreton katër gjeneralë brigade, pa asnjë vendim komisioni karriere, vetëm mbi propozimin e Ministrit të Mbrojtjes. Në vitin 2009, ndërsa Komisioni i Veçantë²³ (i krijuar me urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes, nr.821, datë 11.06.2009) i propozon Ministrit emrat e tre kolonelëve të përzgjedhur si më të përshtatshëm për të marrë gradën e gjeneralit të brigadës²⁴, ky i fundit e injoron këtë propozim dhe vendos vetë e i dërgon Presidentit kandidatura të tjera²⁵. Për më tepër, në tekstin e propozimit dërguar Presidentit, shkruhet se “Bazuar në vlerësimin e Komisionit të Veçantë të Karrierës...”²⁶, gjë që nuk ishte e vërtetë. Po në vitin 2009, ndërsa Komisioni i Lartë i Karrierës²⁷, i dërgon Ministrit të Mbrojtjes vendimin e vet dhe propozimet për ushtarakët e përzgjedhur për gradat e larta (Major-Kolonel), ky i fundit bën ndryshime në listat dhe gradon të tjerë

²² Ligji Nr.9171, “Për gradat.....”, Neni 21/1 përcakton: “Autoritete përgjegjëse për vlerësimin e përparimit të oficerëve në gradë e karrierë, si dhe për kualifikimin brenda dhe jashtë vendit, janë komisionet e karrierës”.

²³ Sipas Ligjit 9171 “Për gradat...” Neni 21/4a, Komisioni i Veçantë i Karrierës përbëhet nga pesë gjeneralë (të cilët përcaktohen nga Ministri i Mbrojtjes me urdhrë të veçantë) dhe kryesohet nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm. Ai vlerëson e rekomandon kandidatët për grada madhore (gjeneral).

²⁴ Relacioni i Komisionit të Veçantë Nr.6368, date 24.08.2009, fq.2

²⁵ Në listën e dërguar nga Komisioni i Veçantë – 2009, Ministri zgjodhi kandidaturat e renditura përkatësisht në vendin e 5^{të}, 6^{të}, 8^{të}, 9^{të} dhe 13^{të} (Informacion i Ministrit të Mbrojtjes për Presidentin e RSH, Nr.5725, datë 03.09.2009, fq.2).

²⁶ Propozimet e Ministrit të Mbrojtjes dërguar Presidentit të RSH, përkatësisht Nr, 5726, 5727, 5728, 5729, 5730, datë 03.09.2009.

²⁷ Sipas Ligjit 9171 “Për gradat...” Neni 21/4b, Komisioni i Lartë i Karrierës përbëhet nga katër gjeneralë (kryetari duhet të jetë “Gjeneral major”) dhe tre kolonelë. Ai vlerëson e rekomandon kandidatët për gradat “Major”, “Nënkolonel” e “Kolonel”.

kandidatë²⁸. Në rregulloren e gradimeve të vitit 2011, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm merr të drejtën që, pa qenë pjesë e Komisionit të Lartë të Karrierës, të ketë në dorë 20% të pikëve në vlerësimin e oficerëve për gradat “Major”, “Nënkolonel” e “Kolonel”, duke mundësuar potencialisht e praktikisht përmbysjen e çdo vlerësimi të bërë nga ky Komision²⁹.

Ndryshim i rregullave të lojës duhen konsideruar edhe rastet e ndryshimit të kohës/periudhës së shqyrtimit dhe gradimit të ushtarakëve. Sipas ligjit për gradat, gradimet kryhen “një herë në vit, në muajin Shtator”³⁰. Logjikshëm kjo lidhet me përfundimin e të gjitha llojeve të shkollimeve (zakonisht muaji korrik) duke u dhënë kohën e mjaftueshme komisioneve të karrierës për shqyrtimin e kandidatëve në periudhën korrik-gusht (përfshi edhe kohën e nevojshme në dispozicion të ankimimeve). Promovimet për vitin 2013 u kryen në muajin prill³¹, për gradat Major-Kolonel dhe qershor, për gradën madhore “Gjeneralbrigade”. Në këtë mënyrë, njëherazi me shkeljen flagrante të ligjit në fjalë, u privuan pa të drejtë nga konkurrimi një kategori e madhe ushtarakësh që vijonin procesin mësimor në kurse të ndryshme brenda apo jashtë vendit.

Dukuritë e mësipërme, të cilat kanë qenë më të spikatura në gradat e larta³² e madhore, kanë prodhuar një nivel relativisht të lartë pakënaqësie ndaj procesit të gradimit, e evidentuar kjo në masën e madhe të ankimeve nga ushtarakët.

²⁸ Në këtë mënyrë morën gradën “Kolonel” kandidatët me numër rendor 13 e 15 dhe u penalizuan kandidatët me numër rendor 9 e 10.

²⁹ Metodika e vlerësimit e Rregullores së Komisionit të Lartë të Karrierës, viti 2011, Shtojca A, Kapitulli II, pika 2: “...vlerësimi i karrierës përbëhet nga tre pjesë kryesore: Vlerësimi Vjetor i Eprorit, Vlerësimi i Komisionit të Karrierës dhe Vlerësimi i Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, të cilat kanë respektivisht 35%, 45% dhe 20% të Vlerësimit të Karrierës”.

³⁰ Ligji Nr.9171, “Për gradat.....”, Neni 30.

³¹ Pas periudhës ankimore, u finalizuan me urdhrat e MM, përkatësisht Nr.1292, 1293, 1294, date 19.06.2013 dhe Nr.1297 e 1298, date 20.06.2013.

³² Sipas Ligjit “Për gradat...” “grada të larta” konsiderohen gradat Major deri Kolonel, ndërsa “grada madhore”, gradat e gjeneralëve (Gjeneralbrigade, Gjeneralmajor, Gjeneralleitënant)

Të dhënat për numrin e ankuesve ndër vite është vështirë të gjenden, provë kjo edhe e nevojës për më shumë transparencë të procesit, megjithatë duke iu referuar vetëm vitit 2008, rezulton se janë ankuar tek Ministri i Mbrojtjes për të drejtën e mohuar (sipas tyre) 64 pretendentë³³ për gradën “Major”, 38 pretendentë³⁴ për gradën “Nënkolonel” dhe 23 pretendentë³⁵ për gradën “Kolonel”, të cilët së bashku përbëjnë një pjesë të rëndësishme të gjithë kandidatëve (rreth 35% të tyre). Një pjesë e ankimeve, në lidhje me gradimet, kanë ndjekur pas kësaj rrugën ligjore duke paditur në gjykatë sipas rastit Ministrin e Mbrojtjes e deri Presidentin.

Promovimi i femrave në FASH është trajtuar gjerësisht kohët e fundit³⁶, për rrjedhojë, nuk është vendosur specifikisht në objekt të këtij studimi. Mund të thuhet që sidomos dy vitet e fundit po konstatohet një prirje pozitive për mbështetjen dhe inkurajimin e tyre, gjë që nga ana tjetër, mbart edhe rrezikun e të ashtuquajturit “diskriminim pozitiv”. Nëse për hir të realizimit të disa kuotave, do të rezultojë përparim në gradë pavarësisht nga vlerat personale, kjo nismë pozitive mund të komprometohet rëndë duke bërë që “t’i gjendet personit puna” në vend të të kundërtës.

Në përgjithësi, në material, trajtimi fokusohet tek oficeri, për vetë impaktin që problemet e menaxhimit dhe promovimit të kësaj kategorie kanë për gjithë FASH. Sigurisht që këto probleme ndeshen edhe te kategoria e nënoficerëve. Për një numër arsyes ato kanë qenë më pak evidente për FASH, por sigurisht shumë të ndjeshme për individin nënoficer. Duke shpresuar mirëkuptimin e lexuesit, këto probleme nuk janë vënë në objekt të këtij shkrimi.

³³ Shkresa e Komisionit të Ankimit, për Ministrin e Mbrojtjes, Nr.7302/1, datë 29.08.2008

³⁴ Shkresa e Komisionit të Ankimit, për Ministrin e Mbrojtjes, Nr.7302/2, datë 29.08.2008

³⁵ Shkresa e Komisionit të Ankimit, për Ministrin e Mbrojtjes, Nr.7302/3, datë 29.08.2008

³⁶ Në lidhje me pozicionin e femrave në FASH dhe promovimin e tyre, shih artikujt e Dr. Elona Dhëmbos, Revista “Çështje Europiane dhe të Sigurisë”, organ i Institutit për Demokraci e Ndërmjetësim, Nr.24 dhe në Revistën Mbrojtja, organ i Ministrisë së Mbrojtjes, Korrik 2013.

Megjithëse ligji 9171, për gradat, përcakton me saktësi përbërjen e komisioneve të karrierës dhe funksionet (civilë apo ushtarakë) të cilët në mënyrë kategorike ndalohen të bëjnë pjesë në këto komisione³⁷, në dy vitet e fundit u kthye në praktikë futja në komisione e vëzhguesve të Ministrit³⁸, “*nëpunës nga drejtoritë e përgjithshme në Ministrinë e Mbrojtjes*”. Megjithëse roli i tyre, sipas urdhrave përkatës të Ministrit të Mbrojtjes, konsiston në vëzhgimin e punës së komisioneve dhe informimin e Ministrit, duke mos qenë e parashikuar në ligj, përbën një shkelje të qartë ligjore. Nga ana tjetër kjo është shprehje mosbesimi e imponimi ndaj pjesëtarëve të komisioneve, të cilët për fat të keq e kanë pranuar këtë fakt. Në bazë të ligjit nr.9171 për gradat³⁹, Komisioni i Veçantë që përzgjedh kandidatët për gradën “Gjeneralbrigade”, përbëhet nga pesë gjeneralë dhe kryesohet nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, ndërsa Komisioni i Lartë i Karrierës (për gradat “Major” deri “Kolonel”) përbëhet nga katër gjeneralë dhe tre kolonelë. Është absurde të mendohet se vëzhguesit, cilëtdo qofshin ata, do të kenë integritet më të lartë se pjesëtarët e komisioneve në fjalë.

Lirimi nga shërbimi, megjithëse tingëllon si e kundërta e promovimit në detyrë, është padyshim pjesë e sistemit të menaxhimit të karrierës së ushtarakut. Një numër rastesh të lirimimit nga shërbimi, të pa mbështetura në ligj, të konstatuara deri rishtas, bile edhe ndaj lidershipit më të lartë të FASH, nuk mund të mos demotivojnë pjesën tjetër të ushtarakëve, në lidhje me drejtësinë e sistemit. Vendimet e gjykatave në favor të të liruarve (qofshin këta me gradën madhore të Gjeneralit, por edhe me grada më të ulëta) dëshmojnë se këto lirime janë kryer në kundërshtim me ligjin⁴⁰. Krahas këtyre rasteve, janë edhe një numër rastesh të tjera kur ushtarakë të liruar me urdhër të Ministrit janë rikthyer në punë përsëri me

³⁷ Ligji Nr.9171, “Për gradat.....”, Neni 21/5

³⁸ Shih Urdhri i MM, Nr.1296, datë 08.08.2012, pikat 4.3.4 deri 4.3.7 dhe Urdhri i MM, Nr.220, datë 04.02.2013, pika 2.1.4

³⁹ Ligji Nr.9171, “Për gradat.....”, Neni 21/4

⁴⁰ Ndërmjet të tjerash, shih intervista e Kol. Perikli Koliçi dhe letra e tij për Presidentin e RSH, Shekulli, 27.11.2012.

urdhër të Ministrit, bile kjo gjë, për ndonjë person ka ndodhur më shumë se një herë, pa asnjë vendim gjykate dhe në kundërshtim me ligjin⁴¹. Një dukuri e tillë, me shumë gjasa unike vetëm në praktikën shqiptare, është një tjetër dëshmi e problemeve që ekzistojnë në sistemin e menaxhimit të personelit në FASH.

Punonjësi civil, sistemi i ekuivalencës së gradave dhe promovimi

Shërbimi civil në institucionet shtetërore të SHBA, duke filluar nga viti 1978, është i organizuar në dy grupe të mëdha gradash, “GS” (General Schedule) dhe “SES” (Senior Executive Service).

Grupi i parë, për “oficer ekuivalent” ka nënklasat nga **08** (ekuivalent me Nëntogerin) deri në **15** (ekuivalent me Kolonelin). Punonjësit civilë kanë gjithashtu grada ekuivalente me nënoficerët (GS-6,7) dhe me ushtarët (GS-1 deri GS-6).

Grupi i dytë (SES) përshkallëzohet në nënklasa të tjera (ekuivalent me Gjen.brig deri Gjeneral). Me gjithë ekuivalencën me gradat ushtarake, siç shihet, gradat civile jo domosdoshmërisht ndjekin shkallët (nënndarjet) e gradave ushtarake.

Pagat e dy punonjësve civilë që punojnë në dikastere të ndryshme, megjithëse mund të kenë të njëjtën gradë, mund të jenë të ndryshme, pasi çdo dikaster ka politikën e vet të pagave. Pagat e punonjësve civilë në FA Amerikane mund të jenë pak më të ulëta (për të njëjtën gradë) me pagat e punonjësve në Departamentin e Shtetit, Departamentin e Thesarit e të tjerë.

Pavarësisht nga kjo, Forcat e Armatosura shpesh rezultojnë më të preferuara për punonjësit civilë, ndër rreth 75 institucione federale të mundshme, pasi mundësitë (hapësirat) për progres në gradë këtu janë më të mëdha. (në internet: <http://www.federal-resume.org/gs-levels-explained.aspx>; ose <http://www.history.navy.mil/library/online/comparison.htm>) gjithashtu studim i Shtabit Përgj. të FASH, Korrik 2007)

⁴¹ Ligji Nr.9171, “Për gradat.....”, Neni 29, përcakton se ushtaraku në rezervë kthehet në shërbim aktiv vetëm në rastet kur: a) bëhen shtesa në numrin e personelit të FA, b) bëhet mobilizim i përgjithshëm apo i pjesshëm

Kontingjenti civil po zë një vend gjithnjë e më të madh brenda forcave të armatosura në të gjitha vendet. Në këtë dukuri kanë influencën e vet arsyt ekonomike (konsiderohet me kosto më të ulët) por edhe kompleksiteti i misioneve e detyrave. Fakti që një pjesë e operacioneve po kryhen në mjedisin virtual, pritet ta thellojë më tej këtë trend në të ardhmen. Në FA Amerikane, sot, krahas rreth 1.4 milionë ushtarakësh shërbejnë rreth 800 mijë civilë (menaxherë, inxhinierë, shkencëtarë, staf ndihmës, etj), ose rreth 36% e totalit, ndërsa në FASH, në një total prej rreth 11 mijë vetash, punonjësit civilë numërojnë rreth 2 mijë (rreth 18%). Në ushtritë e vendeve të tjera, këto shifra vërtiten diku në midis. Është e kuptueshme që për një kategori punonjësisht që përbën nga 1/4 në 1/3 e totalit, nuk mund të mos ketë një sistem të maturuar menaxhimi e promovimi. Nga ana tjetër, në kushtet e reja të funksionimit të forcave të armatosura, me kontribut të përbashkët të ushtarakëve dhe civilëve, ku jo rrallë të dytët janë eprorë për të parët, bëhet e domosdoshme një hierarki e qartë autoritetesh dhe pushtetesh. Është kjo arsyeja që shumica e vendeve perëndimore (të ndjekura edhe nga një numër vendesh të Evropës Lindore) kanë vendosur tashmë sistemin e gradave civile ekuivalente me ato ushtarake. Në ushtritë e tyre, ekuivalenca në gradë po bëhet pjesë e formulës së prezantimit personal⁴². Për marrjen e gradës prej civilëve, respektohen të njëjtat kritere si dhe për ushtarakët (performancë, arsimim, kohëqëndrimi në detyrë).

Duke qenë një sistem i maturuar e kodifikuar deri në detaje, rastet kur civili është epror për ushtarakun apo anasjelltas, konsiderohen normale, por gjithnjë eprori nuk mund të ketë kurrë gradë (ekuivalente) më të ulët se vartësi. Një pjesë e vendeve aplikojnë edhe ruajtjen e gradës nga punonjësi civil gjatë transferimeve nga një institucion shtetëror në tjetrin (ministri e jashtme, e brendshme etj) gjë që i jep atij sigurinë që përpjekjet dhe arritjet e tij në

⁴² Terma të tillë si "*Major equivalent*", "*Two stars equivalent*" (ekuivalent i gjeneralit me dy yje) janë më se të zakonshëm në prezantimin e vetes nga civilët që punojnë në forcat e armatosura të vendeve të NATO-s.

institucionin e mëparshëm, nuk shkojnë kot, me kalimin në një institucion tjetër.

Në FASH, megjithëse është diskutuar disa herë në parim, deri tani nuk ka asnjë hap konkret për instalimin e një sistemi të tillë. Përveç vështirësive që paraqet gjithnjë diçka që aplikohet për herë të parë, këtu kanë ndikuar negativisht edhe lëvizjet frekvente të punonjësve civilë, sidomos në postet e rëndësishme (drejtor, shef sektori). Zakonisht kanë qenë sektorët e lidhur me personelin, me ekonominë apo marrëdhëniet me jashtë, që kanë përjetuar ndryshimet më të shpeshta të titullarëve të tyre (për shkak të rotacionit të pushtetit, por jo vetëm), të cilat jo rrallë kanë ndodhur edhe çdo një apo dy vjet. Përgjithësisht vendet e punës nga ku ky kontingjent ka ardhur apo ka shkuar pas largimit, nuk kanë pasur lidhje me sektorin e mbrojtjes (apo të sigurisë).

Është e kuptueshme që në kushte të tilla, duke iu referuar sistemit perëndimor të ekuivalencës së gradës, punonjësi civil i porsa emëruar në FASH⁴³ do të duhej të merrte një gradë të ulët, gjë do ta vinte në pozitë të vështirë ndaj një vartësi ushtarak me gradë më të lartë. Një tjetër opsion mund të ishte pajisja e punonjësve civilë me ekuivalencën e gradave sipas vendit të punës. Kjo do të kishte si rrjedhojë që të porsa ardhurve t'u jepeshin menjëherë grada madhore, gjë që do ta komprometonte sistemin e gradave civile duke bërë që të mos merrej seriozisht (të paktën për një farë kohe, deri në maturimin e sistemit). Nga ana tjetër, ky sistem gradash ekuivalente ka vlerë kur punonjësi civil përfshihet në të për një kohë relativisht të gjatë. Qëndrimi i individit në sektorin e mbrojtjes për vetëm 1-3 vjet e bëjnë këtë sistem të pakuptimtë. Mesa duket, për shkak të këtyre vështirësive është preferuar të ruhet statukuojja. Për rrjedhojë, punonjësit civilë në Ministrinë e Mbrojtjes, për shkak të postit, pavarësisht nga koha në detyrë, kanë mundësinë të jenë eprorë edhe për ushtarakë me grada të larta, bile në ndonjë rast, duke interferuar

⁴³ Këtu është fjala jo vetëm për pozicione të larta në Ministrinë e Mbrojtjes, por edhe në një numër strukturash të tjera, të natyrës jo operacionale, jashtë Ministrisë së Mbrojtjes.

e ushtruar influencën deri në njësitë ushtarake⁴⁴. Një situatë e tillë, për shkak të traditës në FASH, nuk ka provokuar tensione serioze, por nga ana tjetër, është e pamundur të motivojë e inspirojë për të mobilizuar energjitë e nevojshme për realizimin e detyrave.

Një tjetër dukuri që shkon përkundër nevojës për motivim, është fakti që në sektorin e mbrojtjes në Shqipëri, për të njëjtin nivel detyre, ushtarakët paguhën më pak se punonjësit civilë⁴⁵ gjë që nuk ndeshet në ushtritë e tjera. Kështu në nivelin drejtor drejtorie, ushtaraku me gradë kolonel merr një pagë rreth 16% më të vogël se kolegu i tij civil. Në nivelin e shefit të sektorit, kjo diferencë shkon nga 20% në 40%, më pak për ushtarakun (Nënkolonel, Major). Këto diferenca vijnë e zbuten në nivelin e specialistit, por sërish me rreth 4.5% deri 8% më pak për ushtarakun (Major, Kapiten). Për më tepër, kjo diferencë, me rritjen e pagave në Gusht 2012 është thelluar në raport me pagat e vendosura në Gusht 2011. Efektin zbritës, në dëm të ushtarakut e thellon më tej fakti që ushtaraku është i detyruar të paguajë kontribut për sigurim suplementar në masën 5% të pagës bruto, në një kohë që ky detyrim për punonjësit civilë është 2-4%⁴⁶.

Sikurse shihet, sistemi i menaxhimit të personelit në FASH, në përgjithësi dhe ai i promovimit në veçanti, kanë probleme të mëdha të cilat ka ardhur koha të merren në dorë në mënyrë serioze, duke i parë në tërësinë e tyre e me synimin për zgjidhje

⁴⁴ Kjo dukuri konstatohet edhe nga kompania e ekspertëve amerikanë, SAIC, e cila bëri vlerësimin e mbrojtjes të RSH në vitin 2000-2001. Në rekomandimet e SAIC specifikohet: "As Ministri, as Stafi i Ministrisë, nuk duhet të ketë fuqi direkte të komandim-kontrollit për asnjë njësi të FASH" (Vlerësimi i Mbrojtjes, viti 2001, pika 6.3 "Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm").

⁴⁵ Shih shtojca 1 - tabela me të dhënat konkrete për nivelin aktual të pagave në Ministrinë e Mbrojtjes e Shtabin e Përgjithshëm.

⁴⁶ Kontributi 5%, i detyruar me Aktin Normativ Nr.05, datë 10.11.2010, Neni 2, paguhet vetëm nga ushtarakët dhe punonjësit e policisë së shtetit. Për nëpunësit civilë (specialist deri drejtor drejtorie) ky kontribut është 2% - 3% (shih Ligji Nr.9061, datë 08.05.2003, Neni 2 dhe Ligji Nr.8097, datë 21.03.1996, Neni 1/9).

afatgjata. Dërgimi i disa nënrepartëve në misione të luftarake jashtë vendit, në kuadrin e NATO-s, kanë qenë ndërmarrje të vështira dhe i kanë nderuar ushtarakët tanë, por e ardhmja mund të rezervojë sfida shumë më të rrezikshme ndaj sigurisë e mbrojtjes së vendit, të cilat nuk mund të përballohen pa reagimin e gjithë masës së FASH. Në këtë rast përkushtimi e kohezioni janë po aq vendimtare, bile marrin epërsi ndaj përgatitjes teknike e pajisjeve moderne luftarake.

Konkluzione dhe rekomandime:

1. Kuadri ligjor në promovimin e ushtarakëve në FASH, megjithëse ka shfrytëzuar përvojat më të mira të vendeve të tjera, ka probleme të përshtatjes me realitetin shqiptar. I rishikuar për të fundit herë në vitin 2004, ai mund të konsiderohet i tejkaluar nga koha, sidomos në aspektin e reflektimit të shformimeve e defekteve të konstatuara nga koha e miratimit deri sot.
- 1.2. Të gjithë aktet e tjer nën ligjorë që do të prodhohen pas rishikimit të “Ligjit të gradave...” duhet të synojnë krahas plotësimin të një numri boshllëqesh në teknikalitetet e vlerësimit dhe shqyrtimit për gradim të ushtarakëve, edhe qëndrueshmërinë në praktikën e punës me personelin duke ndaluar kategorikisht ndryshimin e herëpashershëm të “rregullave të lojës”.
2. Në përgjithësi sistemi i vlerësimit të performancës së ushtarakut në FASH dhe sidomos procesi i shqyrtimit e përzgjedhjes për promovim, vuan mungesën e transparencës, duke qenë njëkohësisht vulnerabël ndaj ndërhyrjeve nga jashtë sistemit.
- 2.1. Të rishikohen aktet nënligjore e praktikën përkatëse me qëllim që nga njëra anë të rritet objektiviteti në vlerësimin e individit (në performancën e tij në punë e shkollim) nga ana tjetër të krijohen të gjitha kushtet e nevojshme për individin për t’u njohur me vlerësimin që i është bërë punës së tij nga eprori apo institucionet përkatëse.
- 2.2. Praktikën vlerësuese dhe procedurat për shqyrtim e përzgjedhje për gradim, të kombinohen me teknika të përshtatshme, përfshi ato kompjuterike, me qëllim pamundësimin e ndërhyrjeve e ndikimeve nga jashtë sistemit, në injorim të “rregullave të lojës”.

- 2.3. Të ndërpritet praktika e caktimit të vëzhguesve jashtë përbërjes dhe mbi komisionet e karrierës.
3. Raportet aktuale midis ushtarakëve dhe punonjësve civilë (të niveleve të larta) ka nevojë të përmirësohen e vendosen mbi baza më të shëndosha ligjore
- 3.1. Një nga fushat e rishikimit dhe plotësimit të kuadrit ligjor në FASH t'i kushtohet punonjësit civil që shërben në FASH. Ky kuadër ligjor të precizojë vendin e punonjësit civil, sidomos shmangien e ndërhyrjeve të tij në zinxhirin e komandimit ushtarak.
- 3.2. Me grupe specialistësh të shqyrtohet mundësia e aplikimit të sistemit të ekuivalencës së gradave edhe për punonjësit civilë të FASH, së bashku me metodologjinë dhe etapat e implementimit të plotë të këtij sistemi.
- 3.3. T'u jepet fund praktikave të deritanishme, ku për të njëjtin nivel detyre, kuadrot ushtarakë paguhen më pak se homologët e tyre civilë.

Shtojca 1

**Tabela e pagave
(për kategori të njëjtë apo të ngjashme pune në MM – SHP)**

DETYRA	Kategori/ Grada		Paga (Lekë)			Paga (Lekë)		
	Civil	Usht	Civil ¹ (VKM 545/11.08.11)	Usht ² (VKM 549/11.08.11)	Pag usht (më pak)	Civil ¹ (VKM 524/16.08.12)	Usht ² (VKM 502/01.08.12)	Pag usht (më pak)
Sek. Përgj M M	I ¹	-	136800	-	-	138500	-	-
Zv. Shef i ShPFA	-	Gj. Brig	-	115667	18.3%	-	116667	18.7%
Drejtor i Përgjith MM	I ^A	-	126600	-	-	128300	-	-
Drejtor drejtorie	I ^B	Kolonel	109300	94500	15.7%	111200	95480	16.5%
Shef Sektori	I ^A	N/Kol	92000	75600	21.7%	93900	76593	22.6%
	I ^{A-1}	Major	82800	59740	38.6%	84700	60660	39.6%
Specialist	IV ^A	Major	63400	59740	6.1%	65300	60660	7.6%
	IV ^B	Kapiten	53200	52500	1.3%	55200	52816	4.5%

¹ Në pagat e punonjësve civilë të MM është marrë një mesatare midis pagës minimale dhe asaj maksimale, për kategori, e përcaktuar në VKM përkatës (duke përfshirë shtesën për vjetërsi).

² Në pagat e ushtarakëve është marrë një mesatare midis pagës minimale dhe asaj maksimale, për gradë, e përcaktuar në VKM përkatëse.

Shtojca 2

Ndryshimi i rregullave për gradim në rregulloret e dy viteve të fundit të Ministrisë së Mbrojtjes

Kërkesat	Rregullore vitit 2012	Rregullore e vitit 2013
Koha e miratimit	Gusht	Shkurt
Fillimi punës së komisioneve	1 Qershor ¹	-
Vlerësimi i performancës	55 % ²	60 % ³
Vlerësimi i arsimimit	45 %	40 %
Arsimimi civil në komponentin e arsimimit	20 % ⁴	10 % ⁵
Grada "Master"	5 pikë	4 pikë
Grada "Doktoraturë"	2 pikë	6 pikë
Përgatitja fizike	Komponent i veçantë ⁶	-
Vërtetimi shëndetësor	Nga Spitali Usht ⁷	-
Vlefshmëria e testimit për gjuhën angleze (STANAG 6001)	1 vit ⁸	2 vjet ⁹
Vlefshmëria e testimit për gjuhën angleze (testi ALCPT)	90 ditë	105 ditë
Vlerësimi i eporit	3 vitet e fundit	Gjithë periudha e gradës fundit
Vlerësimi i eporit	55 %	60 %
Vlerësim komisionit për detyrën funksionale	-	16 % ¹⁰
Vlerësim komisionit për leadership	35 %	-
Përvoja, roli në misione	-	8 % ¹¹
Rekomandim nga superiorët	-	8 %
Vlerësim komis për potencialet e kandidatit në të ardhmen	10 %	-
Paraqitje nga kandidati i vizionit të tij për reformën e FASH	-	8 %

¹ Pavarësisht nga detyrimi për komisionet e karrierës, për fillimin e punës në 1 Qershor, (pika 6.2.8) vetë Urdhri ka dale në 8 Gusht 2012

² Rregullore 2012, pika 8,1

³ Rregullore 2013, pika 6.1 e 6.2

⁴ Rregullore 2012, Shtojca A, pika 1.2

⁵ Rregullore 2013, shtojca 1, pika 3

⁶ Rregullore 2012, fq.3

⁷ Rregullore 2012, pika 6.2.11

⁸ Rregullore 2012, 6.2.8

⁹ Rregullore 2013, pika 4.2.6

¹⁰ Në rregullore: 40% e 40%

¹¹ Në rregullore: 20% e 40%

Julian DORACI

KOMPANITË PRIVATE TË SIGURISË,
IMPAKTI I TYRE NË SHOQËRITË E SOTME
DHE NË REALITETIN SHQIPTAR

Rritja e industrisë private të sigurisë është ndoshta një nga zhvillimet më befasuese gjatë viteve të fundit në shoqërinë tonë. Është pikërisht kjo industri që gjatë këtyre viteve i ka dhënë një kuptim tjetër dinamik konceptit të sigurisë. Duke u zhvilluar me hapa galopantë, globalizimi i sigurisë, si në aspektin ekonomik, por edhe atë ligjor, ka ndryshuar edhe konceptin vestfalian të sovranitetit dhe organizimit shtetëror, sidomos në Evropë, e cila sot po funksionon nën aspektin e sovranitetit të përbashkët.

Ajo çfarë është e rëndësishme të kuptojmë në këtë proces, janë dy aspekte: e para, fragmentarizimi i atij pushteti që tradicionalisht është menduar së është një monopol i shtetit pra koncepti i sigurisë dhe së dyti, sa për qind e këtij pushteti mund të jetë transferuar në këto organizata të cilat udhëhiqen nga përfitimi monetar. Përgjigjet vështirësohen më shumë në kushtet kur tashmë, në tregun e sigurisë, si rezultat i këtyre zhvillimeve dinamike, operojnë edhe kompani të fuqishme private si Securitas apo Group4Securior, të cilat për nga madhësia, burimet dhe të ardhurat përbëjnë një faktor domethënës në politikat ndërkombëtare.

Një impakt të tillë do ta deklaronte edhe ish-presidenti i Francës, Sarkozy, në Samitin I-rë të Sigurisë Private në Evropë në vitin 2008: *“Sektori privat i sigurisë është zgjeruar ndjeshëm në të gjithë Bashkimin Evropian duke përfaqësuar 1.7 milion vende pune, 50 mijë kompani private të sigurisë më një të ardhur vjetore prej 15 bilionë eurosh.”*

Pikërisht, ky dokument do të trajtojë një vlerësim analitik të këtij fenomeni si në Evropë, ashtu edhe Shqipëri, e cila është përfshirë tashmë në procesin dinamik të rritjes së industrisë private të sigurisë. Kjo qasje analitike do të ekzaminojë arsyet rritjes së ndjeshme të kësaj industrie, zhvillimin dhe ndryshimet në legjislacionet përkatëse, trendet dhe zhvillimet e pritshme në të ardhmen, shoqëruar me rekomandimet përkatëse në rastin e Shqipërisë. Ky dokument, jo vetëm përmbledh njohuritë ekzistuese dhe këndvështrimet e ndryshme mbi këtë çështje, por sjell edhe informacione te reja të hapura për t'u debatuar.

1-Trajtim i shkurtër historik mbi sigurinë private

Ndryshe nga se mund të mendohet në ditët e sotme, siguria private si profesion nuk është një zhvillim modern i dekadave të fundit, por i ka fillimet e saj shumë më herët. Që nga fillimet e njerëzimit, ashtu sikurse është dokumentuar edhe në gjetjet e shumta arkeologjike në mbarë botën, njerëzit kanë treguar se mbrojtja e jetës dhe pronës private ka qenë një nga detyrat dhe shqetësimet kryesore të shoqërisë. Në Romën e lashtë familjet e pasura romake do të punësonin gladiatorët apo ushtarakë të tjerë që kishin marrë pjesë në luftëra të ndryshme për të mbrojtur familjet dhe pronat e tyre. Në kohën e Perandor Augustit do të formohej Garda Pretoriane, një grup ushtarakësh elitë që merreshin me ruajtjen fizike të perandorit, por edhe Rojtarët Romakë, nga perandori Octavious, që merreshin me ruajtjen e qytetit dhe infrastrukturës së tij. Disa studiues mendojnë se Garda Pretoriane dhe Rojtarët Romakë, për nga organizimi dhe funksioni, mund të quhen edhe si personeli i parë i sigurisë private dhe ndoshta forca e parë policore.

Zhvillimet kryesore në fushën e sigurisë qytetare do të zhvilloheshin më pas vrullshëm në kohën e Mesjetës. Në vitin 1285, për shkak të rritjes së kriminalitetit, dëmtimit të pasurisë, vjedhjeve të ndryshme, Mbreti Eduard I do të aprovonte

Statusin e Winchesterit (*i njohur edhe si Statusi i Westminsterit*), status i cili themeloi bazat e koncepteve të sigurisë lokale. Në status parashikoheshin masa të përbashkëta të sigurisë si mbyllja e portave ruajtëse të fshatrave, krijimi i patrullave të rojeve të natës e të tjerë. Shumë tregtarë anglezë në këtë kohë do të punësonin roje private për të ruajtur mallrat e tyre apo edhe për të investiguar dhe rimarrë pronën apo sendet e vjedhura prej tyre.

Në vitin 1748, po në Mbretërinë e Bashkuar, Henry Fielding do t'i jepte një hov të mëtejshëm konceptit të sigurisë private. Si kundërpërgjigje ndaj krimit të rrugës, ai krijoi një forcë profesionale sigurie të mirëpaguar, që më pas do të konsiderohej edhe si forca e parë policore londineze.

Ndjekur nga zhvillimet e vrullshme të kohës, duke u bazuar edhe në parimet e Fielding, Sir Robert Peel, një politikan vizionar, do të krijonte në vitin 1829 Forcën Policore Metropolitane me bazë në Londër. Për herë të parë u prezantua edhe koncepti i policimit në komunitet, ku qytetarët do të ishin pjesë integrale e procesit të sigurisë së tyre.

Në të njëjtën mënyrë edhe SHBA ndoqi shembullin e Anglisë në marrjen e masave për sigurinë private. Në vitin 1850 Allan Pinkerton, një ish dedektiv nga Chikago, do të formonte agjencinë “Pinkerton”, agjencinë e parë private të sigurisë. Edhe pse fillimisht ajo u krijua si një agjenci e cila merrej me sigurimin e dërgesave monetare nëpër rrugë dhe hekurudha, ajo do të njihej shpejt në të gjithë vendin pas zbulimit të një komploti për të vrarë presidentin Abraham Linkoln. Më pas ajo do të përfshihej në Luftën Civile si një agjenci sekrete në fushën e inteligjencës në shërbim të Ushtrisë së Unionit. Pas luftës do të formohej Agjenica Kombëtare e Dedektivëve Pinkerton¹. Krijimi i kësaj agjencie do të ishte precedent për krijimin e shumë agjencive të tjera private në të gjithë SHBA dhe një model për krijimin e shumë agjencive të

¹ www.pinkerton.com

tjera ligjzatuese publike, duke përfshirë edhe Byronë Federale të Investigimit (FBI). Me shumë interes në zhvillimin e sigurisë private ishte edhe zbulimi në vitin 1853 i sistemit të parë të alarmit ndaj vjedhjeve, nga reverend Augustus Pope, patenta e të cilit do të blihej në vitin 1857 nga biznesmeni Edwin Holmes, i cili e nxorri atë në treg në vitin 1858 (Donnelly, 1992).

Diçka inovative për sektorin e sigurisë private do të ishte edhe përdorimi i makinës së parë të blinduar për shërbimet financiare. Makina bankare e blinduar Bellamore² do të vihej për herë të parë në funksionim në vitin 1910 dhe do të përdorej për transportimin e shumave të mëdha të parave, sikurse do të përdorej edhe si banka e parë e lëvizshme. Gjatë Luftës e Parë Botërore (1914-1918) u rrit ndjeshëm nevoja për siguri, sidomos në industrinë amerikane, për shkak të frikës së sabotazheve të mundshme, ku kompani të shumta private të sigurisë u përdorën për të mbrojtur industrinë e luftës dhe kalatat e porteve nga sabotatorët.

Vitet e Depresionit të Madh (1929-1937) do ta ulnin këtë kërkesë, megjithatë Lufta e Dytë Botërore (1939-1945) do të ishte një katalizator i rëndësishëm në rritjen e industrisë private të sigurisë (Hess, 2009:13). Drejtuesit e impianteve të prodhimeve luftarake do të kërkonin nga kompanitë private të sigurisë personel profesional dhe të trajnuar për t'iu përgjigjur nevojave emergjente me efikasitet të plotë. Disa kompani kishin edhe investigatorë privat, të cilët kontrollonin punonjësit që punonin në disa impiante sekrete. Një vëmendje e veçantë në këtë periudhë do t'i kushtohej edhe trajnimit të punonjësve të sigurisë private për të arritur standardet e forcave policore, por me të vetmin ndryshim, që kjo filozofi drejtohej drejt besnikërisë dhe devotshmërisë ndaj kërkesave të klientit.

Kjo industri do të zhvillohej më tej edhe gjatë Luftës së Ftohtë (1945-1991) sidomos në fushën e spiunazhit. Një

² <http://www.coachbuilt.com/bui/b/bellamore/bellamore.htm>

gjeneratë e re e kësaj industrie po zhvillohej duke aplikuar shumë edhe zhvillimet teknologjike që do e mbështesnin fuqishëm atë në ofrimin e sigurisë. Rreth viteve 1980, Shearing dhe Stenning do të paraqisnin tezën e “pronës private masive”. Kjo tezë do të gjente ndjeshëm aplikim në Afrikën e Jugut pas periudhës së aparteidit si një tezë tepër influencuese në fushën e sigurisë private. Në ditët e sotme, industria private e sigurisë në Afrikën e Jugut mbetet një nga interesimet kryesore për akademikët dhe politikbërësit në mbarë botën për një sërë arsyesh, por ndoshta më kryesorja është pasi ajo besohet të jetë më e madhja në botë në terma të GDP-së së vendit, përafërsisht rreth 2 % e saj (Berg & Nouveau 2011, 23-30).

Me rritjen e pronës private dhe me ndryshimet e vullshme të konceptit të sigurisë në shoqëri, IPS-ja do të merrte një karakter multidimensional dhe ndërkombëtar. Numri i kompanive dhe punonjësve të tyre do të rritej ndjeshëm. Në Mbretërinë e Bashkuar në ditët e sotme punonjësit e sigurisë private tejkalojnë numrin e punonjësve të policisë në një raport 2:1; në Shtetet e Bashkuara, përafërsisht 3:1; në Hong Kong, 5:1, kurse në disa vende të zhvilluara ai është akoma më i lartë dhe mund të shkojë 10:1 (Abrahamsen & Williams 2007, 237-253).

Krijimi i kompanive të mëdha të sigurisë do të tejkalonte konceptin “kombëtar” të parimit të sigurisë private. Për shembull, kompania “Securitas” me bazë në Suedi është një nga KPS-të më të mëdha në botë. Pas viteve 1990 do të zgjerohej ndjeshëm në Evropë dhe më pas edhe në tregun e Amerikës së Jugut duke operuar në më shumë se 52 shtete, duke punësuar rreth 300 mijë punonjës sigurie. Po ashtu edhe Group4Securior është një nga KPS-të e cila ka ndjekur strategjinë e zgjerimit global, sidomos pas vitit 2004. Ajo tashmë operon në mbi 120 shtete duke punësuar 620 mijë punonjës sigurie.

Në Samitin e Parë të Sigurisë Private në Evropë në vitin 2008, sektori privat i sigurisë do të konsiderohej si një nga

fushat më të rëndësishme të aktivitetit ekonomik në BE duke përfaqësuar 1.7 milionë vende pune, 50 mijë KPS, më një të ardhur vjetore prej 15 bilionë eurosh.

2-Privatizimi i Sigurisë, *quo vadis?*

Ndër vite siguria është parë si një nga detyrat parësore autoritare të shtetit. Të gjithë jemi dëshmitarë që dekadat e fundit sektori i sigurisë private është zgjeruar dhe rritur ndjeshëm duke ndikuar në balancat e asaj se çfarë është siguria publike apo private, nëse privatizimi i sigurisë po dobëson rolin e shtetit në ofrimin e sigurisë qytetare dhe asaj ndaj pronës. Mos vallë privatizimi i ndjeshëm i sigurisë po ndikon në “fragmentizimin” e autoritetit shtetëror. Nëse duhet të analizojmë konceptin e autoritetit joshtetëror në fushën e sigurisë, do të ishte e nevojshme të analizonim me pak fjalë, në vetvete, konceptin “autoritet”. Fjalori i Oksfordit e përkufizon termin autoritet si:

“Një person ose organizatë që ka pushtet politik ose administrativ për të dhënë urdhra, të marrë vendime për të komanduar dhe ndikuar ndaj të tjerëve.” Fjalori i Cambridge e përkufizon si:

“Një grup njerëzish me përgjegjësi zyrtare në një fushë ose aktivitet të caktuar; morali ose e drejta ligjore për te kontrolluar.”

Pra në përgjithësi autoriteti është pushteti apo fuqia për të ndikuar ndaj të tjerëve duke pasur legjitimitetin e nevojshëm. Autoriteti i KPS-ve rrjedh kryesisht nga tre zhvillime kryesore: së pari nga ligjërimi i këtij aktiviteti, së dyti nga mbizotërimi i politikave ekonomike neoliberales dhe së treti integrimi i KPS-ve në rrjetet “hibride” të sigurisë (Abrahamsen & Williams 2007, 237-253).

Përsa i përket faktorit të parë, ndryshimi midis autoritetit shtetëror dhe joshtetëror është se autoriteti policor (*autoriteti shtetëror*) rrjedh përgjithësisht nga statuset publike të zbatimit të ligjit, kurse autoriteti joshtetëror i personelit të sigurisë private rrjedh kryesisht nga legjitimiteti i shërbimeve që ofrohen ndaj klientit, i cili posedon/kontrollon pronën private.

Kryesisht, këto janë marrëdhënie juridike që krijohen mbi të drejtat dhe detyrimet e kontratave dhe legjislacionit përkatës kombëtar për kompanitë e sigurisë private për çdo shtet.

Përsa i përket faktorit të dytë, neoliberalizmi zhbën trashëgiminë e qytetarisë pasive dhe ashtu si liberalizmi në shekullin e nëntëmbëdhjetë, neoliberalizmi e vendos tregun si një nga motorët kryesorë të qytetarisë aktive (Kempa & Stenning & Wood 2004, 562-581). Pra në tërësi ky pohim ka të bëjë me qasjen e politikave ekonomike dhe sociale të orientuara drejt tregut privat. Kjo fazë do të evidentohet rreth viteve '80, kur Shearing dhe Stenning do të përkufizonin krijimin e “pronës masive private”. Ata do ta shpjegonin rritjen dhe zhvillimin e policimit privat në funksion të këtyre trendeve të lidhura me tregun privat. Kjo ishte një teori që në fillim do të shpjegohej si përqëndrimi në duart e disa individëve ose korporatave të hapësirave private, por që ishin të hapura për publikun siç mund të ishin supermarketet, fabrikat apo komplekset e punës, hapësirave private të banimit e të tjerë. Fillimisht “prona masive private” do të lulëzonte kryesisht në Amerikën e Jugut, në SHBA dhe më pas edhe në Evropë, kryesisht në Britaninë e Madhe. Në Britaninë e Madhe kjo rritje masive e këtyre hapësirave private tregtare do krijonte edhe disa probleme sociale. Për shembull, qendra tregtare e qytetit të Sheffield do të humbiste 15-20 % të tregut të saj pas hapjes së qendrës tregtare Meadowall apo qendra tregtare e qytetit të Birminghamit do të humbiste rreth 10 % të tregut të saj pas hapjes së qendrës tregtare Merry Hill (Jones & Newburn 1999, 225-244).

Një rast interesant ishte edhe krijimi i hapësirave të përbashkëta të banimit dhe për rrjedhojë edhe zhvillimi i KPS-ve që do t'i siguronin për qëllime komerciale dhe klienteliste. Një evoluim, i cili sipas vlerësimit tim personal, do të gjejë një rritje në vazhdim edhe në tregun evropian duke analizuar zhvillimet sociale të shoqërisë tonë, të shoqëruara me rritjen e kriminalitetit, kryesisht të “krimeve të vogla” apo manifestimi në rritje i sjelljeve kriminale të të miturve. Një shembull i tillë

është edhe hapësira e përbashkët e banimit “Heritage Park”, një qytet i vogël i fortifikuar me mure në Keip Toun, në Afrikën e Jugut. Një nga faktorët kryesorë që çmimet e banesave janë më të larta se të tregut, është edhe ofrimi i një sigurie private të lartë brenda territorit të saj. Për të hyrë në të, banorët duhet të paraqesin një “kartë elektronike smart” dhe vizitorët duhet të kenë leje sigurie para se të lejohen brenda. Në çdo 200 metra janë të stacionuar roje të armatosura përreth një gardhi rrethues të elektrifikuar. Alarmet janë një shërbim ekstra në çdo shtëpi dhe biznes, dhe i tërë kompleksi është nën vëzhgimin e kamerave të sigurisë 24 orë (Flanagan, 2002).

Pra mund të konkludojmë se tashmë individi qëndron në cilësinë e konsumuesit të shërbimit të sigurisë, është i lirë të vendosë vetë në lidhje me sigurimin e tij personal, familjar apo të pronës së tij. Kombinimi i autoritetit publik-privat i ka dhënë një dimension të ri konceptit të policimit. Policimi tradicional tashmë në shumë vende po kalon në shumë reforma, duke çuar kështu në “pluralizimin” e policimit. Ky faktor lidhet ngushtë dhe i jep një dimension të ri faktorit të autoritetit shtetëror. Megjithatë, “fragmentizimi” i autoritetit policor tradicional publik në duart e shërbimeve të tjera nuk duhet të shihet si një proces i ndarë, por si një proces dinamik, në funksion të ofrimit të shërbimeve sa më të mira ndaj qytetarit. Në fund të fundit policimi tradicional publik posedon autoritetin ligjor dhe ka një juridiksion shumë herë më të madh në lidhje me shërbimet e tjera të sigurisë, sikurse mund të themi se policimi privat operon nën një kornizë rregullatore që kontrollohet kryesisht nga autoriteti shtetëror. Përshkrimi i konceptit të pluralizimit të policimit ishte i nevojshëm për të kuptuar riartikulimin e autoritetit shtetëror në ofrimin e shërbimit të policimit dhe atë të sigurisë në përgjithësi.

Ky pluralizëm ka marrë një dimension ndërkombëtar, prandaj ky proces do të mund të quhej “një kuvend global i sigurisë”; struktura hibride dhe komplekse të aktorëve, njohurive, teknologjive, normave dhe vlerave që shtrihen përtej kufijve kombëtarë, por që operojnë në një mjedis

kombëtar (Abrahamsen & Williams 2011, 171-181). Është pikërisht ky fakt, mbi bazën e të cilit, një vëmendje e veçantë duhet t'iu kushtohet zhvillimeve legislative e rregullatore të kësaj veprimtarie. Në ditët e sotme po debatohet vrullshëm në BE për harmonizimin legjislativ të këtij shërbimi kaq të rëndësishëm. Më e rëndësishmja është se legjislacioni kombëtar, rregullues i kësaj veprimtarie, duhet të përshtatet me perspektivën ligjore evropiane, për shembull levizjen e lirë të mallrave dhe sendeve, sikurse mund të jetë siguri i vlerave monetare teksa kalohen kufijtë apo kontrollet në aeroportet ndërkombëtare që janë, midis të tjerash, një pasqyrë e kësaj filozofie e cila kërkon një unifikim të mëtjeshëm, pasi impakti i këtij shërbimi është shumë i madh dhe i tillë pritet të jetë edhe në të ardhmen.



Siç do ta theksonte Nicolas Sarkozy në 2008, me zgjerimin e Bashkimit Evropian, duke përfshirë edhe disa vende të Evropës Lindore, kërkesa për siguri, më shumë se kurrë është më urgjente dhe e fokusuar ndaj cilësisë, për shkak të hendekut të krijuar nga një ulje e pashmangshme në shpenzimet shtetërore dhe ndarjen e misionëve midis segmenteve të ndryshme të tregut të sigurisë (Sarcozy, 2008).

1-Një qasje analitike ndaj KPS-ve në Europë dhe Ballkanin Perëndimor

Nëse do analizonim grafikisht shtetet kryesore të Evropës, do të shihnim se Hungaria ka numrin më të madh të KPS-ve, në total 11 mijë e 304 të tilla, kurse Mbretëria e Bashkuar ka numrin më të madh të punonjësve të sigurisë 364 mijë e 586³.

³ Të dhënat statistikore janë marrë nga COESS – Konfederata e Shërbimeve Evropiane të Sigurisë – Shërbimet e Sigurisë Private në Evropë, Fakte dhe Shifra 2011, <http://www.coess.org>

Europa



Sikurse e përmendëm edhe më sipër, operimi i kompanive private të sigurisë në një mjedis kombëtar, i detyron ato të veprojnë në bazë të ligjeve të atij vendi. Prandaj është e nevojshme që për të kuptuar këtë pohim, të analizojmë shkurtimisht legjislacionin dhe karakteristikat

Shteti	Legjislacioni	Karakteristikat kryesore të KPS
Austria	Akti Regulator i Tregtisë dhe Industrisë (Gewerbeordnung 1994) Nenet 94/62, 129, 249-256, 254-256	KPS - 30000, PSP, 9.000-10.000 Raporti i PSP/Popullsi: 1/523 Raporti i P.Policie/Popullsi: 1/380 • Është e detyrueshme me ligj licencimi i KPS • Kërket licencë e veçantë për KPS të cilat përdorin armë për qëllime të tregut të licencës Autoriteti Policor • Autoriteti përgjegjës për hartimin dhe miratimin e legjislacionit - Autoriteti i Tregtisë (Gewerbebehörde). • Moshë Minimale për PSP 18 vjeç; Menaxherët, 18 vjeç • Moshë mesatare e PSP, 35-40 vjeç • Trajnimi bazë për PSP - 7.5 orë (Trajnimi kryesor në Akademine e Sigurisë dhe financet nga Kompania) • E detyrueshme një e kaluar e paster kriminale • Page Netto, • 1,520 7500 50000 3500 4000 4207
Belgjië	Ligji mbi Sigurinë Private i vitit 1990 (Wet op de Private en Bijzondere Veiligheid) Ligji mbi investigatorët privat 19.06.1991	KPS - 220, PSP -15.411 Raporti i PSP/Popullsi: 1/266 Raporti i P.Policie/Popullsi: 1/266 • Është e detyrueshme me ligj licencimi i KPS • Ligji mbi Sigurinë normon KPS-të të cilat zhvillojnë punën e autoritetit përgjegjës për hartimin e legjislacionit, Ministria e Brendshme, votohet në Parlament dhe hyn në fuqi me Dekret Moretëror • Moshë Minimale për PSP, 18 vjeç; Menaxheret, 21 vjeç

⁴ COESS Shifra dhe Fakte për 2011. Përzgjedhja e shteteve evropiane është bërë në mënyrë rastësore mbi parimin e gjykimit të mirë, duke pasur parasysh shtrirjen gjeografike të këtyre shteteve.

		<ul style="list-style-type: none"> • Moshë mesatare e PSP, 35 vjeç <p>Trajnime bazë për PSP - 127 orë (Trajnime kryhet nga institucione të certifikuara trajnime të licencuara nga Ministria e Brendshme)</p> <ul style="list-style-type: none"> • E detyrueshme një e kaluar e pastër kriminale • Paga Neto, • 1,632 <p>Armët : Vetëm pistoletat me kalibër më të vogël se 10mm</p>
Gjermania	<p>Ligji mbi Aktivitetet Profesionale (Gewerbeordnung) i datës 07.02.1927 i amenduar me 16.06.1998</p> <p>Rregullore mbi Shërbimet e Sigurisë (Verordnung über das Bewachungsgewerbe) i 14.12.1995</p>	<p>KPS - 3700 , PSP -168.000</p> <p>Raporti i PSP/Popullsi: 1/484</p> <p>Raporti I P.Policie/Popullsi: 1/326</p> <ul style="list-style-type: none"> • Është e detyrueshme me ligj licencimi i KPS • Ligji mbi Sigurinë normon KPS të cilat përdorin armë • Autoriteti përgjegjës për hartimin dhe ndryshimin e legjislacionit sikurse për kontroll/inspektim - Departamenti i Tregtisë • Moshë Minimale për PSP 18 vjeç, Menaxheret 18 vjeç • Moshë mesatare e PSP 45 vjeç <p>Trajnime bazë për PSP - 40 orë (Trajnime sigurohet nga Dhoma e Tregtisë dhe financohet nga vete PSP dhe KPS)</p> <ul style="list-style-type: none"> • E detyrueshme një e kaluar e pastër kriminale • Paga Neto, • 1,400 <p>Armët : Nuk ka kufizime për përdorimin e armëve dhe municioneve</p>
Italia	<p>Teksti Unik i Ligjeve të Sigurisë Publike. Dekreti Nr.773 datë 18.06.1931 (TULPS)</p> <p>Rregullorja mbi amendimet të TULPS e 4.09.2008 (Miratuar me Dekretin e Presidentit të Republikës Nr.153)</p> <p>Rregullorja e Ministrisë së Brendshme Nr.557/Pas/10971.10089.D(1)Reg</p>	<p>KPS - 1299 , PSP -47.858</p> <p>Raporti i P.S.P./Popullsi: 1/1260</p> <p>Raporti I P.Policie/Popullsi: 1/565</p> <ul style="list-style-type: none"> • Është e detyrueshme me ligj licencimi i KPS • Autoriteti kompetent për lëshimin e licencës Ministria e Brendshme, administrimi nga Zyra e Prefektit, kontrolli/inspektimi, Autoriteti Policor • Një licencë e veçantë kërkohej për KPS të cilat përdorin armë - Lëshohet nga Prefektura • Moshë Minimale për PSP, 18 vjeç, Menaxheret, 18 vjeç • Moshë mesatare e PSP, 42 vjeç <p>Trajnime bazë për PSP - Nuk ka një orar të përcaktuar (Trajnime sigurohet nga Kompania, financohet nga Kompania dhe donator të tjerë)</p> <ul style="list-style-type: none"> • E detyrueshme një e kaluar e pastër kriminale • Paga Neto, • 1,250 <p>Armët : Nuk ka kufizime për përdorimin e armëve dhe municioneve</p>
Mbretëria e Bashkuar	<p>Akti i Industrisë Private të Sigurisë 2001</p> <p>Instrumentet statusore 2003-2009</p> <p>Rregulloret 2007-2012</p>	<p>KPS - 2500 , PSP -364.586</p> <p>Raporti i P.S.P./Popullsi: 1/170</p> <p>Raporti I P.Policie/Popullsi: 1/382</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nuk është e detyrueshme me ligj licencimi i KPS, është i detyrueshëm licencimi individual për çdo PSP • Autoriteti përgjegjës për hartimin dhe ndryshimin e legjislacionit sikurse për kontroll/inspektim - Autoriteti I Industrisë së Sigurisë (SIA)

		<ul style="list-style-type: none"> • Një liçencë e veçantë kërkohet për KPS të cilat përdorin armë, kjo lëshohet nga Prefektura • Moshë Minimale për PSP, 18 vjeç, Menaxherët 18 vjeç. Trajnimi bazë për PSP, 20.5 orë (Trajnimi sigurohet nga Kompania, mund të financohet nga burime të ndryshme) • E detyrueshme një e kaluar e pastër kriminale • Paga Neto, • 1,823 Armët : Është e ndaluar me ligj mbajtja e armëve
Suedia	Ligji mbi Industrinë Private të Sigurisë i datës 26.04.1974 (1971:191)	<p>Raporti i P.S.P./Popullsi: 1/467 Raporti I P.Policie/Popullsi: 1/522</p> <ul style="list-style-type: none"> • Është e detyrueshme me ligj liçencimi i KPS • Autoriteti kompetent për hartimin/amendimin legjislativ: Bordi Administrativ Policor, mbikqyrës Bordi Administrativ Rajonal i cili është edhe autoriteti inspektim/kontroll i KPS-ve • Moshë Minimale për PSP, 18 vjeç Menaxherët, 20 vjeç • Moshë mesatare e PSP, 30 vjeç Trajnimi bazë për PSP - 288 orë (Trajnimi sigurohet nga Insititute të veçanta për trajnimin mbi sigurinë, financohen nga KPS) • E detyrueshme një e kaluar e pastër kriminale si dhe njohja në nivel profesional e gjuhës Suedeze • Paga Neto, • 1,987 Armët: Përdoren vetëm armë gjysmë-automatike 9 mm

Pasqyrat e mësipërme statistikore na japin një tablo të përgjithshme të funksionimit të KPS-ve në Evropë. Nga analizimi i bërë legjislacionit rregullator të kësaj industrie mund të vërehet se Gjermania dhe Italia kanë qenë vendet e para që kanë parashikuar një legjislacion të tillë, përkatësisht në vitin 1927 dhe 1931, ndjekur më pas nga Suedia, në vitin 1974 dhe shtetet e tjera kanë stabilizuar legjislacionin e tyre pas vitit 1990. Ndoshta ky zhvillim pas këtyre viteve, ka të bëjë me mbizotërimin e politikave ekonomike neoliberales dhe zhvillimin e tregut dhe pronës private, arsye që i analizuam edhe më sipër.

Duke mos pasur një legjislacion të harmonizuar dhe unik, kjo industri ndryshon dukshëm në aplikimin e standardeve të harmonizuara në të gjithë Evropën. Për shembull, përveç karakteristikave kryesore të përbashkëta të sigurisë private si sigurimi i objekteve, mbrojtja e jetës, shoqërimi dhe sigurimi i vlerave monetare në disa vende të caktuara,

siguria private ka evoluar edhe më tej duke prekur edhe fusha të caktuara. Në Austri, për shembull, shoqëritë private të sigurisë kontrollojnë dhe menaxhojnë hyrjet në autostrada sikurse kryejnë edhe patrullimin e tyre; në Gjermani disa KPS kanë autoritetin të trajtojnë edhe disa aksidente të qarkullimit rrugor të një natyre të vogël dhe jo serioze për jetën; në Suedi disa KPS ofrojnë shërbimin e zjarrfikses e të tjerë. Mbretëria e Bashkuar ka shkuar edhe më tej duke i deleguar industrisë private të sigurisë edhe më shumë kompetenca të shërbimit publik, si sigurimin e burgjeve në disa qytete, transportimin e të dënuarve e të tjerë, madje ne ditët e sotme, me rritjen e emigracionit të paligjshëm, një numër në rritje i vendeve të BE-së janë duke përdorur KPS-te për të ruajtur qendrat e mbyllura të emigrantëve, sikurse edhe transportimin e tyre ne rast të largimit nga vendi (Nielsen, 2013).

Ndryshimi i këtyre standardeve shihet në aplikimin e një legjislacioni të ndryshëm në lidhje me licencimin e kompanive, cilësinë dhe fushën e veprimit të tyre, përdorimin e armëve gjatë shërbimit, uniformat dhe shenjat dalluese, pagesat e të tjerë. Liçencimi i KPS-ve në pjesën më të madhe të shteteve evropiane është i detyrueshëm nga ligji kombëtar, kurse, për shembull, në Mbretërinë e Bashkuar nuk ekziston ky kriter. Standarde të ndryshme mund të shihen edhe për liçencimin e punonjësve privat të sigurisë, ku në pjesën më të madhe të vendeve është i detyrueshëm nga ligji, përveç disa vendeve si Austria, Bullgaria e të tjerë. Liçenca për KPS-të akordohet nga institucione të ndryshme; në Gjermani nga Departamenti i Tregtisë e po ashtu në Austri nga Autoriteti i Tregtisë; në Belgjikë, Greqi e Itali nga Ministria e Brendshme; në Spanjë e Luksemburg nga Ministria e Drejtësisë, e të tjerë. Ekzistojnë edhe detyrime specifike, për shembull njohja në mënyre profesionale e gjuhës kombëtare, e detyrueshme kjo në Austri, Qipro, Çeki, Hollandë, Finlandë, Spanjë (gjuha baske dhe katalanase), Suedi e Zvicër. Praktikisht lejohet mbajtja e armëve në të gjitha vendet evropiane, përveç Danimarkës, Irlandës, Hollandës dhe Mbretërisë së Bashkuar. Jo të gjitha vendet

evropiane kanë të ligjëruar aspektin e investigimit privat dhe vendet që e kanë sanksionuar këtë veprimtari në legjislacionin e tyre janë Austria, Holanda, Rumania, Sllovenia e Spanja.

Të gjitha vendet evropiane e kanë ligjëruar faktin që punonjësi i sigurisë duhet të ndërmarre një program trajnimi bazë që varion nga 300 deri në 400 orë në Hungari dhe nga 30 në 90 ore në Sllovaki, Francë dhe Mbretëri e Bashkuar. Ndërkohë që për specialitete të caktuara, si mbrojtja e afërt fizike (bodyguarding), investigimi privat apo siguria detare apo ajrore, kohëzgjatja e trajnimeve është akoma më e madhe se koha e ndërmarre për trajnimin bazë. Është interesant fakti se qentë e shërbimit (K9) mund të përdoren në shumë vende evropiane, përveç se në Bullgari dhe Greqi. Ndërkohë që është më i limituar përdorimi i kuajve të shërbimit, të cilët mund të përdoren në Austri, Belgjikë, Francë, Gjermani e të tjerë. Pagesa ndryshon në të gjitha vendet evropiane duke pasur pagesën më të lartë në Zvicër (paga neto është 2750 •) dhe pagesën më të ulët në Bullgari, përafërsisht 200 •.


E sollëm këtë tablo për të sqaruar faktin se industria e sigurisë private varion në çdo shtet anëtar të BE-së duke pasur parasysh që ndryshimi bazohet në karakteristikat e veçanta të një vendi si ekonomia, politika, zhvillimi social e kulturor e të tjerë. Prandaj edhe unifikimi specifik i legjislacionit evropian mbetet i vështirë edhe për të ardhmen. Megjithatë, ekzistojnë edhe disa nisma ndërkombëtare të ndërmarra në këtë fushë, por që do t'i trajtojmë më poshtë. Është me interes të shohim zhvillimin e kësaj industrie edhe në Ballkanin Perëndimor, pjesë e së cilës është edhe Shqipëria.

4-Një këndvështrim mbi Ballkanin Perëndimor

Kurse persa i përket Ballkanit Perëndimor, i cili konsiderohet i pandashëm nga zhvillimet e industrisë së sigurisë private nga vendet e tjera evropiane, do të shihnim se Serbia ka numrin

më të madh të KPS-ve me 580 të tilla dhe po ashtu edhe numrin e punonjësve të sigurisë private 50 mijë⁵.

Ballkani Perëndimor



Ashtu siç e analizuar edhe më sipër për vendet evropiane, do të ishte me interes të krahasojm legjislacionin përkatës dhe disa karakteristika të veçanta të mënyrës së organizimit të kësaj industrie në Ballkanin Perëndimor⁶

Shteti	Legjislacioni	Karakteristikat kryesore të KPS-ve
Shqipëria	<p>Ligji nr. 8770, datë 19.04.2001 "Për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike", ndryshuar me ligjin 8936/2002, 9343/2005</p> <p>Udhëzimi i MB nr.656, datë 06.10.2009 "Për procedurat e certifikimit, liçencimit dhe kontrollit të veprimtarisë së shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Është e detyrueshme me ligj liçencimi i SHRSF-ve sikurse edhe i punonjësve të sigurisë. Liçenca jepet me afat 3-vjeçar, me të drejtë përtëritjeje. Autoriteti për kontroll/inspektimet e SHRSF është autoriteti policor. • Numri i personelit të SHRSF është deri në 5 % e efektivit të DEQ, ku kjo shoqëri ushtron veprimtarinë, ndërsa numri i amatimit të saj është deri në 2 % të numrit të amatimit të efektivit të DEQ • Paga neto: • 170-200

⁵ Shërbimet e Sigurisë Private në Evropë, CoESS Fakte dhe Shifra 2011.

Të dhënat për Kosovën, KCSS (2009), Vlerësimi i Kompanive Private të Sigurisë. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

Të dhënat për Malin e Zi, Center for security, sociological and criminological research "Defendologija". (2010). Privatna bezbjednost. <http://defendologija.wordpress.com/o-nama/defendologija/bezbjednost/privatna-bezbjednost/>

⁶ Në analizë, për shkak të karakteristikave gjeografike si pjesë e Ballkanit Perëndimor, do të analizohen edhe Kroacia dhe Sllovenia

Kosova	Ligji Nr. 04/ L-004, datë 23.06.2011 për "Shërbimet private të sigurisë"	<ul style="list-style-type: none"> • Është e detyrueshme me ligj liçencimi i KPS • Autoriteti licencues/kontroll/inspektim: Divizioni për shërbimet private të sigurisë në Ministrinë e Brendshme • Armët :Lejohen armë me tytë konvencionale dhe municion të kalibrit 9 x 19mm, me predhë me këmishë të plotë metalike, (Kategoria.B1) • Paga : • 100-350
Serbia	Projektligji mbi sigurinë private (2011) Projektligji mbi detektivët privat	<ul style="list-style-type: none"> • Është e detyrueshme me ligj liçencimi i KPS •Autoriteti kompetent për hartimin/amendimin legjislativ dhe dhënien e liçençës: Ministria e Brendshme; autoriteti inspektim/kontroll i KPS-ve, Autoriteti Policor. •Armët : Lejohen vetëm armë të kalibrit 9 mm dhe jo më shumë se 50% e numrit total të punonjësve lejohet të mbajë armë • Paga Neto, • 200
Mali i Zi	Ligji mbi mbrojtjen e personave dhe të pasurisë (Gazeta Zyrtare e Malit të Zi, nr. 29/ 05)	<ul style="list-style-type: none"> • Është e detyrueshme me ligj liçencimi i KPS • Rregjistrimi KPS duhet bërë pranë Rregjistrimit Qendror të Gjykates Tregtare, kurse autoriteti inspektim/kontrolli është Ministria e Brendshme dhe e Administrimit Publik •Armët : Ekzistojnë kufizime të veçanta në lidhje me përdorimin e armëve në bazë të Ligjit për Armët dhe jo më shumë se 50% e numrit total të punonjësve lejohet të mbajë armë.
Bosnje Hercegovinë	Ligji mbi Agjencinë e Mbrojtjes së Personave dhe Pronës, 2002	<ul style="list-style-type: none"> • Është e detyrueshme me ligj liçencimi i KPS •Autoriteti kompetent për hartimin/amendimin legjislativ: Ministria e Brendshme •Autoriteti inspektim/kontroll i KPS-ve, Autoriteti Policor Rajonal • Paga Neto, • 350 •Armët: Lejohen vetëm armë të kalibrit 9mm (jo armë automatike) dhe jo më shumë se 50% e numrit total të punonjësve lejohet të mbajë armë, lejohet vetëm 1 Shotgun në makinat e transportit të vlerave monetare. Armët nuk lejohen të mbahen të fshehura.
Kroacia	Ligji mbi Sigurinë Private, 22.04.2003, amenduar në mars dhe nëntor, 2010. Ligji mbi armët e zjarrit, 6.06.2007	<ul style="list-style-type: none"> • Është e detyrueshme me ligj liçencimi i KPS •Autoriteti kompetent për hartimin/amendimin legjislativ: Ministria e Brendshme, Inspektoriat i Sektorit të Mbrojtjes Private •Autoriteti inspektim/kontroll i KPS-ve: Autoriteti Policor • Paga Neto, • 420 •Armët: Lejohen vetëm armë gjysmë automatike.
Sllovenia	Akti i Sigurisë Private, 2003 Akti mbi Dedektivët Privat, 2002	<ul style="list-style-type: none"> • Është e detyrueshme me ligj liçencimi i KPS •Autoriteti kompetent për hartimin/amendimin legjislativ: Ministria e Brendshme •Autoriteti inspektim/kontroll i KPS-ve: MB dhe SHKB • Paga Neto, • 550 •Armët: Ekzistojnë kufizime të veçanta në lidhje me përdorimin e armëve/municioneve në bazë të Ligjit për Armët.

Në ndryshim nga vendet e tjera evropiane, kryesisht legjislacioni mbi industrinë e sigurisë private në Ballkanin Perëndimor është prezantuar pas viteve 2000. Praktikisht është një legjislacion i ri, i cili mund të thuhet se është bazuar në praktikat e mira evropiane. Aktualisht vetëm Serbia nuk ka një legjislacion të miratuar për rregullimin e sigurisë private. Mungesa e ligjit në Serbi pengon zhvillimin adekuat të kësaj fushe ekonomike dhe publike, profesionalizmin e saj dhe aftësinë për të mbajtur hapin me tendencat globale (Jovanovic, 2013). Karakteristik mbetet fakti se kryesisht në Ballkanin Perëndimor, është Ministria e Brendshme ajo e cila trajton liçencat e KPS-ve, sikurse është Autoriteti Policor i ngarkuar për kontrollin dhe inspektimin e tyre. Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor e kanë të lejuar të përdorin armë gjatë shërbimeve specifike, por ky fakt është i kufizuar nga ligji kombëtar dhe kryesisht nga ligji për armët; për sasinë dhe llojin e armëve që do të përdoren. Ai që bie në sy është fakti se Sllovenia dhe Bosnje-Hercegovina aplikojnë edhe shërbimin e investigatorëve privat, tashmë të rregulluar me ligj. Ky shërbim ofrohet edhe nga Serbia, megjithëse ligji mbi detektivët privat nuk është miratuar ende. Analizimi i situatës së mësipërme na çon në konkluzionin se legjislacioni është një çështje që po debatohet ende në Evropë, për sa kohë ai nuk është harmonizuar ende. Sfidat kryesore që tashmë i paraqiten kësaj industrie janë strukturimi dhe adaptimi i tyre me tregun evropian, sikurse krijimi i një industrie që të ofrojë profesionalizëm dhe besim; kjo, duke rritur kërkesat për cilësi dhe kualifikime profesionale të stafit të saj.

5-Nismat ndërkombëtare

Edhe pse nuk ka një legjislacion të harmonizuar siç e përmendëm më sipër, sërish janë hedhur hapat e para për aplikimin e disa standardeve ndërkombëtare të përbashkëta për kompanitë private të sigurisë, të cilat janë:

• **Dokumenti i Montreux** (*Mbi Detyrimet Ligjore Ndërkombetare dhe Praktikrat e Mira për Shtetet e Përfshira në*

Operacione të Kompanive Private Ushtarake dhe të Sigurisë gjatë Konfliktëve të Armatosura)⁷, është dokumenti i parë ndërkombëtar në fushën e sigurisë private dhe erdhi si rezultat i iniciativës së ndërmarrë nga Zvicra dhe Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (ICRC) në vitin 2006, sikurse është rikonfirmuar sërish në 2007 dhe 2008. Ky dokument, për të cilin duhet theksuar se nuk është një instrument ligjërishit detyrues dhe nuk ndikon mbi detyrimet ekzistuese të shteteve sipas të drejtës ndërkombëtare, përshkruan kryesisht faktin se si duhet të respektohet e drejta ndërkombëtare në konfliktet e armatosura nga kompanitë private ushtarake dhe të sigurisë (PMSC). Duke qenë se përmban një përmbledhje të praktikave të mira, dokumenti ka si synim të shërbejë edhe si një udhëzues për çështjet praktike dhe ligjore që mund t'i interesojnë këtyre kompanive. Aktualisht janë 46 shtete pjesëmarrëse që kanë nënshkruar këtë dokument, përfshirë edhe Shqipërinë në 2009. Këtij dokumenti, së fundmi i është bashkuar edhe BE në 2012.

• **Kodi i Sjelljes për Shërbimet e Sigurisë Private (ICoC)**⁸ u përpilua si një instrument në respektim të standardeve të të drejtave të njeriut dhe ligjit ndërkombëtar humanitar duke pasur si dokument referencë Dokumentin e Montreux. Ky Kod në vetevete përfshin konceptet bazë që duhen aplikuar nga KPS për të reflektuar pozitivitet dhe profesionalizëm në ofrimin e sigurisë private si për klientet shtetërore, edhe joshtetërore. Si një Kod i pranuar ndërkombëtarisht, ai u nënshkrua fillimisht më 9 nëntor 2010 në Gjenevë, nga 58 kompani private të sigurisë. Deri më 1 shtator 2013 ai është nënshkruar nga 708 KPS nga e gjithë bota. Kodi nuk përcakton detyrime ligjore për kompanite nënshkruese, përtej atyre që tashmë gjenden në ligjin kombëtar

⁷ The Montreux Document. http://www.icrc.org/eng/assets/files/other/icrc_002_0996.pdf

⁸ International Code of Conduct for Private Security Providers (ICoC), http://www.icoc-ppsp.org/uploads/International_Code_of_Conduct_Final_without_Company_Names.pdf

dhe ndërkombëtar, por ai është përpiluar për të qenë një instrument i cili ndihmon për një përputhshmëri, përgjegjësi dhe udëheqje më të mirë nga ana e atyre që ofrojnë shërbimet e sigurisë. Asnjë nga kompanite private të sigurisë në Shqipëri nuk është palë nënshkruese e këtij Kodi.

• **Krijimi i COEES (Konfederata e Shërbimeve Evropiane të Sigurisë⁹)**. CoESS është një konfederatë unike, e njohur zyrtarisht nga institucionet e BE-së. Ajo u themelua më 26 tetor 1989 në Romë, fillimisht nga disa KPS që u përkisnin vendeve anëtare të BE-së dhe tashmë është një organ specifik dhe një nga zërat më përfaqësues të sektorit privat të shërbimeve të sigurisë në nivel evropian. CoESS përfaqëson 19 shtete anëtare të BE-së dhe një total prej 25 vendesh; e thënë ndryshe, rreth 60 mijë kompani private të sigurisë, që punësojnë një total prej 2.2 milionë punonjësish privat të sigurisë. COESS mbështet konceptin “qasje evropiane *one-stop*” për shërbimet e sigurisë private. Sipas filozofisë së ndjekur prej saj, vetëm një qasje e tillë mund të rrisë koordinimin, unifikimin dhe efektivitetin e të gjitha politikave, iniciativave, hulumtimeve dhe programeve që lidhen me sigurinë private në nivel të BE-së. Aktualisht nga rajoni i Ballkanit Maqedonia, Kroacia dhe Sllovenia janë anëtare aktive, kurse Bosnje-Hercegovina dhe Serbia janë anëtare të asociuara të saj. Shqipëria nuk bën pjesë në këtë Konfederatë.

6-Mënyra e organizimit dhe roli i kompanive private të sigurisë në Shqipëri.

Ishte e pashmangshme që ndikimi i shërbimeve të sigurisë private të mos paraqiste efektet dhe sfidat e saj edhe në Shqipëri. Sikurse është përcaktuar nga ligji nr. 8770 “Mbi shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike”, KPS-të në Shqipëri janë të strukturuar si shoqëri të ruajtjes dhe sigurisë fizike të cilat kanë për mision:

⁹ www.coess.org

- a) sigurimin e objekteve publike e private në pronësi ose në përdorim të personave fizikë e juridikë që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë;
- b) sigurimin dhe mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të personave fizikë, shtetas shqiptarë ose të huaj;
- c) shoqërimin e vlerave monetare e materiale ose të sendeve të çmuara gjatë transportimit të tyre.

Nëse fusha e veprimit e tyre do të krahasohej me fushat e veprimit të së njëjtës natyrë, në ligjin rregullator të vendeve të Ballkanit Perëndimor e më tej në Evropë do të shihej se ajo është më e kufizuar dhe e bazuar në shërbimet tradicionale të sigurisë, siç i përmendëm edhe më sipër, por e kufizuar në numrin e punonjësve të shërbimit, i cili duhet të jetë deri në 5 % e efektivit të drejtorisë së policisë së qarkut ku kjo shoqëri ushtron veprimtarinë¹⁰. Këtij fakti i shtohet edhe fakti i “ndalimit” të kompanive të huaja të sigurisë private të operojnë individualisht në territorin shqiptar¹¹ duke kufizuar zhvillimin dhe profesionalizmin e mëtejshëm të kësaj veprimtarie. Hapësira e vetme qëndron te faktin se këto kompani, po sipas ligjit, mund të bashkëpunojnë me SHRSF-të shqiptare të liçencuara për këtë qëllim, por nuk mund të operojnë individualisht¹².

“Ro.gat Security” ishte shoqëria e parë e liçencuar në vitin 1993 në tregun e sigurisë private në Shqipëri dhe aktualisht kjo situatë ka evoluar. Sipas statistikave, në Shqipëri numërohen rreth 350 shoqëri të ruajtjes dhe sigurisë, me një total rreth 7 mijë e 500 punonjës sigurie. Fusha e veprimit e këtyre kompanive është zgjeruar duke iu ofruar shërbimet e tyre të sigurisë private, bankave të ndryshme të nivelit të dytë, bizneseve të ndryshme si shqiptare ashtu edhe të huaja, mbrojtje të afërt fizike për persona të ndryshëm e të tjerë.

¹⁰ Neni 11, par.2

¹¹ Ligji përcakton qartë se drejtuesit teknik dhe punonjësit e shërbimit duhet të jenë shtetas shqiptar me banim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, neni 14 pika “b”, neni 15 pika “b”.

¹² Neni 2, par.1

Ligji 9343, datë 10.2.2005, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8770”, përcakton qartë se liçencimi i SHRSF-ve në Shqipëri është i detyrueshëm me ligj, ndërsa liçenca jepet pasi shoqëria të jetë regjistruar në regjistrin tregtar dhe të ketë të përcaktuar në aktin e themelimit, drejtuesin teknik. Ajo jepet me afat trevjeçar, me të drejtë përtëritjeje, kur nuk kanë ndryshuar kushtet e dhënies së saj. Ndërkohë që sipas ligjit nr. 8770, ekzistojnë edhe kufizime në aplikimin e veprimtarisë së këtyre shoqërive brenda territorit shqiptar, në varësi të kategorizimit të licencës¹³, sikurse edhe në numrin e armatimit, i cili është deri në 2% të numrit të armatimit të efektivit të drejtorisë së policisë së qarkut¹⁴.

Ligji përcakton se punonjësi i shërbimit, para dhënies së lejes së ushtrimit të profesionit, i nënshtrohet një kursi kualifikimi për një periudhë kohe jo më pak se 15 ditë, nën drejtimin e drejtuesit teknik të shoqërisë dhe në përfundim të këtij kursi testohet nga një komision i posaçëm, i krijuar nga organi lëshues i lejes. Megjithatë, punonjësi i shërbimit i nënshtrohet kurseve të kualifikimit të organizuara nga shoqëria, të cilat zgjasin jo më pak se 5 ditë në çdo vit kalendarik. Interesant është fakti se ligji lejon përdorimin e qenve të shërbimit (K9) në aktivitetin ditor të punonjësve të sigurisë si në shumë vende evropiane, megjithatë një praktikë jo fort e ndjekur nga ana e SHRSF-ve. Për të mbrojtur interesat social-ekonomike të punonjësve të sigurisë private, është krijuar Sindikata e Punonjësve të Sigurisë.

Në tërësi korniza ligjore që rregullon këtë veprimtari është e një niveli të përafërt me atë të vendeve të rajonit dhe disa vendeve evropiane, megjithatë ka ende fusha që mund të përmiresoheshin në të ardhmen. Kjo, për vetë faktin se duhet

¹³ Shoqëritë e pajisura me liçencë të kategorisë “a” ushtrojnë veprimtari brenda juridiksionit territorial të qarkut të përcaktuar në liçencë. Shoqëritë e pajisura me liçencë të kategorisë “b”, “c” dhe “a+b” ushtrojnë veprimtari në të gjithë territorin e vendit.

¹⁴ Ibid.Neni 11

kuptuar që procesi i zhvillimit të shërbimit të sigurisë private nuk është një proces statik, por dinamik që duhet të përshtatet me zhvillimet e vrullshme të shoqërisë sonë. Nga një vlerësim i përgjithshëm i aktivitetit të SHRSF-ve në Shqipëri, me qëllim rritjen e performancës në ofrimin e shërbimeve dhe paraqitjen sa më dinjitoze në publik, mund të sugjeroja rekomandimet përkatëse:

- Rritja e nivelit të profesionalizmit, e shprehur në dy drejtime:

- a. rritja e kërkesave të pranimit nga ana e SHRSF-ve të punojësve të sigurisë private duke u fokusuar më shumë në nivelin edukativ, për të përfituar një staf kualitativ;

- b. ofrimi i pagesave më të larta dhe konkurrese në treg, si një faktor tërheqës i një niveli më cilësor të punonjësve të sigurisë private.

- Është e nevojshme të kryhet harmonizimi, standardizimi dhe unifikimi i kurrikulave të trajnimit bazë për punonjësit e sigurisë private.

- Armët e përdorura nga SHRSF-të, si për shembull AK-47 (*një armë tepër e fuqishme*), nuk janë të përshtatshme për kryerjen e shërbimeve të sigurisë, prandaj mund të rekomandohej përdorimi i armëve gjysëm automatike 9 mm duke ndjekur praktikën e mira të vendeve evropiane, si për shembull Suedia ose vendeve të rajonit si Bosnje-Hercegovina dhe Serbia.

- Rritja e përfaqësimit të gjinisë femërore në këtë veprimtari.

- Një qasje më të shpeshtë nga ana e hulumtuesve në fushën e sigurisë për të prezantuar studime dhe kërkime të përditësuara në lidhje me këtë veprimtari kaq të rëndësishme

- Bashkëpunimi më i shpeshtë dhe më i konsoliduar ndërmjet vetë kompanive private të sigurisë, por edhe me autoritete të tjera shtetërore dhe jo-shtetërore. Diçka inovative do të ishte zhvillimi i tryezave të përbashkëta dhe shkëmbimit të praktikave më të mira në fushën e sigurisë private edhe me vendet e rajonit.

- Një ndërgjegjësim më i madh ndaj respektimit të të drejtave të njeriut në tërësi. Për realizimin e kësaj qasjeje mund të ishte me interes vlerësimi i nënshkrimit dhe

implementimit të Kodit të Sjelljes për Shërbimet e Sigurisë Private (IcoC).

- Aderimi në organizatat ndërkombetare si për shembull COESS për standardizimin dhe harmonizimin e politikave dhe aktiviteteve të përbashkëta në nivel evropian.

Përfundime

Siç e analizuam edhe më sipër, industria e sigurisë private është ndoshta një nga zhvillimet më unike gjatë viteve të fundit në shoqërinë tonë, në fushën e sigurisë. Globalizimi i sigurisë si në aspektin ekonomik, po ashtu edhe në atë ligjor, ka ndryshuar dhe ndikuar shumë në organizimin e shërbimit publik tradicional të sigurisë; pra ka ndodhur fragmentarizimi i atij pushteti, që tradicionalisht është menduar së është monopol i shtetit. Kombinimi i autoritetit publik-privat i ka dhënë një hov tjetër konceptit të policimit duke çuar kështu në të ashtuquajturin koncept të “pluralizimit” të policimit.

Megjithatë, në Evropë kjo degë e policimit të pluralizuar ka hasur vështirësi në aplikimin e shërbimeve të saj, për shkak të mospasjes së një legjislacioni të harmonizuar dhe të unifikuar, kjo edhe për shkak të ndryshimeve shumëplanëshe që kanë përjetuar vetë vendet anëtare si ndryshimet politike, kulturore, ekonomike, sociale e të tjerë.

E njëjta situatë shihet se është reflektuar edhe në Ballkanin Perëndimor, përfshirë Shqipërinë. Dokumenti i Montreux, Kodi i Sjelljes për PSP-të janë dhe hapat fillestare që shtetet kanë hedhur për harmonizimin e kësaj veprimtarie në aspektin ndërkombëtar. Industria e sigurisë private do të vazhdojë të ketë një ndikim të mëtejshëm në shoqërinë tonë, përsa kohë që ajo paraqet një investim prej biliona eurosh në Evropë dhe më gjerë, prandaj në të ardhmen do të kërkohet me vendosmëri një harmonizim koherent të standardeve të saj.

Referenca

1. Abrahamsen, Rita & Williams, C. Michael. (2007). Securing the City: Private Security Companies and Non-State Authority in Global Governance. *International Relations*, 21(2): 237-253
2. Abrahamsen, Rita & Williams, C. Michael. (2011). Security Privatization and Global Security Assemblages. *Brown Journal of World Affairs*, 28 (1): 171-181
3. Berg, Julie & Nouveau, Jean-Pierre. (2011). 'Towards a Third Phase of Regulation: Re-Imagining Private Security in South Africa', *SA Crime Quarterly*, 38:23-32.
4. Konfederation of European Security Services (CoESS), (2011). Private Security Services in Europe – *CoESS Facts & Figures 2011*, [http://www.coess.eu/_Uploads/dbsAttachedFiles/Private_Security_Services_in_Europe-CoESS_Facts_and_Figures_2011\(1\).pdf](http://www.coess.eu/_Uploads/dbsAttachedFiles/Private_Security_Services_in_Europe-CoESS_Facts_and_Figures_2011(1).pdf)
5. Donnelly, C. Karen. (1992). Domestic Security: The Holmes Burglar Alarm Telegraph, 1853-1876. University of Pennsylvania, f.20. <http://ia70049.us.archive.org/25/items/domesticsecurity00donn.pdf>
6. Flanagan, Jane. (2002). Safe within these walls. Artikull, <http://www.telegraph.co.uk/property/propertyadvice/propertymarket/3306400/Safe-within-these-walls.html>
7. Hess, M. Kären. (2009). Introduction to Private Security. Wadsworth Cengage Learning, f. 13
8. Jones, Trevor. & Newburn, Tim. (1999). Urban Change and Policing: Mass Private Property Re-Considered. *European Journal on Criminal Policy and Research*, 7 (2): 225–244
9. Jovanovic, Ivana. (2013). Serbia moves to regulate private security sector. Artikull, http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/features/2013/08/17/feature-02
10. International Code of Conduct for Private Security Providers (ICoC), http://www.icoc-ppsp.org/uploads/International_Code_of_Conduct_Final_without_Company_Names.pdf
11. Kempa, Michael. & Stenning, Philip. & Wood, Jennifer. (2004). Policing Communal Spaces. A Reconfiguration of the “Mass Private Property” Hypothesis. *British Journal of Criminology*, 44 (4): 562-581
12. Ligji nr.8770, datë 19.4.2001 “Për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike”. Fletorja Zyrtare nr.23 datë 18.05.2001

13. Ligji nr. 9343 datë 10.2.2005, Për disa ndryshime në ligjin nr. 8770, datë 19.04.2001 “Për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike”. Fletorja Zyrtare nr.17 datë 25.03.2005
14. The Montreux Document. http://www.icrc.org/eng/assets/files/other/icrc_002_0996.pdf
15. Nicolas Sarcozy, (2008). Preface. Private Security and its Role in European Security. CoESS & INHES, First Private Security Summit White Book. http://www.coess.eu/Uploads/dbsAttachedFiles/CoESSINHES_White_Book_Private_Security_and_its_Role_in_European_Security.pdf
16. Nielsen, Nikolaj. (2013). Private Security Firms Cash in on Guarding EU borders. Artikull, <http://euobserver.com/priv-immigration/121454>
17. *Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS)*. (2009). Vlerësimi i kompanive private të sigurisë <http://qkss.org/web/images/content/PDF/Vler%C3%ABsimi%20i%20kompanive%20private%20t%C3%AB%20siguris%C3%AB1.pdf>

Legjislacioni online për vendet evropiane:

Austria

Gewerbeordnung 1994 - Akti Regullator i Tregtisë dhe Industrisë

<http://www.ris.bka.gv.at/GeltendeFassung.wxe?Abfrage=Bundesnormen&Gesetzesnummer=10007517>

Belgjika

Wet op de Private en Bijzondere Veiligheid - Ligji mbi Sigurinë Private

http://www.ejustice.just.fgov.be/cgi_loi/change_lg.pl?language=nl&la=N&cn=1990041033&table_name=wet

Amenduar me date 03/08.2012 Shih: https://vigilis.ibz.be/upload/documents/20120803_wetswijziging_KB04062006-afbakeningplaatsen.pdf

Wet tot regeling van het beroep van privé-detective - Ligji “Mbi investigatorët privat”

http://www.ejustice.just.fgov.be/cgi_loi/change_lg.pl?language=nl&la=N&table_name=wet&cn=1991071933

Gjermania

Gewerbeordnung i vitit 1927, ndryshuar me 1998 - Ligji “Mbi Aktivitetet Profesionale”

<http://www.gesetze-im-internet.de>

Verordnung über das Bewachungsgewerbe - Rregullore mbi Shërbimet e Sigurisë

<http://www.berlin.de/imperia/md/content/balichtenberghohenschoenhausen/gesetzevorschriften/bewachungsvo.pdf?start&ts=1299099362&file=bewachungsvo.pdf>

Italia

Testo unico delle leggi di pubblica sicurezza - Teksti Unik i Ligjeve të Sigurisë Publike

http://psm.du.edu/media/documents/national_regulations/countries/europe/italy/italy_law_on_public_security_1931-italian.pdf

Regolamento recante modifiche al regio decreto 6 maggio 1940, n. 635

<http://www.dplmodena.it/DPR-153-08.pdf>

Regolamento Nr.557/Pas/10971.10089.D(1)Reg

<http://www.federsicurezza.it/public/documenti/282201195412.pdf>

Mbretëria e Bashkuar

The Private Security Industry Act 2001 - Akti i Industrisë Private të Sigurisë 2001

<http://www.sia.homeoffice.gov.uk/Pages/about-legislation.aspx>

Suedia

Lag (1974:191) Om Bevakningsföretag - Ligji mbi Industrinë Private të Sigurisë

http://psm.du.edu/media/documents/national_regulations/countries/europe/sweden/sweden_law_on_the_private_security_industry_1974-swedish.pdf

Legjislacioni online për vendet e Ballkanit Perëndimor:

Kosova

Ligji Nr. 04/ L-004 “Për shërbimet private të sigurisë”

[http://www.mpbks.org/repository/docs/Ligji%20per%20Shërbimet%20Private%20te%20Sigurise%20\(shqip\).pdf](http://www.mpbks.org/repository/docs/Ligji%20per%20Shërbimet%20Private%20te%20Sigurise%20(shqip).pdf)

Serbia

Predlog zakona o privatnom obezbeđenje – Projekt-Ligji mbi sigurinë private

<http://www.zakon.co.rs/predlog-zakona-o-privatnom-obezbedjenju.html>

Predlog zakona o detektivskoj delatnosti - Projekt-Ligji mbi dedektivët privatë

<http://www.zakon.co.rs/predlog-zakona-o-detektivskoj-delatnosti.html>

Mali i Zi

Zakona o zaštiti lica i imovine i osnovne odredbe - Ligji mbi Mrojtjen e Personave dhe të Pasurisë

[http://www.visit-mba.org/userfiles/file/
Zakon%20o%20zastiti%20lica%20i%20imovine.doc](http://www.visit-mba.org/userfiles/file/Zakon%20o%20zastiti%20lica%20i%20imovine.doc)

Maqedonia

Ëdââëëîê - Ligji mbi Sigurinë e Personave dhe Pronës

[http://psm.du.edu/media/documents/national_regulations/countries/
europe/macedonia/macedonia_regulation_on_the_
licensing_of_private_security_companies_2000-macedonian.pdf](http://psm.du.edu/media/documents/national_regulations/countries/europe/macedonia/macedonia_regulation_on_the_licensing_of_private_security_companies_2000-macedonian.pdf)

Bosnje-Herzegovina

Ligji mbi Agjensinë e Mbrojtjes së Personave dhe Pronës

[http://psm.du.edu/media/documents/national_regulations/countries/
europe/bosnia_herzegovina/bosnia_and_herzegovina_
law_on_private_protection_agencies_and_detective_2002-
english.pdf](http://psm.du.edu/media/documents/national_regulations/countries/europe/bosnia_herzegovina/bosnia_and_herzegovina_law_on_private_protection_agencies_and_detective_2002-english.pdf)

Kroacia

Zakon o privatnoj zaštiti – Ligji mbi Sigurinë Private

<http://www.mup.hr/145.aspx>

Sllovenia

Zakon o zasebnem varovanju - Ligji mbi Sigurinë Private

<http://www.uradni-list.si/1/objava.jsp?urlid=201117&stevilka=690>

Zakona o detektivski dejavnosti - Ligji mbi Detektivët Privat

<http://www.uradni-list.si/1/content?id=102526>

Doktorant Kol (R) Thimi Hudhra
Zv/drejtor i Qendrës Kombëtare të Sigurisë dhe Mbrojtjes

KONCEPTI STRATEGJIK I SIGURISË
 DHE I MBROJTJES SË REPUBLIKËS
 SË SHQIPËRISË SI VEND ALEAT

Abstrakt

Në dy dekadat e fundit, koncepti i sigurisë dhe i mbrojtjes kombëtare ka pësuar ndryshime të thella në teori dhe në praktikë. Gjatë luftës së ftohtë shumica e vendeve ishin kapur nga ethet e agresioneve të befasishme të kundërshtarëve të tyre ideologjikë, qëllimet dhe objektivat e të cilëve shkonin deri në pushtimin e territoreve kombëtare, humbjen e sovranitetit dhe të pavarësisë së vendit, deri në asgjësimin total të kundërshtarit, pa kursyer as popullsitë e tyre.

Pas mbarimit të Luftës së Ftohtë, shtetet në Lindje dhe në Perëndim filluan një rishikim të politikave të tyre sigurisë dhe të mbrojtjes. Çdo shtet, më vete ose në kuadrin e organizmave të sigurisë, u vu në kërkim të një sistemi që të pasqyronte realitetin e ri të sigurisë në zhvillim. Disa shtete ishin më të avancuar, disa më të vonuar, megjithatë realiteti i sotëm është një mjedis krejt i transformuar, krahasuar me 20 vite më parë. Reforma të thella janë kryer veçanërisht në transformimin e forcave ushtarake. Shumë analistë në vendet e zhvilluara aleate e konsiderojnë këtë si fazën e parë të një “revolucionit në Çështjet Ushtarake”.

Sot jetojmë në epokën e globalizimit të informacionit, të hapjes së ekonomisë dhe të lëvizjes së lirë, të cilat po sjellin një frymë të re në marrëdhëniet midis shteteve, grupeve dhe njerëzve. Kjo epokë ka sjellë ndryshime të paimagjinueshme. Gjërat që 20 vjet më parë bëheshin për vite, muaj dhe ditë, sot bëhen për ditë, orë dhe minuta; nesër pritjet të bëhen akoma edhe më shpejt. Epoka e informacionit, si një element thelbësor i fuqisë kombëtare, po përshpejton ndjeshëm zhvillimin e

historisë në shtigje tërësisht të panjohura më parë. Por ajo po shoqërohet gjithashtu me rreziqe dhe sfida të reja.

Pyetjet qendrore të këtij “*concept paper*” janë: Si do ta sigurojmë dhe mbrojmë vendin tonë në dekadat që vijnë? A duhet të kemi ndonjë mendim që tani? Ku duhet të bazohet ky qëndrim? Cilat janë pritjet dhe tendencat e zhvillimit të mjedisit të sigurisë globale, rajonale dhe kombëtare? Çfarë ndryshimesh duhet të përgatitemi të bëjmë në sistemin e sigurisë kombëtare? Për çfarë duhet të përgatitemi sot për t’u përballur nesër? Cili do të jetë spektri i operacioneve të ardhshme të Forcave të Armatosura të RSH? Së fundi, çfarë kapacitetesh duhet të zhvillojnë forcat tona për kryerjen e tyre?

Hyrje

Tendenca themelore e mjedisit të sigurisë së ardhshme është transferimi i një pjese të autoriteteve të sigurisë kombëtare drejt organizmave të sigurisë ndërkombëtare apo rajonale. Shumë analistë parashikojnë që shtetet-kombe do të vazhdojnë të mbeten aktorët gjeopolitikë kryesorë në nivel global edhe për shumë dekada në vijim, por nën efektet e globalizimit në rritje, pritet që mjedisi i ardhshëm i sigurisë të krijojë një ndërvarësi më të madhe midis shteteve, si dhe një ndryshim të elementit të fuqisë nga shtetet individuale drejt organizatave, rrjeteve, apo korporatave shumëkombëshe.

Parashikimet janë që mënyra se si do të ushtrohet sovraniteti i shteteve pritet të ndryshojë në dekadat e ardhshme. Kjo ndërvarësi më e madhe e shteteve do të shoqërohet me përfitime të konsiderueshme. Veprimi i përbashkët në rritje do të rritë më tej mirëkuptimin dhe do të ulë ndjeshëm mundësinë e konflikteve ndërshtetërore¹.

Si pjesë e realitetit të sigurisë globale, edhe vendi ynë do të adaptojë rast pas rasti qëndrime racionale, ku pjesë të sovranitetit kombëtar mund t’i transferohen organizmave ndërkombëtarë ku ne aderojmë, bazuar në traktatet dhe konventat ndërkombëtare.

¹ AJP-1 (D) Doktrina e Përbashkët e Aleancës, botim shqip, faqe 28

Evoluimi i Konceptit të Sigurisë në shekullin e XXI

Me integrimin në organizmat rajonale e ndërkombëtarë, më shumë se kurdoherë më parë, Shqipëria është bërë pjesë e realitetit rajonal dhe global në fushën e sigurisë. Në një botë gjithmonë e më të globalizuar, nuk mund të ketë siguri kombëtare pa siguri rajonale dhe globale.

Pas prillit 2009, Koncepti i Sigurisë së Shqipërisë është i lidhur ngushtë me konceptin e sigurisë së Aleancës së Atlantikut Verior. Planifikimi i sigurisë dhe i mbrojtjes së vendit tonë do të bëhet në përputhje me planifikimin e sigurisë dhe të mbrojtjes kolektive, si dhe me skenarët dhe situatat e planzimit të Aleancës. Duke qenë se Shqipëria aspron dhe punon për të qenë pjesë e BE-së, duhet të mbahet në konsideratë edhe pjesëmarrja në operacione nën konceptin e ESDP-së.

Në 20 vitet e fundit, FASH kanë marrë pjesë në operacione ushtarake në tre kontinente të globit, nën drejtimin e NATO-s, të BE-së, të OKB-së ose të koalicioneve të rastit (*ad-hoc coalitions*). Po ashtu, ato kanë marrë pjesë në dhjetëra operacione kombëtare në ndihmë të popullsisë civile duke mbështetur autoritetet vendore dhe qendrore. Gjatë kësaj periudhe FASH kanë grumbulluar përvojë të jashtëzakonshme, praktika të mira, por edhe mësim të nxjerra, të cilat janë pasqyruar në këtë doktrinë.

Në të ardhmen pritet që harta e operacioneve ku FASH mund të angazhohen, të jetë më e gjerë dhe e larmishme, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Po ashtu, më shumë se më parë, përgatitja dhe përdorimi i tyre do të bëhet përgjatë gjithë spektrit të konfliktit, sipas konceptit të operacioneve të spektrit të plotë.

Evoluimi i mjedisit të sigurisë do të ndikojë jo vetëm në qasjet sesi zhvillohen operacionet e forcave ushtarake, por edhe në kombinimin e fuqisë luftarake me atë të komponentëve të tjerë të fuqisë kombëtare, si dhe të zhvillimit të kapaciteteve që i kalojnë mundësitë e një shteti. Një nga këto është koncepti “*smart defence*”, ku vendet synojnë që në 10 vitet e ardhshme të fokusohen në zgjidhjet shumëkombëshe, në ripërcaktimin e përparësive të ardhshme dhe në specializimin *niche* të tyre.

Kuadri i Konceptit të Sigurisë së Republikës së Shqipërisë

Në shekullin e XXI, koncepti i sigurisë në tërësi dhe koncepti i sigurisë së RSH kanë evoluar ndjeshëm. Koncepti i sigurisë së vendit përcakton masat përkatëse për ruajtjen dhe avancimin e interesave kombëtare të RSH, me mjete politike dhe ushtarake. Ai shpreh objektivat, mënyrat dhe mjetet që do të përdoren nga vendi ynë për arritjen e sigurisë në dhjetë vitet e ardhshme.

Kuadri i Sigurisë së RSH i përmbahet Konceptit të Gjerë të Sigurisë, i cili përbëhet nga Siguria Shtetërore, Siguria Shoqërore dhe Siguria Njerëzore².

Në kuadrin e Konceptit të Gjerë të Sigurisë, siguria dhe mbrojtja e vendit tonë nuk është vetëm çështje e forcave të armatosura. Ajo është përgjegjësi edhe e shumë institucioneve të tjera të shtetit. Po ashtu, siguria dhe mbrojtja kolektive e Aleancës nuk është vetëm çështje e forcave të armatosura të shteteve aleate. Ajo është gjithashtu një përgjegjësi gjithëpërfshirëse e shumë institucioneve të tjera qeveritare ose joqeveritare, me misione dhe interesa në këtë fushë.

² **Siguria Shtetërore** lidhet më shumë me masat për sigurinë dhe mbrojtjen tradicionale të vendit dhe ka të bëjë kryesisht me ruajtjen e sovranitetit, mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe të pavarësisë. Shqipëria, në përputhje me Nenin 5 të Traktatit të Uashingtonit, respekton parimin themelor të sigurisë dhe mbrojtjes kolektive.

Siguria Shoqërore lidhet me sigurinë dhe mbrojtjen e popullsisë civile dhe të grupeve shoqërore nga emergjencat e shkaktuara nga natyra, incidentet industriale ose gabimet njerëzore, si dhe nga terrorizmi, kërcënimet asimetrike e hibride, krimi i organizuar, korrupsioni, trafiket etj. Mbrojtja e shoqërisë në kohë paqeje, krize e lufte është një nga detyrat kryesore të institucioneve të sigurisë së vendit.

Siguria Njerëzore synon mbrojtjen e te drejtave të njeriut sipas Rezolutës 1674 të OKB në kuadrin e "*përgjegjësisë për të mbrojtur*" popullsitë nga gjenocidi, krimet kundër njerëzimit, spastrimet etnike, krimet e luftës e të tjerë. Sipas rastit, Shqipëria merr pjesë dhe kontribuon për sigurinë njerëzore, bazuar në ligjin ndërkombëtar dhe kushtetutën e vendit, duke bashkuar përpjekjet me institucionet ndërkombëtare ku ajo është anëtare.

Brenda Konceptit të Gjerë të Sigurisë, instrumenti ushtarak (Forcat e Armatosura) ka hapësirën kushtetuese për t'u përgatitur dhe angazhuar për sigurinë shtetërore, sigurinë shoqërore dhe njerëzore; në rol kryesor, mbështetës ose kontribues. Në këtë kuadër, kjo Doktrinë e Përbashkët e FASH ofron zgjidhjet më të sigurta, me cilësinë më të lartë dhe koston më të ulët për sigurinë e vendit tonë.

Qëllimi i zhvillimit dhe mbajtjes së Forcave të Armatosura (FASH).

Mbrojtja e vendit është një e drejtë legjitime që bazohet në Kushtetutën e RSH, në të drejtën për vetëmbrojtje të ligjit ndërkombëtar, të parashikuar në nenin 51 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, si dhe në nenin 5 të Traktatit të Atlantikut të Veriut, ku Shqipëria bën pjesë. Qëllimi i zhvillimit dhe mbajtjes së FASH është që vendi ynë të disponojë një instrument të besueshëm të fuqisë ushtarake, të bashkërenduar me instrumentet e tjera të fuqisë kombëtare, si dhe ato aleate, për të përballuar kërcënimet dhe rreziqet ndaj sigurisë kombëtare, tani dhe në të ardhmen.

Fuqia ushtarake do të përdoret bazuar në Konceptin e Gjerë të Sigurisë në kohë paqeje, krize dhe luftime. Përdorimi i saj në të ardhmen parashikohet të bëhet në një spektër edhe më të gjerë duke përfshirë pjesëmarrjen në veprimtari të tilla: nga parandalimi i konflikteve, lehtësimi i pasojave nga fatkeqësi të ndryshme, operacionet e mbështetjes së paqes dhe të stabilizimit e deri në rastet e konflikteve të ndryshme.

Në të gjitha rastet, Shqipëria do të përdorë forcën e saj ushtarake vetëm si mjet të fundit, kur të jenë shterur të gjitha opsionet e tjera dhe vetëm nëpërmjet vendimmarrjes së autoriteteve legjitime. Ajo, në asnjë rrethanë, nuk do ta përdorë forcën ushtarake si qëllim në vetvete për aneksimin e territoreve të tjera.

Misioni dhe objektivat e FASH

Bazuar në Kushtetutën e RSH, “Forcat e Armatosura sigurojnë pavarësinë e vendit, si dhe mbrojnë tërësinë territoriale dhe rendin e tij kushtetues”³, ndërsa në Strategjinë Ushtarake thuhet se “misioni i Forcave të Armatosura është: ruajtja e pavarësisë, sovranitetit dhe tërësisë territoriale të vendit, mbrojtja dhe mbështetja e popullit në kohë paqeje, krize e lufte, si dhe dhënia e kontributit për paqen dhe sigurinë në rajon e më gjerë”⁴.

Për efekt të këtij projekti studimor, definicionet e sovranitetit, të pavarësisë, dhe të tërësisë territoriale janë nocione që plotësojnë dhe ndërthuren me njeri tjetrin e që kanë evoluar nga Sokrati te Tomas Hobsi, e deri në epokën e sotme moderne⁵.

Në përmbushjen e misionit kushtetues të tyre, FASH do të përgatiten dhe do të angazhohen për arritjen e tre objektivave kryesorë ushtarakë:

a. Objektiv i parë ka të bëjë me misionin klasik të çdo force të armatosur, pra me angazhimin e FASH për të garantuar sovranitetin, pavarësinë dhe mbrojtjen e territoreve të vendit nga një agresion i mundshëm nga jashtë. Ky është objektiv

³ Kushtetuta e RSH, neni 12, pika 2

⁴ Strategjia Ushtarake 2007, kapitulli 4, pika 4.1

⁵ **Sovraniteti.** Sovraniteti është statusi ligjor që shpreh të drejtën e zotërimit të autoritetit suprem dhe të pavarur për të bërë dhe zbatuar ligjin dhe ushtruar kontrollin e popullsisë në një territor apo zonë gjeografike të caktuar, autoritet që njihet nga shtetet e tjera sovrane si zotërues dhe bartës i vetëm i kësaj të drejte. Në shtetet e demokracisë parlamentare, autoriteti sovran është Parlamenti. **Tërësia Territoriale,** sipas të drejtës ndërkombëtare, është parimi që shpreh se territori që përfshihet brenda kufijve të përcaktuar e të njohur ndërkombëtarisht nën sovranitetin e një shteti të caktuar, është një dhe i pandashëm. Tërësia territoriale përfshin hapësirën tokësore, detare dhe ajrore. Ushtrimi i forcës për ndryshimin e kufijve të territorit përbën një akt agresioni. **Pavarësia** e një shteti është e drejta politike e tij për të ushtruar pushtet politik në të gjithë territorin dhe popullsinë që banon brenda kufijve të përcaktuar e të njohur ndërkombëtarisht, duke qenë i pavarur nga influenza, kontrolli apo vendimmarrja e shteteve të tjerë.

themelor i FASH, ku ato luajnë rol kryesor. Në përmbushjen e këtij objektivi, FASH kanë mbështetjen e të gjithë kapaciteteve kombëtare të vendit, publike e private, sipas konceptit të gjithëpërfshirjes. Planifikuesit në nivelin strategjik duhet të mbajnë parasysh që ky objektivi, që ka të bëjë me ekzistencën e vendit dhe të popullit shqiptar, do të planëzohet në kuadrin e skenarëve a situatave të planëzimit të Aleancës ose atyre kombëtarë. Po ashtu, Shqipëria dhe Forcat e saj të Armatosura, do t'i përmbahen detyrimeve e kërkesave që rrjedhin nga neni 5 i mbrojtjes kolektive të Aleancës.

b. Objektivi i dytë ka të bëjë me angazhimin e FASH brenda vendit për mbrojtjen dhe mbështetjen e popullit shqiptar. Ky është një objektivi i rëndësishëm i FASH, ku ato luajnë rol mbështetës. FASH mbështetin institucione të tjera të shtetit në kohë paqeje, krize e lufte, sipas autoritetit që u jep ligji. Për këtë mision, FASH planëzojnë, përgatiten dhe bashkërendojnë duke vënë në dispozicion kapacitetet e tyre në përputhje me planet e situatave të veçanta të institucionit që mbështetet.

c. Objektivi i tretë ka të bëjë me angazhimin e FASH për mbështetjen e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare. Ky është një objektivi tjetër i rëndësishëm i FASH, ku ato luajnë rol kontribues. Rast pas rasti, Shqipëria do të kontribuojë në nismat dhe operacionet shumëkombëshe me mandat të organizmave legjitime ndërkombëtare, për menaxhimin e krizave dhe mbështetjen e paqes e të sigurisë rajonale e ndërkombëtare.

Shqipëria dhe mbrojtja kolektive

Si vend anëtar i NATO-s, qysh prej prillit 2009, Shqipëria ka përfitime dhe detyrime ndaj sigurisë dhe mbrojtjes kolektive, sipas nenit 5 të Traktatit të Uashingtonit⁶. Strategjia e Sigurisë

⁶ Neni 5 i Traktatit të Uashingtonit shprehet se *“palët bien dakord se një sulm i armatosur kundër një apo më shumë prej tyre në Evropë apo në Amerikën e Veriut, do të konsiderohet si sulm kundër të gjitha Palëve, dhe si pasojë bien dakord që, nëse ndodh një sulm i tillë, secila nga ato, në ushtrim të të drejtës së vetëmbrojtjes kolektive apo individuale të njohur nga neni 51*

e RSH mbështetet dhe mbështet detyrat themelore të sigurisë të Konceptit Strategjik të Aleancës, të cilat janë: mbrojtja kolektive, menaxhimi i krizave dhe bashkëpunimi për sigurinë.

Parimi themelor i mbrojtjes kolektive të Aleancës është parimi i bashkëpunimit dhe i sigurisë së ndërsjelltë. Nëse ndonjë nga anëtarët e saj kërcënohet, të gjithë anëtarët e tjerë janë të cënuar. Çdo shtet anëtar angazhohet për respektimin e këtij parimi themelor, duke ndarë me shtetet e tjera anëtare si rreziqet e përgjegjësitë, ashtu dhe avantazhet e mbrojtjes kolektive. Pa u hequr të drejtën anëtarëve të saj që të marrin masa individuale për mbrojtjen sovrane të tyre, Aleanca garanton sigurinë dhe mbrojtjen e aleatëve të saj nëpërmjet sistemit të planifikimit të mbrojtjes kolektive.

Koncepti Strategjik i mbrojtjes së vendit.

Koncepti Strategjik i mbrojtjes së vendit mbështetet në Kushtetutën e RSH, në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare dhe në Strategjinë Ushtarake të RSH. Si vend aleat, Koncepti Strategjik i mbrojtjes së vendit bazohet edhe në Konceptin Strategjik të Aleancës (2010) , i cili “udhëheq fazën tjetër të evolucionit të NATO-s, duke siguruar një angazhim efektiv të saj në një botë në ndryshim, kundër kërcënimeve të reja, me kapacitete të reja dhe me partnerë të rinj”.

Siguria dhe mbrojtja e vendit është detyrë dhe atribut i institucioneve dhe autoriteteve kushtetuese të vendit. Bazuar në Ligjin e Pushteteve dhe Autoriteteve të Komandimit dhe Drejtimit Strategjik të FASH, ato kanë përgjegjësinë kushtetuese për zhvillimin e një force ushtarake me kapacitete të besueshme për përmbushjen e misioneve të FASH.

Ndërsa misioni i FASH mbetet i njëjtë, koncepti strategjik i përmbushjes së tij ka evoluar ndjeshëm gjatë shekullit të ri.

i Kartës së Kombeve të Bashkuara, do të ndihmojë Palën apo Palët e sulmuara, duke ndërmarrë menjëherë, individualisht dhe në bashkërendim me Palët e tjera, ato veprime që vlerësohen si të nevojshme, përfshirë këtu përdorimin e forcave të armatosura, për të rivendosur dhe ruajtur sigurinë në zonën e Atlantikut të Veriut “.

Pas prillit 2009 e në vijim, Koncepti Strategjik i mbrojtjes së vendit tonë mbështetet në një ndërthurje dinamike të operacioneve kombëtare me ato aleate. Operacionet ushtarake të FASH për mbrojtjen e vendit, në nivel strategjik, operativ dhe taktik, do të bashkërendohen sipas planeve përkatëse të operacioneve aleate (planeve të përhershme të mbrojtjes (SDP-s); planeve për situata të veçanta (CONPLAN-s); planeve të operacioneve (OPLAN-s); planeve mbështetëse (SUPLAN-s)). Për të kryer një mision të tillë, FASH planëzojnë, stërviten, pajisen dhe bashkërendojnë me forcat aleate që në kohë paqeje.

Koncepti Strategjik i Mbrojtjes merr në konsideratë gjithashtu kontributin për mbrojtjen kolektive. Ai e tejkalon konceptin tradicional të sigurisë dhe të mbrojtjes vetëm të territoreve kombëtare dhe mban parasysh edhe rreziqet e kërcënimit ndaj Aleancës si një e tërë ose ndaj aleatëve të veçantë. Për këtë qëllim, FASH përgatiten dhe bashkërendojnë me komandat aleate për angazhimin e njëjësive të deklaruara të FASH për mbrojtjen kolektive të vendeve të tjera aleate, nëse çënohet integriteti i tyre territorial, si dhe në operacione në përgjigje të krizave të mundshme përtej territorit të Aleancës.

Koncepti Strategjik i Mbrojtjes (keto dy fjale anglisht mendoj se nuk kane vend ketu) së RSH do të zbatohet nëpërmjet një spektri të gjerë të operacioneve të sotme dhe të ardhme të FASH. Mbi bazën e tyre, do të zhvillohen skenarët dhe situatat përkatëse të planëzimit, si dhe planet e operacioneve për përdorimin e forcave tona të armatosura në nivelin strategjik, operativ dhe taktik.

Qasja gjithëpërfshirëse në sigurinë dhe mbrojtjen e RSH

Siguria dhe mbrojtja e RSH në shekullin e ri kërkon një qasje gjithëpërfshirëse. Po ashtu, operacionet e FASH do të karakterizohen nga një pjesëmarrje e gjerë e kapaciteteve ushtarake dhe civile. Në të gjitha rastet, në varësi të shtrirjes,

rëndësisë dhe intensitetit të tyre, pjesëmarrja e forcave dhe e kapaciteteve në operacionet e sotme dhe të ardhshme do të synojë të jetë e përbashkët (*joint*), ndëragjenci dhe shumëkombëshe.

Operacionet e sotme dhe të ardhshme të FASH mund të jenë nën komandimin dhe drejtimin e vetë strukturave të FASH, mund të drejtohen nga agjenci të tjera kombëtare civile ose mund të organizohen e të drejtohen nga organizma ndërkombëtare të sigurisë e të mbrojtjes si NATO, BE, OKB ose koalicione. Kjo çështje mund të evidentohet në nivelin politik, në nivel strategjik, operativ dhe taktik.

Kjo qasje e re e operacioneve të sotme kombëtare dhe ndërkombëtare do të kërkojë më shumë bashkëpunim e bashkërendim në arritjen e synimeve të përbashkëta. Nga këndvështrimi ushtarak, kjo qasje gjithëpërfshirëse bazohet jo vetëm në kuptimin e përbashkët të situatës, por edhe në pranimin e faktit që shpesh aktorët joushtarakë mund të mbështetin aktorët ushtarakë dhe anasjelltas, që aktorët ushtarakë do të mbështetin aktorët joushtarakë⁷.

Krahas anëve pozitive, zbatimi i qasjes gjithëpërfshirëse rrit vështirësitë e kryerjes së operacioneve, sidomos të komandimit dhe kontrollit të tyre, për shkak të qëllimeve, objektivave, kulturave dhe qasjeve të agjencive të ndryshme në operacion. Kjo kërkon nga të gjitha palët ndjeshmëri, mirëkuptim, respekt, besim, durim e takt, si dhe vendosmëri për të bashkëpunuar në të gjitha nivelet duke synuar arritjen e qëllimit të përbashkët.

Bibliografi:

- Kushtetuta e RSH, 1999
- Strategjia e Sigurisë Kombëtare të RSH, 2005
- Strategjia Ushtarake, 2007
- Traktati i Washingtonit, 1949
- Koncepti Strategjik i Aleancës, Lisbonë, nëntor 2010
- AJP-1 (D) Doktrina e Përbashkët e Aleancës, botim shqip

⁷ AJP-1 (D) Doktrina e Përbashkët e Aleancës, botim shqip 2010, faqe 38

Jêdrzej PASZKIEWICZ¹

BASHKËPUNIMI RAJONAL NË BALLKANIN PERËNDIMOR NJË KËNDVËSHTRIM NGA BRENDA BASHKIMIT EVROPIAN, PREMISAT DHE PENGESAT

Abstrakt

Anëtarësimi në BE ka qenë prej thuajse dy dekadave qëllimi i përbashkët i vendeve të Ballkanit Perëndimor. Duke qenë se këto vende kanë ekonomi të vogla dhe zhvillim të ulët ekonomik është e nevojshme që ato të veprojnë sëbashku përmes formave të ndryshme të rrjetëzimeve dhe bashkëpunimit. Trashëgimia historike e së shkuarës së afërme dhe asaj të largët shpesh përbën një pengesë të madhe për zhvillimin e bashkëpunimit të ndërsjelltë ndërmjet këtij grupi vendesh. Gjithashtu, ky faktor pengon edhe përdorimin e mundësive ekzistuese për rritje më të shpejtë ekonomike.

Ky artikull përqendrohet tek pengesat aktuale të bashkëpunimit rajonal në Ballkanin Perëndimor të cilat janë rrjedhojë e pasigurisë ekonomike dhe politike. Vëmendje e veçantë i kushtohet problemeve që ndikojnë rolin e Bashkimit Evropian si një “aktor i jashtëm”, që mbështet transformimin rajonal në skenat e brendshme të Ballkanit. Ky i fundit përfaqëson për të gjithë vendet e rajonit një motiv të mirë për të korrigjuar mungesat aktuale si edhe krijon perspektiva të reja për rolin rajonal të ardhshëm të BE-së. Së fundmi, kjo situatë lejon për konsiderata të reja lidhur me vendin e rajonit në sferën gjeopolitike evropiane.

¹PhD, Universiteti Adam Mickiewicz, Instituti i Historisë, Posnan Poloni paszje@wp.pl.

Fjalët Kyçe: *Ballkani Perëndimor, Evropa Juglindore, Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal*

Bashkëpunimi shumëpalësh ndërmjet vendeve të Evropës Juglindore që është zhvilluar që prej përfundimit të konflikteve të ish-Jugosllavisë në fundin e viteve 90-të është mbështetur aktivisht nga Bashkimi Evropian (BE) i cili e percepton këtë bashkëpunim si një ndihmë të rëndësishme për stabilizimin e paqtë të të gjithë rajonit. Gjithashtu ai perceptohet si një pjesë thelbësore e programeve të vendeve të Ballkanit Perëndimor për t'u anëtarësuar në BE. Lidhja e procesit të përgatitjes për anëtarësim në BE të vendeve të sipërpërmendura me konceptin e bashkëpunimit rajonal është theksuar fill pas përfundimit të konflikteve të armatosura në Kroaci dhe Bosnjë Hercegovinë. Që atëherë termi “Ballkani Perëndimor” u shfaq në fjalorin administrativ të BE-së. Ai përcakton shumicën e republikave ish-Jugosllave që synojnë integrimin në strukturat e BE-së dhe që ndajnë një set të përbashkët sfidash socio-politike dhe ekonomike. Shumica e këtyre pengesave lidhen ngushtësisht me transformimin në vazhdim (që prej mesit të viteve 90-të) të sistemit politik, demokratizimin e pamjaftueshëm, pengesat ekonomike dhe çështjet ende të pazgjidhura të konflikteve të armatosura të së shkuarës².

Që prej fundit të viteve '90, BE-ja ka punuar për të bindur vendet që aspirojnë antarësim që të bashkojnë përpjekjet e tyre për krijimin e zgjidhjeve, ku të gjithë palët janë të barabarta dhe paqësore në fushat e politikës dhe ekonomisë, të cilat synojnë konsolidimin rajonal si një pjesë thelbësore të aktiviteteve përkatës të para-aderimit. Themelet e kësaj politike janë të shqetësimi për rritjen e nivelit të sigurisë në Evropë në

² Sipas terminologjisë së aprovuar nga Bashkimi Evropian, vendet e mëposhtme konsiderohen si Ballkani Perëndimor: Shqipëria, Bosnjë Hercegovina, Serbia dhe Kosova. Përveç vendeve të Ballkanit Perëndimor, Evropa Juglindore (e cila ndonjëherë përkufizohet si Ballkani) përfshin gjithashtu edhe Bullgarinë, Greqinë Rumaninë dhe Turqinë. Shih: Milica Deleviaë, 'Regional Cooperation in the Eastern Balkans', *Institute for Security Studies. Chaillot paper*, No 104, 2007, pp. 13–15.

përgjithësi dhe në veçanti për të evituar transplantimin e çështjeve që lidhen me marrëdhëniet e komplikuar të republikave ish-Jugosllave në BE³.

Nuk ka dyshim se atmosfera e përgjithshme e marrëdhënieve politike post-Jugosllave gjatë pjesës së dytë të viteve '90, vështirë se mund të përkufizohet si inkurajuese për krijimin e formave afatgjata të bashkëpunimit ndërmjet shteteve përkatëse, të cilat do të tejkalonin ndjesinë dominuese të ankthit. Mungesa e stabilitetit politik në rajon ka pasur ndikimin e tij shkatërrues për sigurinë e shteteve të reja e të sapoformuara. Pretendimet territoriale të pazgjidhura kontribuan që strukturat politike në të gjithë rajonin t'i përkushtoheshin aktiviteteve të një natyre të veçantë, të cilat synonin kryesisht vendosjen e ndonjë lloj kundërpeshe ndaj pretendimeve kundërshtuese të vendeve fqinje. Edhe pse kjo gjendje në Ballkanin Perëndimor gradualisht i la vendin negociatave bilaterale gjatë gjysmës së dytë të dekadës, nuk mund të injorohet fakti se këto ndryshime kanë ardhur kryesisht si të imponuara nga superfuqitë⁴. Nga ana tjetër, adoptimi i sjelljeve të orientuara drejt integritetit Euro-Atlantik prej elitave politike të rajonit të Ballkanit ka treguar se është një avantazh i vlefshëm për krijimin e operacioneve shumëpalëshe. Falë kësaj qasjeje, vende të veçanta mund të marrin përgjegjësi më të madhe për stabilizimin e rajonit dhe të lidhin më tej këtë çështje me sigurinë evropiane.

Marrëdhëniet që lidhen me nocionin e sigurisë ndërkombëtare, ndërmjet BE-së dhe vendeve të Ballkanit, janë të lidhura ngushtësisht me idenë e bashkëpunimit shumëpalësh, i cili sipas krijuesve të tij synon të balancojë zhvillimet socio-politike dhe ekonomike të vendeve të rajonit. Iniciativa në fjalë u konkretizua te Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore (PSEJL), i cili u formua nga Bashkimi

³ Sandro Knezovič, 'Postkonfliktni Okviri Regionalne Sigurnosti i Suradnje u Jugoistočnoj Europi—Inicjative Evropske Unije', *Politička Misao*, Vol. 43, No 2, 2006, p. 80.

⁴ Denisa Kostovicova, 'Slabost Države na Zapadnom Balkanu kao Pretnja Bezbednosti: Pristup Evropske Unije i Perspektiva Globalne Politike', *Bezbednost Zapadnog Balkana*, No 7–8 2007–2008, p. 14

Evropian në qershor të vitit 1999 dhe që detyroi të ashtuquajturat republikat ish-Jugosllave dhe Shqipërinë (vendet që synonin anëtarësim) që të përmirësonin më tej marrëdhëniet e brendshme në Ballkan⁵. Fillimisht prezantimi i Paktit të Stabilitetit u bazua mbi katër iniciativa ekzistuese ekonomike dhe politike për Evropën Juglindore⁶. Ndërmjet tyre ishte edhe Procesi i Bashkëpunimit për Evropën Juglindore (PBEJL), i cili përmbante një sërë bashkëpunimesh në fusha si siguria, dialogu politik, veprimet në përputhje me ligjin, ndërtimi i burimeve njerëzore dhe lufta ndaj krimit të organizuar⁷. Marrëveshja e Tregëtisë së Lirë e Evropës Qendrore (MTLEQ), e cila u formua në vitin 1992 dhe u rishikua në vitin 2006, nga ana tjetër zëvendësoi sistemin e komplikuar të 32 marrëveshjeve tregtare ndërmjet vendeve të Evropës Juglindore⁸. Iniciativa e Evropës

⁵ Erhard Busek, Björn Kühne, *From Stabilisation to Integration. The Stability Pact for South Eastern Europe* (Wien: Böhlau, 2010), pp. 11–23.

⁶ Milica Deleviæ, pp. 23–25

⁷ Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (PBEJL) përbëhej nga këto vende: Shqipëria, Bosnjë Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Greqia, Republika Ish Jugosllave e Maqedonisë (RIJM), Rumania, Republika Federale e Jugosllavisë, Turqia dhe Moldavia si vëzhgues. Takimet vjetorë të PBEJL ndiqen nga kryeministrat ose nga kryetarët e shteteve në rolin e koordinatorit. Takimet konsultative zhvillohen gjithashtu në nivel ministror. Përgatitjet për takimet e PBEJL janë nën kompetencën e Zyrës së Sekretarit. Me synim mundësimin e një koordinimi më të mirë të aksioneve të përbashkë mbledhet e ashtuquajtura Trio e cila përbëhet nga përfaqësues të PBEJL, Komisionit Evropian dhe të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (KBR); Milica Deleviæ, p. 18.

⁸ Fillimisht (deri në vitin 2004) ndër firmëtarët e kësaj marrëveshjeje ishin edhe Çekosllovakia (që prej vitit 1993 Republika Çeke dhe Sllovakia), Polonia dhe Hungaria. Në vitin 1996 MTLEQ iu bashkuan edhe Sllovenia (deri në vitin 2004), Rumania në vitin 1997 (deri në vitin 2007), në vitin 1999 Bullgaria (deri në vitin 2007), në vitin 2003 Kroacia, në vitin 2006 RIJM, në vitin 2007 Shqipëria, Bosnjë Hercegovina, Mali i Zi dhe Kosova e përfaqësuar nga Qeveria e Përkohshme e Misionit Administrativ të OKB në Kosovë (UNMIK). Vende të veçanta janë tërhequr nga kjo marrëveshje pas anëtarësimit në BE. E vetmja strukturë e MTLEQ është Komiteti i Përbashkët i cili mbledh ministrat përgjegjës për çështjet që përfshihen nën këtë marrëveshje. Udhëheqësit e vendeve pjesëmarrës mbajnë takime vjetorë: Erhard Busek, Björn Kühne, pp. 191–233

Qendrore (IEQ, 1989) dhe Iniciativa Adriatiko-Joniane (IAJ, 2000) që u themeluan si përpjekje të diplomacisë italiane, janë gjithashtu faktorë të rëndësishëm për mbështetjen e bashkëpunimit shumëpalësisht në Ballkanit. Fillimisht, ato u konceptuan për të mundësuar konsultime për çështjet ndërkombëtare, por më pas përfshinë edhe bashkëpunimin në fusha të tjera si për shembull për kufijtë, shkëmbimin kulturor dhe shkencor si edhe për ekologjinë⁹.

Nevoja për themelimin e mekanizmave për bashkëpunim ndërkombëtar, të cilët do të favorizonin rritjen ekonomike dhe rritjen e strukturave demokratike në të gjithë vendet e rajonit, ishte në themel të Paktit të Stabilitetit. Krijuesit e tij u përpoqën për të pasur një qasje të kuptueshme për situatën në Ballkan dhe që të besonin se gjendja e çështjeve në fillim shekull ende vendosej nga faktorët, të cilët shpërbënin marrëdhëniet socio-politike dhe ekonomike.

Rumania, Bullgaria dhe Moldavia u përfshinë sëbashku me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe brenda kuadrit të iniciativave të mësipërme u krijuan tre grupe pune, të cilët u përdorën për të mbështetur dhe vlerësuar aktivitetet e qeverive përkatëse në një sërë fusha të jetës socio-ekonomike¹⁰. Fusha e parë ishte trajtimi i çështjeve të demokratizimit dhe të drejtave të njeriut. Fusha e dytë lidhej me bashkëpunimin ligjor dhe tregtar, rritjen ekonomike dhe rindërtimin e asaj që u shkatërrua gjatë luftrave. Grupi i tretë lidhej me çështjet e sigurisë. Pakti i Stabilitetit synonte të mblidhte të gjithë

⁹*Iniciativa e Evropës Qendrore (IEQ)* ka funksionuar nën emrin aktual që prej vitit 1992. Paraardhësit e saj ishin iniciativat e emëruara si *Quadrangonale* (1988), *Pentagonale* (1990) dhe *Hexagonale* (1991). 18 vende (10 vende antarë të BE-së si edhe 8 vende jashtë BE-së) janë përfshirë në aktivitetet e CEI. Struktura kryesore e saj është Sekretariati Ekzekutiv bazuar në Trieste. Takimet e kryetarëve të qeverive dhe ministrave përkatës të punëve të jashtme mbahen në bazë vjetore. IEQ përfshin tre të ashtuquajtur fonde mbështetës të cilat përdoren për zhvillimin e projekteve me fonde të ndryshëm; Milica Deleviæ, pp. 21–22; Dalibor Kekić, 'Jadransko-Jonska Inicijativa', *Međunarodni Problemi*, Vol. 55, No 3–4, 2004, pp. 413–433.

¹⁰ Së bashku me Komisionin Evropian dhe një sërë organizatash ndërkombëtare (NATO, OKB, OSBEE, Këshilli i Evropës, Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar), Zvicra, Norvegjia, ShBA dhe Japonia morrën pjesë si shtete mbështetës dhe Ukraina morri pjesë si vëzhgues; Sandro Knezoviæ, p. 105.

pjesëmarrësit e procesit në një tavolinë të përbashkët, ku secili kishte të drejta të barabarta. Pjesëmarrësit ishin vendet e Ballkanit Perëndimor dhe vendet fqinjë, vende anëtarë të BE-së, organizatat ndërkombëtare më të mirënjohura dhe institucionet financiare. Qëllimi kryesor i këtij bashkëpunimi ishte mbajtja rregullisht e konferencave për t'u marrë me çështjet e rëndësishme për idenë e bashkëpunimit rajonal¹¹.

Procesi u drejtua nga BE, bazuar në Paktin e Stabilitetit që synonte rivendosjen e lidhjeve ndërmjet vendeve fqinje dhe kombeve si edhe trashëgiminë e përbashkët historike dhe kulturore të të gjithë rajonit. Këto lidhje u dobësuan thellësisht gjatë periudhës së dominuar nga mosmarrëveshjet etnike dhe fetare. Padyshim që dëshira e madhe për t'u integruar në BE, që është shfaqur prej shumicës së strukturave shoqërore të rajonit të Ballkanit Perëndimor, ka qenë një ndihmë e konsiderueshme për thellimin e procesit të inspiruar nga BE, të ri-vendosjes së marrëdhënieve rajonale. Ndërkohë, qasja që u miratua prej BE-së për bashkëpunimin rajonal ka qenë objekt kritikash të shpeshta nga qeveritë e vendeve të veçanta, të cilat e quanin atë si arbitrare dhe si me mungesë shqetësimi për realitetin shumëplanësh dhe të komplikuar politik dhe tregtar në rajon. Mendjet kritike theksonin se pakti shpesh detyronte qeveritë për të bërë aktivitete shfaqjesh me synim arritjen e një vlerësimi pozitiv prej Komisionit Evropian duke vepruar ndërkohë kundër interesave kombëtarë. Rrjedhimisht, kjo qasje nuk qe efiçase për zgjidhjen e problemeve ekzistues në marrëdhëniet ndërkombëtare, por shërbeu vetëm për agravimin e konkurrencës ndërmjet vendeve që aspirojnë anëtarësim në BE.

Iniciativat u bazuan kryesisht tek Pakti i Stabilitetit. Në vitin 2001 vendet e rajonit firmosën paktin ndërkombëtar lidhur

¹¹ Marrëveshjet e bashkëpunimit ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Bashkimit Evropian (2001-2008) lidhen me procesin e stabilizim asocimit zhvilluar pas themelimit të Paktit të Stabilitetit. Dokumentimi i aktivitetit të grupeve rajonale të punës gjatë periudhës 1999-2008: Erhard Busek, Björn Kühne, p. 126

me zhvillimin e rrjetit rajonal të transportit, i cili përmbante lehtësime doganore si edhe prezantimin e projekteve infrastrukturore të cilët synonin të krijonin një sistem të unifikuar komunikimi në rajon. Ndërmjet aktiviteteve që zgjatën për dekada sistemi i themeluar i bashkëpunimit rajonal u konsiderua si i suksesshëm. Suksesi më i madh u arrit në fushat e transportit dhe energjisë si edhe fushat specifike për politikat socio-ekonomike dhe bashkëpunimin e forcave policore.

Një përmbledhje e një rrjeti të integruar transporti tokësor dhe lumor i cili përfshinte republikat e ish-Jugosllavisë si edhe Shqipërinë, u krijua nën mbikëqyrjen e BE-së¹². Në vitin 2002 u vendosën objektiva për Procesin e Bashkëpunimit të Danubit (PBD), lidhur me uniformitetin që nevojitej për rregulloren e lundrimit në Lumin Danub dhe për Komisionin Ndërkombëtar të Basenit të Lumit Sava, i cili do të balancoje shfrytëzimin e burimeve natyrore të lumenjve të basenit të lumit Sava¹³. Bashkëpunimi në fushën e industrisë energjetike bazohej tek Traktati i Komunitetit të Energjisë ndërmjet BE-së dhe vendeve të Ballkanit, që u prezantua në vitin 2006. Akti në fjalë ka krijuar bazat ligjore për integrimin e tregjeve të veçantë të energjisë dhe unifikimin e rregulloreve për shfrytëzimin e burimeve të naftës dhe gazit¹⁴.

Një tjetër kategori bashkëpunimi pëmban aktivitetet për zgjerimin e reformave ekonomike dhe lidhet ngushtësisht me një strukturë të specializuar që quhet Investimet Kompakte për Evropën Juglindore dhe që punonte nën mbikëqyrjen e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD)

¹² E. Busek, B. Kühne, pp. 255–272. See also: Nenad Nikolic, *SEE Core Regional Transport Network Development*, Southeast Europe Transport Observatory (Brussels, SEETO, 2010).

¹³ Erhard Busek, Björn Kühne, pp. 273–296; Simona Mameli, 'Regional cooperation in Western Balkans in times of political and economic uncertainty', *PECOB's Papers Series*, No 8, 2011, pp. 10–11

¹⁴ Shih: www.eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2006:198:0018:0018:EN:PDF (12.06. 2012).

dhe të Komisionit Evropian. Kjo do të mundësonte qeveritë me mbështetjen në përgatitjen e reformave ekonomike dhe me vlerësimin për realizimin e tyre¹⁵. Një rol i njëjtë në fushën sociale performohet nga i ashtuquajti Procesi i Bukureshtit, i cili filloi në tetor të vitit 2003¹⁶. Qëllimi i Iniciativës Elektronike të Evropës Juglindore (IEEJL), e cila është themeluar që në vitin 2001, ishte mundësimi i ndihmës për prezantimin e teknologjive të komunikimit modern në strukturat administrative të qeverisë, institucionet ekonomike dhe në shkollat publike¹⁷.

Sigurimi i kufijve dhe lufta ndaj krimit të organizuar përbëjnë një fushë të rëndësishme të bashkëpunimit rajonal ndërmjet vendeve të Ballkanit. Përpyekjet e tyre të përbashkëta përputhen me kuadrin e mundësuar që nga viti 1999 nga Qendra Rajonale për Luftën ndaj Krimit Ndër-Kufitar mbikëqyrjen e Iniciativës për Bashkëpunim të Evropës Juglindore (IBEJL)¹⁸.

¹⁵ Erhard Busek, Björn Kühne, pp. 237–242. See also: <http://www.investmentcompact.org> (12.06.2012).

¹⁶ Erhard Busek, Björn Kühne, pp. 383–389. Nga iniciativat e ndërmarra përgjatë kohëzgjatjes së *Paktit të Stabilitetit* dhe lidhur me Ballkanin Perëndimor ja vlen të ri-vlerësohen janë përshembull iniciativa e cila synonte rritjen e kanaleve politikë dhe të trajnimit profesional për gratë (*Gender Task Force*, 1999) si edhe për balancimin e niveleve të arsimit (*Education Reform Initiative of South Eastern Europe*, ERI SEE, 2004). Një tjetër iniciativë e rëndësishme lidhet me harmonizimin e tregjeve të punës (*Centre of Public Employment Services of South East European countries*, CPESSEC, 2007). Njëkohësisht një sërë programesh që synonin bashkëpunimin ndërmjet tregjeve të punës së rajonit të Adriatikut u prezantua. (SVILMA, 2004–2006; DILMA 2007–2009). Në vitet 2008-2010 u ndërmorr një program për promovimin e reformave në fushën e mirëqenies shoqërore në vendet e rajonit nën mbikëqyrjen e Komisionit Evropian dhe Këshillit të Europës; Hermine Vidovic, Vladimir Gligorov, Renate Hauptfleisch, Mario Holzner, Katja Korolkova, Monika Natter, 'Developing Efficient Activation Approaches and Identifying Elements for Regional Cooperation in the Western Balkans', *Research Reports. The Vienna Institute for International Economic Studies*, no 374, 2011, pp. 146–147.

¹⁷ Erhard Busek, Björn Kühne, p. 296.

¹⁸ Iniciativa për Bashkëpunim të Evropës Juglindore (IBEJL) u krijua në vitin 1996 si një forum për bashkëpunimin ndërkombëtar në luftën ndaj krimit të organizuar.

